



PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA AKSESUESHMËRIA DHE PJESEMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

RAPORTI MBI PËRPUTHSHMËRINË
DHE HARMONIZIMIN E KORNIZËS LIGJORE
DHE INSTITUCIONALE NË SHQIPËRI
ME KONVENTËN PËR TË DREJTAT E PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Shtator 2023



AUTOR:

Nesila Koka, Juriste Eksperte për të Drejtat e Njeriut

Juliana Shllaku, Arkitekte, eksperte për aksesueshmërinë

Mbështetur nga Fondacioni Shqiptar për Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Botuesit

Albanian Disability Rights Foundation (ADRF)

Albanian National Association of Deaf (ANAD)

Movement against Disability (POLIO PLUS),

Association of Paraplegics and Paralyzed Children of Kosova (HANDIKOS)

“This report was developed with the support of the “SMART Balkans – Civil Society for Shared Society in the Western Balkans” regional project implemented by Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Center for Research and Policy Making (CRPM) and Institute for Democracy and Mediation (IDM) and financially supported by the Norwegian Ministry of Foreign Affairs (NMFA). The content is the sole responsibility of the project implementers and does not necessarily reflect the views of the Norwegian Ministry of Foreign Affairs (NMFA)

Ky raport u zhvillua me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Shoqërinë e Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Krijim Politikash (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA). Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)

Publikimi i nënshtrohet të drejtës së autorit. Mund të riprodhohet pa pagesë apo leje paraprake për qëllime të tjera, por jo për rishitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leja paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi.

Tabela e Përmbajtjes

AKRONIMET:	4
I. HYRJE	5
1.1 Informacion mbi projektin	5
1.2 Të dhëna të përgjithshme	5
II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
III. METODOLOGJIA	8
IV. PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE	10
IV.1 Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.....	10
IV.2 Strategjia Evropiane e Aftësisë së Kufizuar, 2021-2030	11
IV.3 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara	12
V. KUADRI LIGJOR SHQIPTAR PËR AKSESUESHMËRINË DHE PJESËMARRJEN NË JETËN POLITIKE DHE PUBLIKE.....	14
V.1 Aktet ligjore e nënligjore kryesore për aksesueshmërinë.....	14
V.1.1 Mbledhja e të dhënave	23
V.1.2 Mjedisi/ Territori.....	24
V.1.3 Transporti.....	26
V.1.4 Informimi dhe komunikimi	28
V.1.5 Ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme/sectoriale	32
Strehimi	32
Edukimi - Arsimi.....	34
Punësimi.....	38
Turizmi dhe arkeologjia.....	40
Legjislacioni për statuse të vecanta të aftësisë së kufizuar	40
Monitorimi, kontrolli dhe zbatimi	41
V.2 Aktet ligjore e nënligjore kryesore për Pjesëmarrjen në Jetën Politike dhe Publike.....	43
VI. KUADRI INSTITUCIONAL	53
VI.1 Aksesueshmëria	53
VI.2 Pjesëmarrje në Jetën Politike dhe Publike.....	58
VII. PËRFUNDIME	61
VIII. FORMA E PËRMBLEDHUR E ANALIZËS SË KORNIZËS LIGJORE PËR AKSESUESHMËRINË DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE	63
IX. REFERENCA.....	82

AKRONIMET

AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKSHI	Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
FSHDKPAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
IKMT	Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHPSHS	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
IVMT	Inspektoriati Vendor për Mbrojtjen e Territorit
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
KKAK	Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KMD	Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqënies Sociale
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OSHMA	Ofrues të Shërbimit Media Audiovizive
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
QV	Qendra e Votimit
TIK	Teknologji- Informacioni-Komunikim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1.1. Informacion mbi projektin

Raporti mbi përputhshmërinë dhe harmonizimin e kornizës ligjore dhe institucionale në Shqipëri me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara u hartua në kuadër të projektit rajonal Aleancat e Aftësisë së Kufizuar për Zhvillimin e Reformave Gjithëpërfshirëse në Rajon” (DADIRR), të cilin Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara po zbaton nga Janari i vitit 2023, për një periudhë 18 mujore, së bashku me organizatat partnere në Ballkanin Perëndimor, HANDIKOS Kosova, Polio Plus Maqedoni dhe Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë, po zbaton në kuadër të programit rajonal SMART Balkans.

Programi rajonal, SMART Balkans – Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor i cili synon forcimin e demokracive pjesëmarrëse dhe proceseve integruese euro-atlantike në Ballkanin Perëndimor duke fuqizuar organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e OSHC-ve për një rol më të fortë dhe aktiv në krijimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi, financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe po zbatohet nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (Centar za promociju civilnog društva - CPCD), në bashkëpunim me organizatat partnere nga Shqipëria – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Maqedonia e Veriut – Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM).

Projekti DADIRR synon të kontribuojë në forcimin e një rrjeti të pavarur rajonal të organizatave të aftësisë së kufizuar dhe autoriteteve publike në 3 vendet e

Ballkanit Perëndimor, për të avancuar çështjet e aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, për të garantuar harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare në përputhje me Konventën e KB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), Strategjinë Evropiane të Aftësisë së Kufizuar 2021-2030.

Kjo do të realizohet përmes ndërhyrjeve të cilat do të bëjnë të mundur: a) promovimin e mekanizmave të vetë-rregullimit përmes përgatitjes së raportit për pajtueshmërinë dhe harmonizimin e legjislacionit në fushën e aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes në jetën politike e publike; b) inkurajimin e bashkëpunimit dhe partneritetit mes organizatave të personave me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe qeverive për të përgatitur rekomandime për harmonizimin e legjislacionit me KDPAK; c) promovimin e politikave efektive të avokimit, mbikëqyrjes së qeverisë, llogaridhënies dhe transparencës përmes krijimit të Grupeve Parlamentare për Lobim për Aftësinë e Kufizuar (PLG) në tre vendet e Ballkanit Perëndimor ku po zbatohet projekti.

1.2 Të dhëna të përgjithshme

Sipas statistikave të fundit nga MSHMS¹, numri i personave që kanë një aftësi të kufizuar në Shqipëri është 143,973, prej të cilëve 72,838 invalidë pune dhe 71,135 përfitues nga skemat jokontributive të aftësisë së kufizuar. Vitet e fundit në Shqipëri janë hartuar një sërë ligjesh dhe politikash për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Këtu mund të përmendim në mënyrë të veçantë Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (PVKPAK) (2021-2025), Ligjin

¹ MSHMS, janar -shkurt 2023

për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuara², dhe një sërë vendimesh që rregullojnë aksesueshmërinë, shërbimet në përgjithësi, punësimin, arsimin, pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike, mosdiskriminimin. dhe të tjera. Të gjitha këto shprehin angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë Shqiptare për të realizuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) ka qënë burimi kryesor i këtyre ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe politik. Përveç ndikimeve në kuadrin ligjor dhe politik, KDKPAK ka sfiduar edhe qëndrime apo këndvështrime të shoqërisë mbi personat me aftësi të kufizuara që nga momenti i ratifikimit. Kjo dhe patjetër shumë faktorë, në mes të të cilëve veçojmë mungesën e burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore kanë sjellë sfida dhe vështirësi në zbatimin e kuadrin ligjor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Në veçanti neni 4/2 i Kushtetutës parashikon se: “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.” Neni 116 i Kushtetutës pasqyron hierarkinë e normave ligjore, duke parashikuar se “aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a. Kushtetuta; b. marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c. ligjet; ç. aktet normative të Këshillit të Ministrave”.

Marrëveshjet apo konventat ndërkombëtare radhiten pas Kushtetutës në hierarkinë e normave ligjore dhe për pasojë ato zënë një vend të rëndësishëm në rendin ligjor. Këtë e përforcon dhe neni 122 i Kushtetutës, i cili parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj, kanë epërsi mbi ligjet e Shqipërisë që nuk pajtohen me to.³

Qeveria Shqiptare ka dorëzuar raportin e parë për masat e ndërmarra nga ajo për zbatimin e KDKPAK në vitin 2015, duke përbushur kështu detyrimin për raportim që i përkiste vitit 2014.⁴ Gjithashtu, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Komiteti) në vitin 2019 përgatiti konkluzionet përfundimtare dhe rekomandimet për shtetin shqiptar.⁵ Në lidhje me kuadrin ligjor, Komiteti ka shprehur shqetësimin se përpjekjet janë të pamjaftueshme për realizimin e vlerësimit bio-psiko-social, eliminimin e përdorimit të gjuhës denigruese në një numër ligjesh dhe vendimesh, harmonizimin e përkufizimit të aftësisë së kufizuar dhe përshtatjes së arsyeshme, si edhe garantimin e shërbimeve të aksesueshme në përgjithësi, por edhe shërbimeve të specializuara për personat me aftësi të kufizuara. Ky shqetësim është shprehur edhe nga organizatat lokale në vend në vazhdimësi gjatë viteve të fundit pasi ligjet edhe pse janë të shkruajtura mirë janë të zbatuara pjesërisht. Mungon ndarja e vizionit dhe kuptueshmëria e tyre njëllor nga pushteti qëndror e deri në bazë, në pushtetin lokal.

² Ligji Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë

³ Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Xhezair Zaganjori Prof. Dr. Aurela Anastasi Dr. Eralda (Methasani) Çani, 2011

⁴ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolNo=CRPD%2fC%2fALB%2f1&Lang=en

⁵ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolNo=CRPD%2fC%2fALB%2fCO%2f1&Lang=en

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në 2012 me Ligjin 108/2012 të datës 15.12.2012 “Për ratifikimin e Konventës së KB” Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Sipas Nenit 4, “Detyrimet e Përgjithshme, të KDPAK, të gjitha shtetet kanë detyrimin të miratojnë të gjitha masat e duhura legislative, administrative dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në Konventë.

Qëllimi i këtij raporti studimor është analiza e akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me përputhshmërinë e tyre me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin 108/2012, në dy fusha Aksesueshmëria dhe Pjesëmarrja në Jetën Politike dhe Publike. Objektivi i dytë i këtij studimi është ndërgjegjësimi dhe sugjerimi i disa ndryshimeve të nevojshme për mirë-zbatimin e Konventës.

Metodologjia për hartimin e këtij raporti është e një tipologjie cilësore. Ajo konsiston në punën kërkimore (desk review) të dokumenteve ligjore dhe politike dhe analizimin e kuadrit ligjor dhe politik nga këndvështrimi i KDPAK. Progres i dukshëm është evidentuar në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe në përpjekjet për t’u përqasur atë me KDPAK dhe me standardet që ajo përfaqëson. Megjithatë, gjetjet e raportit flasin për një përputhje të pjesshme të kuadrit ligjor kombëtar me KDPAK. Edhe pse Shqipëria ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e legjislacionit, nga analiza rezulton që legjislacioni akoma ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Në fushën e aksesueshmërisë u evidentua numri më i lartë i ndryshimeve ligjore, të cilat janë në një nivel të kënaqshëm në përputhje me KDPAK dhe me rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara. Problematikat kryesore të identifikuar kanë të bëjnë kryesisht me: a) mungesën e mekanizmave efektivë të monitorimit dhe koordinimit,

b) mungesën e penaltiteve, c) mungesën e përdorimit të qasjes duale në legjislacionin e zakonshëm ose të përgjithshëm, e për pasojë mospërfshirje të çështjeve të personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i legjislacionit për aksesueshmërisë vazhdon të mbetet sfida për institucionet përgjegjëse. Niveli i zbatimit është ndikuar në mënyrë të ndjeshme nga mungesa e ekspertizës në këtë fushë dhe mungesa e burimeve financiare.

Fusha e pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike është një fushë e cila nuk ka pësuar ndryshime të mëdha në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Kodi Zgjedhor, si ligji bazë për rregullimin e të drejtës për të/t’u zgjedhur shfaq disa mangësi. Së pari, kodi nuk mbulon të gjithë personat me aftësi të kufizuar, por orientohet kryesisht vetëm tek personat me aftësi të kufizuar fizike dhe ata të verbër. Së dyti, ai nuk përmban detyrime të qarta për institucionet vendore dhe qendrore në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë dhe përshtatjeve të arsyeshme. Së treti, ai kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara intelektuale për të votuar. Së katërti, ai nuk ofron alternativa të tjera votimi. Në fushën e pjesëmarrjes në jetën publike, shumica e akteve ligjore edhe pse përmendet se do të rregullohen me nën-akte ligjore, nuk ka pasur sistemime të tyre. Ka mungesa të theksuara të terminologjisë së duhur, përçarqasjes për personat me aftësi të kufizuara në ligje të ndryshme. Edhe pse ligji ka fuqinë gjithpërfshirëse në hartimin e tij, prapë vihet re që interpretimi për PAK mbetet evaziv me shumë boshllëqe interpretimi.

Raporti përmban edhe një formë të përmbledhur të Analizës së Kornizës Ligjore në fushën e Aksesueshmërisë dhe Pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike ku është paraqitur në formë tabelore, legjislacioni aktual dhe nevojat për rishikim dhe plotësim për të garantuar përputhshmërinë me KDPAK, gjithashtu edhe rekomandime bazuar nga analiza ligjore dhe komunikimet me grupet e punës.

III. METODOLOGJIA

Raporti analitik i përputhshmërisë së kuadrit ligjor me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, është realizuar bazuar në metodologjinë e përzgjedhur paraprakisht në të tre vendet që marrin pjesë në këtë projekt. Ky raport përmban një vlerësim të kuadrit ligjor në dy fusha të përzgjedhura:

- Aksesueshmëria – Neni 9 KDPAK;
- Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike – Neni 29 KDPAK.

Metodologjia për hartimin e këtij raporti është e një tipologjie cilësore. Ajo konsiston në:

- punën kërkimore (desk review) të dokumentave me natyrë ligjore dhe politike, studimeve dhe raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare
- identifikimin e analizimin e kuadrit ligjor dhe politik nga këndvështrimi i KDPAK.

Analiza nxjerr në pah, përveç mospërputhshmërive me KDPAK, edhe problematikat ekzistuese ose mungesën e efektivitetit të legjislacionit dhe përqëndrohet në tre drejtime kryesore.

Së pari, evidenton aspektet që nuk përputhen me frymën dhe kërkesat e KDPAK.

Së dyti, identifikon problematikat që sjellin mungesën e zbatueshmërisë së legjislacionit.

Së treti, evidenton mungesën e përfshirjes së çështjeve të personave me aftësi të kufizuara në ligje të zakonshme ose të përgjithshme (për të gjithë popullatën në përgjithësi), që prekin ose kanë ndikim të konsiderueshëm në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo e fundit, bazohet në parimin e qasjes duale, që do të thotë integrimin në maksimum të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në

legjislacionin e zakonshëm dhe kufizimin në minimum të çështjeve që duhen trajtuar më vete.

Vlen të theksohet gjithashtu që jo të gjitha nenet e KDPAK janë zberthyer në mënyrë të mjaftueshme për bërë një analizë të detajuar të çdo pike që përmbajnë nenet e saj, përveç rasteve kur Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka miratuar komente të përgjithshme, si në rastin e aksesueshmërisë <https://ëëë.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-2-article-9-accessibility-0>. Metodologjia, në këtë kontekst, nuk përmban një kornizë me indikatorë të posaçëm të cilën mund të shërbejnë si elementë krahasimorë. Në këtë kuptim, analiza është kryer në bazë të informacionit dhe interpretimeve ekzistuese të neneve të KDPAK që janë përzgjedhur për këtë raport, nga burime të ndryshme, kryesisht të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave apo ekspertëve të mirënjohur të fushës.

Objektivat kryesore të këtij raporti janë:

- të prodhojë të dhëna të cilat mundësojnë analiza krahasimore sipas fushave për të gjitha vendet pjesëmarrëse;
- të krijojë një kornizë rekomandimesh për përmirësimin e legjislacionit në nivel kombëtar;
- të ndihmojë në zbatimin e aktiviteteve të projektit në nivelin rajonal.

Për të marrë informacionin e nevojshëm për hartimin e raportit metodologjia përmbante pyetje të përgjithshme në lidhje me sistemin ligjor në Shqipëri, dhe në veçanti pyetje për kuadrin ligjor dhe institucional të posaçëm për personat me aftësi të kufizuara. Këto pyetje synonin të identifikonin dhe përshkruanin në mënyrë të përmbledhur aktet juridike

të të gjitha niveleve në të tre fushat e përzgjedhura, akte të tjera si strategji, politika, ndryshime ligjore që janë miratuar ose ndryshuar pas ratifikimit të KDPAK, kuadrin institucional, që do të thotë institucionet e përfshira në zbatimin e kuadrit ligjor.⁶

Për marrjen dhe përpunimin e informacioni sa më lart, u angazhua në një periudhën Prill – Tetor 2023 grupi i ekspertëve të përzgjedhur⁷. Ekspertët kanë ndjekur hapat e paracaktuar në metodologji për realizimin e këtij raporti që janë si vijon:

- Mbledhja e të dhënave të disponueshëm për sektorin përkatës duke përfshirë të dhëna në lidhje me alokimet buxhetore për sektorin përkatës;
- Përshkrimi i akteve të identifikuara në të gjithë sektorët;
- Identifikimi i problematikave të legjislacionit kombëtar (mospërputhshmëri) në një këndvështrim krahasimor lidhje me KDPAK dhe rekomandimet e Komitetit;

- Identifikimi i problematikave që ndikojnë në nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe politik;
- Identifikimi i mungesave të çështjeve të personave me aftësi të kufizuara në akte të përgjithshme (strategji, politika, udhëzime etj.);
- Paraqitja e kornizës institucionale për sektorët përgjegjës për çështjet e personave me aftësi të kufizuara;
- Analiza tërësore e kuadrit ligjor dhe politik dhe përpilimi i rekomandime për secilën nga fushat.

Raporti është i fokusuar në legjislacionin shqiptar dhe sesi ai përputhet me KDPAK. Në raport janë përmendur ligjet sipas fushave të përzgjedhura, të cilat janë hartuar sipas një strukture të unifikuar në të gjithë raportin. Në çdo kapitull përfshihet neni përkatës dhe nëse është në përputhje apo jo me KDPAK. Gjithashtu ofrohen disa sqarime të përgjithshme mbi arsyen e hartimit të ligjit dhe si preken të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Çdo akti ligjor i bëhet një analizë ligjore së bashku me konkluzionet dhe rekomandime.

⁶. Pyetjet gjenden në Aneksin 2 bashkëngjitur raportit

⁷. Lista e ekspertëve gjendet në aneksin 1 të këtij raporti

IV. PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

IV.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Aksesueshmëria (Neni 9):

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për:

- ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës;
- informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.

Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura:

- për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;
- për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun, të marrin parasysh të

gjitha aspektet e mundësimin për personat me aftësi të kufizuara;

- për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;
- për të siguruar në ndërtesat dhe mjete të tjera të hapura për publikun, shenja në Braille dhe në një formë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- për të siguruar forma asistence të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionalë të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar hyrjen në ndërtesa dhe mjete të tjera të hapura për publikun;
- për të promovuar forma të tjera të përshtatshme asistence dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar që atyre t'u mundësohet informacioni;
- për të promovuar mundësimin e informacionit të ri dhe sistemet e teknologjitë e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe internetin;
- për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e sistemeve të informacionit të mundësueshëm dhe teknologjisë së komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të mundshme me një kosto minimale.

Pjesëmarrja në jetën Politike dhe Publike (Neni 29):

Shtetet palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër:

- Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike mbi bazë të barabartë me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësi të kufizuara për të votuar dhe për t'u zgjedhur, ndër të tjera duke:
- siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të mundshme dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur;
- mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, kur të jetë e përshtatshme;
- garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person që zgjidhet prej tyre,
- Promovimin në mënyrë aktive një ambient në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në kryerjen e punëve publike, pa diskriminim dhe në një bazë të barabartë me të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në punët publike, përfshirë:
- pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;
- krijimin apo pjesëmarrjen në organizata për personat me aftësi të kufizuara për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuara në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

IV.2. Strategjia Evropiane e Aftësisë së Kufizuar, 2021-2030⁸

Kjo Strategji merr parasysh diversitetin e aftësisë së kufizuar, që rezulton nga ndërveprimi ndërmjet dëmtimeve afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat shpesh janë të padukshme, me pengesa në mjedis, si dhe përhapjes së shtuar të aftësi të kufizuara me moshën, me pothuajse gjysma e personave mbi 65 vjeç që raportojnë një formë të paaftësisë. Strategjia promovon një perspektivë ndërsektoriale, duke adresuar barrierat specifike me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara që janë në kryqëzimin e identiteteve (gjinore, racore, etnike, seksuale, fetare), ose në një situatë të vështirë socio-ekonomike ose situata të tjera të cenueshme.

Prandaj, Strategjia mbështet tranzicionin e gjelbër dhe dixhital dhe një Evropë të shëndetshme duke kontribuar për një Union të qëndrueshëm, elastik, inovativ dhe të drejtë. Është pjesë e Planit të Veprimit të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale i miratuar nga Komisioni. Si plotësuese e strategjive të barazisë të miratuara për të luftuar diskriminimin në të gjitha format e tij, kjo Strategji do ndihmojë për të arritur një Union të Barazisë dhe për të forcuar rolin e Evropës si një partner global në luftimi i pabarazive, siç është arritja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe promovimi i të drejtave të njeriut.

Bashkimi Evropian është i ankoruar në vlerat e barazisë, drejtësisë sociale, lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ofrojnë bazën për të luftuar të gjitha format e diskriminimit, duke vendosur barazinë si një gur themeli të politikave të BE-së. Presidentja von der Leyen shpalli si një nga prioritetet e Komisionit të saj për të ndërtuar një Union të Barazisë në të gjitha kuptimet e tij. Miratimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësitë të kufizuara (KDPK) në 2006 shënuan një përparim në mjedis dhe standardet minimale për të drejtat e personave me aftësi të

⁸ <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8376&furtherPubs=yes>

kufizuar. BE-ja dhe anëtarët e saj, Shtetet palë në KDPAK dhe po përparojnë me zbatimin e Shtyllave Evropiane e të Drejtave Sociale që shërbejnë si busull për punësim dhe politikat sociale, të shpallura bashkërisht në vitin 2017 nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni Evropian. Parimi 17 i Shtyllës nënvizon se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e mbështetjes së të ardhurave që u siguron jetesën dinjitoze, shërbime që mundësojnë ata të marrin pjesë në tregun e punës dhe në shoqëri, dhe një mjedis pune të përshtatur për nevojat e tyre.

Aksesueshmëria – mundësues i të drejtave, autonomisë dhe barazisë, në mjediset e ndërtruara dhe virtuale, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë transportin dhe infrastrukturën, është një mundësues i të drejtave dhe një parakusht për pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.

Nxitja e pjesëmarrjes në procesin demokratik dhe pjesëmarrja e plotë politike, siç kërkohet nga KDPAK, nënkupton që personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë në zgjedhje, si dhe në proceset politike dhe vendimmarrëse me baza të barabarta me të tjerët.

Cilësi e denjë e jetës dhe të jetuarit në mënyrë të pavarur. Jetesa e pavarur, shërbimet cilësore sociale dhe punësimi, strehimi i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës, pjesëmarrja në mësimin gjatë gjithë jetës, mbrojtja e duhur sociale dhe një ekonomi sociale e forcuar janë të domosdoshme për një jetë të denjë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

IV.3. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërshirja e PAK

Agenda 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm (Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara) është një dokument tjetër i rëndësishëm i cili e bazon suksesin e realizimit të tij, mbi konsiderimin "Agenda e njerëzve, nga njerëzit dhe për njerëzit". Agenda 2030 me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, bazohet në parimin "*asgjë rreth nesh, pa*

ne". Në Vizionin e Agendës 2030 përfshihen personat me aftësi të kufizuara, duke theksuar "respektin për të drejtat e njeriut, dinjitetin njerëzor, barazinë dhe mosdiskriminimin". Në "Deklaratën e Agendës" jepen parashikime të forta mbi respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore për të gjithë, pa dallim të asnjë lloji, përfshi aftësinë e kufizuar. Nga 17 "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm" të kësaj Agende, 13 janë të lidhura veçanërisht me personat me aftësi të kufizuara dhe 7 prej tyre i referohen vetëm personave me aftësi të kufizuara. Vlen të përmendet që e gjithë Agenda 2030, mbështetet në parimin "Asnjë të mos mbetet pas". Agenda 2030 sjell në vëmendje lidhjen mes grupeve vulnerabël dhe varfërisë dhe përforcon termin "persona vulnerabël" duke vendosur edhe personat me aftësi të kufizuara në qendër të eliminimit të varfërisë. Agenda 2030 elaboron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me të tjerët, në edukim, punësim, jetën politike e shoqërore etj, duke garantuar aksesueshmërinë dhe përshtatjen e arsyeshme.

Si pjesë e Objektivave të Qëndrueshme, sidomos Axfenda 2030 (SDGs 2015-2030) përfshin të gjitha Objektivat të cilat kanë në fokus edhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ku mund të përmendim më kryesoret në lidhje me këtë raport studimi:

- Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë;

Më specifikisht 4.5 Deri në vitin 2030, eliminim i pabarazive gjinore në arsim dhe sigurim i aksesit të barabartë për të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional për personat e riskuar, përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara, popullsitë indigjene dhe fëmijët në situata të riskuara.

Dhe 4.8 Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuara dhe gjinisë dhe sigurimin e mjediseve të mësimi të sigurt, jo të dhunshëm, gjithëpërfshirës dhe efektiv për të gjithë.

Ky objektiv kur shihet në krahasim me Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 është në përputhje me synimet

e tyre dhe e njëjta përfaqje është edhe kur e krahason me ligjet për aksesueshmërinë në një arsim cilësor. Kur vlerësojmë nivelin e zbatimit të tyre shohim mungesa në kapacitete qoftë njërëzore dhe financiare.

- Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë;

Në pikën 8.5 përmendet se *“deri në 2030, arritja e punësimit plotësisht produktiv dhe punës së denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshi të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë.”* Për këtë objekt janë përshtatur dhe përmirësuar ligje dhe VKM që kanë të bëjnë me nxitjen e punësimit sidomos për personat me aftësi të kufizuara.

- Zvogëlim i pabarazisë brenda për brenda vendeve dhe mes tyre;

Për këtë objekt është pika 10.2:

Deri në vitin 2030, të arrihet fuqizimi dhe promovimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve pavarësisht nga mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, raca, përkatësia etnike, orgjina, feja ose gjendja ekonomike ose tjetër. Legjislacioni shqiptar për përfshirjen sociale, ekonomike dhe politike është shumë pak i zhvilluar pasi mungojnë burimet dhe hapësirat e duhura për të patur një gjithëpërfshirje sociale. Ka projekte dhe aktivitete për gjithëpërfshirjen sociale, kodi zgjedhor ka të pasqyruar ndryshime për të drejtën e votës e cila lë vend për interpretim, ndërsa zhvillimi ekonomik është më pas në krahasim me të tjerat.

- Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm;

Më specifikisht: 11.2 Deri në vitin 2030, të ofrojnë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë për nevojat e atyre në situata në risk si gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

Dhe 11.7 Deri në vitin 2030, të ofrohet qasje universale në hapësira të sigurta, përfshirëse dhe të arritshme, në hapësira publike dhe në natyrë, në veçanti për gratë dhe fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë analizës ligjore të akteve ligjore shqiptare është bërë edhe interpretimi

- Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillimin e qëndrueshëm

Deri në vitin 2030, duhet të sigurohet rritja e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve për vendet në zhvillim, duke përfshirë vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla në zhvillim, për të rritur ndjeshëm disponueshmërinë e të dhënave me cilësi të lartë, në kohë dhe të besueshme të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, statusin, aftësinë e kufizuar, vendndodhjen gjeografike dhe karakteristikat e tjera relevante në kontekstin kombëtar.

V. KUADRI LIGJOR SHQIPTAR PËR AKSESUESHMËRINË DHE PJESËMARRJEN NË JETËN POLITIKE DHE PUBLIKE

V.1 Aktet ligjore e nënligjore kryesore për aksesueshmërinë

Ligji kuadër me Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, u miratua nga Parlamenti Shqiptar bazuar në rekomandimet e KDPAK. Qëllimi kryesor i ligjit, sikurse shprehet dhe neni 1 i tij, është të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe nga ana tjetër të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara. Duke u nisur edhe nga vetë emërtimi i ligjit, aksesueshmëria luan një rol qendror në këtë ligj për përfshirjen dhe garantimin e të drejtave, sikurse rezulton edhe në qëllimin e ligjit: “...në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara...”

Në nenin 3 të ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, termi “Përshtatje e arsyeshme” përkufizohet si “modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin, ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave e lirive themelore të njeriut”.

Në këtë ligj, përcaktohet ngritja e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, si përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit, si edhe përfshirjen në këtë Këshill të përfaqësuesve nga organizata për aftësinë e kufizuar. Me VKM Nr. 48, datë 21.1.2015 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” (neni 3) u përcaktua roli i

Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) si organ këshillimor i Qeverisë për të: (i) përcaktuar drejtimit e politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë; (ii) propozuar dhe rekomanduar për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në të gjitha fushat; (iii) rekomanduar shërbime dhe programe që janë posaçërisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre; etj. KKAK shqyrton zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për Këshillin e Ministrave.

Neni 9 i VKM-së krijon Sekretariatit Teknik të Këshillit pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe është struktura mbështetëse për aktivitetet e Këshillit (KKAK).

KKAK kryesohet nga Ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Ata emërohen nga Kryeministri me propozim të të gjithë organizatave dhe lirohen me urdhër të Kryeministrit.

Ligji ka sjellë disa risi të domosdoshme në kontekstin shqiptar për sa i përket çështjeve të aftësisë së kufizuar. Të tilla çështje janë: angazhimi ose vlerësimi i personave me aftësi të kufizuara, monitorimi i zbatimit të KDPAK në nivel të brendshëm, sqarime në lidhje me koncepte të cilat përbëjnë risi sikurse janë vendimmarrja e mbështetur, barazia para ligjit, shërbime të jetesës së pavarur, përkufizimi, administrimi i mjeteve ndihmëse, krijimi e pikave fokale dhe çështje të kujdestarisë ose ndihmësve personalë. Ky ligj tenton të kodifikojë “aftësinë e

kufizuar” nën një ombrellë. KDPAK nuk bën dallime mes llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar por përdor termin ‘aftësi e kufizuar’ duke mos e përkufizuar atë qëllimisht, por duke e lënë të hapur pasi konsiderohet një term që evoluon me kohën dhe si i tillë nuk mund të përkufizohet. Në Shqipëri legjislacioni vazhdon të mbetet i fragmentuar dhe ekzistenca e shumë ligjeve të cilat mbrojnë më shumë disa “aftësi të kufizuara” në krahasim me disa të tjera, ka shkaktuar një situatë diskriminuese mes komuniteteve të aftësisë së kufizuar. Ndërkohë ky ligj synon qartazi që përmes vlerësimit të përshtatshëm të komisioneve multidisiplinare, të vlerësoj nevojat për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara. Ky vlerësim bëhet bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funkcionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetit. Keshtu hiqet dore nga modeli i vjetër i vlerësimit bazuar në përkatësinë në statuse ligjore të caktuara, të bazuar mbi modelin e vjetëruar mjekësor.⁹

Në nenin 14 “Financimi i aksesueshmërisë”, ligji përcakton që fondet për garantimin e aksesueshmërisë parashikohen nga MSHMS e cila koordinon me ministrinë e linjës dhe sipas udhëzimeve të KKAK, por nuk përcakton instrumentet për aplikim e tij. Ky nen ka nevojë për një akt nënligjor (VKM ose Urdhër të Ministrit të MSHMS) ku të konkretizohet detyrimi sipas këtij neni për miratimin e një rregulloreje ose udhëzimi se si planifikohen fondet dhe se si Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) mund të japë udhëzime për ministrinë e linjës. Pa këto përcaktime KKAK nuk mund të japë udhëzimet e nevojshme për planifikimin që kërkon ligji. Mungesa e penaliteteve gjithashtu mund të ketë ndikuar në cilësinë e zbatimit të ligjit. Përfshirja e penaliteteve në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij ligji gjithashtu mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në zbatimin më të mirë të tij.

Ligji parashikon gjithashtu që në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre. Këta punonjës shërbejnë si pika fokale në zbatim të kërkesës të KDPAK për ngritjen e pikave fokale. Në lidhje me këtë detyrim, gjatë zbatimit të ligjit në praktikë është vënë re që edhe në institucionet ku është caktuar nga një nëpunës, këta nëpunës në fakt janë persona të ngarkuar me detyra të tjera, që burojnë nga ligje të tjerë. Kjo, dukshëm ka ndikuar negativisht në cilësinë e punës që ata kryejnë për personat me aftësi të kufizuara.

Disa nga problematikat e identifikuara në këtë ligj janë: Ligji parashikon ngritjen e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbështetjes Sociale, i cili vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, por mungon një institucion i posaçëm për monitorimin e zbatimit të tij. Ky ligj ka parashikuar dy institucione Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për monitorimin e ligjit, por secili prej tyre këtë monitorim e kryen në përputhje me fushën e zbatimit të ligjeve sektoriale mbi bazën e të cilave veprojnë. Nevojitet një mekanizëm i posaçëm për monitorimin e këtij ligji në tërësi dhe jo në aspekte të caktuara të tij, aspekte të cilat dy institucionet e sipërcituara i monitorojnë gjithsesi për shkak të legjislacionit të tyre kuadër. Ky mekanizëm do të ishte më efektiv në monitorimin e ligjit. Përcaktimi i rregullave për monitorimin e tij gjithashtu do ta bënte atë më efektiv, si për shembull një metodologji e caktuar, raportim sistematik, monitorime të posaçme gjatë vitit etj. Pra, ligji ka nevojë të plotësohet me akte nënligjore ku të përcaktohet saktë procedura dhe instrumentet e monitorimit, gjë që do të ndihmonte zbatimin e ligjit, dhe promovimin e tij në terren.

Kuadri ligjor ka mbetur i paplotësuar në lidhje me sigurimin e mjeteve ndihmëse, pavarësisht detyrimit

⁹. Raport monitorimi: Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2017

që ekziston në nenin Neni 9 të ligjit, sipas të cilit mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisionet multidisiplinore. FSDKSH dhe MSHMS nuk kanë marrë ende masat e nevojshme për rregullimin e procedurave të ofrimit të këtyre mjeteve.

Ligji nuk parashikon penalitete në rast të moszbatimit të dispozitave të tij, ndonëse disa penalitetet janë vendosur në VKM - në zbatim të ligjit me Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara". Penalitetet e parashikuara në VKM, jo vetëm janë të pamjaftueshme, por vendosja e tyre në ligj do të rriste standard dhe do të siguronte garanci më të larta për personat me aftësi të kufizuara.

Ligj ka nevojë që të ketë një përfshirje më të gjerë të konceptit të aksesueshmërisë në komunikim, për të reflektuar edhe dinamikën e shpejtë në këtë fushë.

Gjithashtu në ligj nuk është përforcuar sa duhet detyrimi për të siguruar trajnime mbi aksesueshmërinë për stafet e institucioneve ligj zbatuese.

Përveç problematikave të identifikuar më sipër, të cilat lidhen më shumë me zbatimin efektiv të ligjit dhe të cilat patjetër ndikojnë edhe në zbatimin efektiv të KDPAK, nuk gjenden mospërputhshmëri me KDPAK.

Ligji është në përputhshmëri me KDPAK

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara",¹⁰ u miratua në zbatim të ligjit kuadër, Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen

dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". VKM-ja specifikon për herë të parë personat që nuk dëgjojnë si një grup në nevojë për rregulla, masa dhe shërbime përkthimi në gjuhën e shenjave, mësimdhënien në gjuhën e shenjave në arsim, trajnimin e interpretëve, botimin e fjalorit për gjuhën e shenjave dhe ofrimin e transmetimeve të rregullta të lajmeve me titra por edhe në gjuhën e shenjave në televizionin kombëtar.

Qëllimi i vendimit është që të detajojë përkufizimet apo parimet e vendosura nga Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Vendimi përveçse përcakton masat për zbatimin në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara, shërben edhe për unifikimin e rregullave ekzistuese me ato të reja. Sqarimi dhe detyrimi për masat që duhet të ndërmerren të gjitha institucionet buron direkt nga ligji, por nga ana tjetër ky vendim, sikurse vetë ligji merr në konsideratë bazën ligjore ekzistuese (ligje dhe vendime) të cilat tashmë rregullojnë disa aspekte të aksesueshmërisë. Vendimi siguron që aksesueshmëria merr kuptimin më të fundit të dhënë nga KDPAK dhe zhvillimet e fundit, por njëkohësisht përforcon në kontekstin e zbatimit, kuadrin ligjor ekzistues dhe siguron që ai të ketë karakter gjithëpërfshirës dhe plotësues duke iu referuar drejtpërdrejtë VKM-së Nr. 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara", për sa i përket aspekteve teknike të sigurimit të përshtatshmërisë.¹¹

Vendimi është përpjekur që të përkufizojë pengesat e t'i vendosë këto pengesa në raport më të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, duke përcaktuar në mënyrë të qartë institucionet përgjegjëse dhe hapat që duhen të ndiqen nga ana e tyre, me plane dhe afate kohore

¹⁰. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara": http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

¹¹. Raport monitorimi: Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2017

për zbatimin e aksesueshmërisë dhe/ose eliminimin e pengesave. Vendimi ka përcaktuar gjithashtu edhe institucionet përgjegjëse për monitorimin e tyre duke u përpjekur që të bëjë edhe një ndërlidhje të monitorimit mes institucioneve në nivel qendror (MSHMS), rajonal (ISHPSHSH)¹² dhe KKAK, dhe gjithashtu përcakton një procedurë ankimi.

Fusha e veprimit të këtij vendimi është shumë e gjerë. Vendimi përcakton një listë të gjatë të institucioneve shtetërore dhe private në të cilat shtrin efektet ky vendim dhe i ka grupuar ato në katër grupime kryesore, si më poshtë:

- bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse, për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;
- të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;
- mjetet e transportit publik;
- mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

Në vijim, vendimi përcakton hapat kryesorë që çdo subjekt shtetëror apo privat duhet të ndjekë për të realizuar përshtatshmëri. Duke qenë të ndërgjegjshëm që zbatimi i këtij vendimi do t'i nënshtrohet parimit të realizimit progresiv për arsye të shpenzimeve financiare që kërkon fillimisht, janë përcaktuar edhe hapat duke respektuar këtë parim.

Ky parim qartazi shprehet në pikën 12 të Kreut I: *“Subjektet planifikojnë në mënyrë progresive procesin e përshtatjes në përputhje me dispozitat e këtij vendimi”*. Çdo subjekt, ka detyrimin që, brenda 12 muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.

Çdo subjekt që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. Realizimi progresiv i tij duhet të fillojë 12 muaj nga data e miratimit të këtij plani. Planet e Masave kanë të bëjnë me evidentimin e (1) objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, (2) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe (3) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Në mënyrë shumë të kujdesshme vendimi është siguruar që të përfshijë aspektet kryesore në plan, të cilat sigurojnë maksimalisht zbatimin e këtij vendimi dhe të respektojë kërkesat e vendosura në Komentin e Përgjithshëm Nr. 2 (2014) të Komitetit për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbi nenin 9 të KDPAK, Aksesueshmëria, sipas të cilave masat duhet të merren brenda një afati të caktuar kohor. Edhe pse kanë kaluar disa vite nga miratimi i kësaj VKM-je, konstatohet që ka ende një pjesë të konsiderueshme të institucioneve, të cilët nuk kanë hartuar e miratuar një plan masash për eliminimin e barrierave ekzistuese.

VKM ka përcaktime në lidhje me aksesueshmërinë në dokumentacionin dhe financimin me fonde publike dhe konkretisht Kreu I, në pikën 15 “Marrja e masave për përshtatshmëri, në çdo rast, do të jetë pjesë e specifikimeve teknike, si një nga kushtet e detyrueshme për t’u plotësuar në një proces prokurimi” dhe 16 “Ndalohet dhënia e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një veprë, me qëllim ofrimin e shërbimit

¹² Vendimi parashikon si institucion monitorues Inspektoratin Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili në rajone mund të operojë përmes degëve rajonale të tij.

publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim”.

Sikurse u përmend edhe më lart, aksesueshmëria para Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe kësaj VKM-je, trajtohej vetëm në kuptimin e barrierave arkitektonike, pra vetëm për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe deri diku për personat me aftësi të kufizuara shqisore (të shikimit e të dëgjimit). Tashmë, ky vendim, sikurse Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, jep kuptimin e plotë të aksesueshmërisë.

Vendimi ka parashikuar që monitorimi për zbatimin e tij bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili merr masat përkatëse sipas kompetencave të veta dhe njofton ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar për çdo rast shkeljeje të konstatuar. Gjithashtu, vendimi ka parashikuar që Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për rastet e moszbatimit të rregullave të parashikuara në këtë vendim nga institucionet u kërkon subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigjojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se 1/2 e afatit të parashikuar në planifikim. Në lidhje me këtë, një situatë më e qartë procedurale do të ishte e nevojshme, në qoftë se ISHPSHS do të ishte organi i vetëm i cili monitoron zbatimin e vendimit. Proçedura e dërgimit të ankesave pranë Ministrit, i cili ndërmerr disa hapa të tjerë dhe koordinon me KKAK duket një proçedurë jorealiste. Mos raportimi i rasteve duke ndjekur këtë rrugë, flet për pamundësinë e zbatimit të saj.

Gjithashtu nevojitet të rishikohet vendosja e penaliteteve të tjera në mënyrë më të qartë, përveç heqjes së liçencave të subjekteve që shkelin vendimin. Këto penalitete mund të rishikohen gjithashtu në kuadër të Ligjit Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas këtij ISHPSHS mund të vendosë këto penalitete: (i) Paralajmërim; (ii) Gjorbë; (iii) Shkeljet ligjore me afate respektive për t’u korrigjuar; (iv) Masë urgjente “Pezullim” të

pjesëshëm apo të të gjithë subjektit të inspektuar. Këto kompetenca duhet të dalin në mënyrë më të drejtpërdrejtë në ligj.

Përveç problematikave të identifikuar në lidhje me zbatueshmërinë e vendimit në praktikë, nuk identifikohen mospërputhshmëri me KDPAK. Vendimi ka respektuar kërkesat e nenit 9 të KDPAK dhe gjithashtu hapat e përcaktuar në Komentin e Përgjithshëm të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 22 Maj 2014:¹³

VKM është në përputhshmëri me KDPAK

**Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 874, datë 24.12.2019
“Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal”.**

VKM përcakton rolin dhe detyrat e ndihmës personal në mbështetje të personit me aftësi të kufizuara për të kapërcyer pengesat në jetën e përditëshme, si barrierat fizike ashtu edhe ato të komunikimit dhe ndërveprimit. Ndihmësi personal përzgjidhet dhe paiset me program të detajuar nga Administratori shoqëror pranë njësisë administrative.

Në VKM nuk përcaktohen masat për ndërtimin e marrëdhënies financiare ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimit.

Në pjesën më të madhe të njësive vendore (Bashkia e Tiranës bën përjatim) nuk funksionon zinxhiri për përfitimin e ndihmesës personale (administrator social, ndihmës personal dhe Person me Aftësi të Kufizuara), mbasi nuk funksionon Administratori Social.

Në VKM duhet të përcaktohet mënyra se si do të ndërtohen marrëdhëniet financiare ndërmjet ndihmës personal me përfituesin si edhe me Sigurimet Shoqërore. VKM duhet të përmirësohet gjithashtu në drejtim të plotësimit të zinxhirit të shërbimit (administrator social, ndihmës personal dhe PAK) me qëllim zbatimin korrekt të këtij shërbimi.

VKM është në përputhje të pjesëshme me KDPAK.

¹³. Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 22 Maj 2014: http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/2&Lang=en

Ligji Nr. 82/2021 datë 4.06.2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, zbatohet edhe për interpretuesit e gjuhës së shenjave ose lehtësuesit e komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur e në të dëgjuar, në rastet kur caktohen nga organet proceduese sipas legjislacionit procedural në fuqi, ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese, me kushtet e parashikuara në këtë ligj. Ligji përcakton “Interpretues ose interpret i gjuhës së shenjave” është personi i çertifikuar për kryerjen e veprimtarisë së interpretimit të gjuhës së shenjave dhe i regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj. Interpretuesi i gjuhës së shenjave mundëson komunikimin me një person që nuk dëgjon dhe/ose nuk flet, pjesërisht ose plotësisht, nga gjuha e shenjave në gjuhën e folur dhe të shkruar shqipe, gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese.” Në neni 9 ligji përcakton “Papajtueshmëritë”, ku një vend të veçantë merr konflikti i interesit me personin për të cilin përkthehet në gjuhën e shenjave.

Ndonëse ky ligj është një hap pozitiv në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara të dëgjimit, duhet të merren masa për trajnimin e PAK të dëgjimit me gjuhën e shenjave, si edhe të rritjes së numrit të interpretëve të gjuhës së shenjave, për të përmirësuar përfaqësimin e këtyre personave në të gjitha fushat dhe aktivitetet.

Ligji është në përputhshmëri me parimet e KDKPAK.

Më herët Qeveria kishte miratuar VKM me Nr. 837, datë 3.12.2014 “Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën Shqipërisë”, i cili sanksionon njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë. VKM ngarkon Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: (i) si autoriteti përgjegjës për koordinimin e procesit të zbatimit të detyrimeve që lidhen me respektimin e të drejtave të personave që nuk flasin dhe nuk

dëgjojnë dhe (ii) të hartojë platformën me masat për veprim, ku të përcaktohen detyrimet për institucionet që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave.

VKM nuk është plotësuar me detyrimet dhe masat për institucionet që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave, gjë që penguar zbatimin e tij në praktikë.

VKM është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK

VKM 470 datë 6. 07. 2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara” përkufizon vendimmarrjen e mbështetur si ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara, nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin më të mirë të personit me aftësi të kufizuara, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime. Vendimi përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë: a) të zgjedhin mënyrën si do të jetojnë, sipas mundësive të tyre; b) të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe gjithëpërfshirëse në aktivitetet e jetesës së përditshme, sipas vendimmarrjes që mbron interesin më të lartë të tyre; c) të marrin vendime për mbështetje në formën më efektive pa kufizime dhe ndërhyrje në të drejtat e tyre; ç) të pranojnë ose të refuzojnë mbështetjen për vendimmarrje. d) të marrin vendime pa cenuar të drejtat e personave të tjerë.

Institucionet publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbime, kanë detyrimin: a) të marrin masat përkatëse për ofrimin e informacionit sipas kërkesës verbale ose me shkrim nga personi me aftësi të kufizuara; b) të evidentojnë dhe të trajnojnë personat që ofrojnë këtë shërbim për formatet e aksesueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, bashkitë dhe organizatat për aftësinë e kufizuar bashkëpunojnë për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e

personave me aftësi të kufizuara për të përdorur vendimmarrjen e mbështetur si një mjet për fuqizimin e autonomisë e të pavarësisë së personave me aftësi të kufizuara.

Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar bashkëpunon me strukturat e shërbimeve sociale në nivel rajonal dhe vendor për të përforcuar referimin e shërbimeve që ndihmojnë në vendimmarrjen e mbështetur. Vendimi ngarkohen Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, bashkitë dhe njësitë administrative për zbatimin e këtij vendimi.

VKM është në përputhshmëri të lartë me parimet e KDKPAK

Institucionet, organizatat dhe strukturat përgjegjëse duhet të marrin masat e nevojshme për zbatimin e VKM-së.

Vendimi Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike. Duhet theksuar që ky vendim shumë i rëndësishme për garantimin e aksesueshmërisë, por e trajton atë në mënyra dhe dimensione të kufizuara dhe nuk i përmbahet kuptimit gjithëpërfshirës që ky term ka sipas KDKPAK dhe Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Ky vendim rregullon aspektet fizike të mjediseve publike dhe private, duke u përqendruar kryesisht në personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore apo ndijore por vetëm në barrierat arkitektonike, pra, nuk përfshin të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Në vendim përdoren terma si mundësi hyrjeje, mundësi shfrytëzimi apo përshtatshmëri, të cilat mbulojnë në mënyrë të pjesshme disa aspekte të aksesueshmërisë, ndërkohe që aksesueshmëria kërkon eliminimin e të gjitha llojeve të pengesave për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara sipas KDKPAK dhe Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Në vendim duhet ndërhyrë

gjithashtu në terminologjinë e përdorur me një gjuhë të zbehtë, sipas së cilës kërkohet që përzgjedhja e projekteve të bëhet mbi baza preferenciale. Fjala “preferohet” duhet të rishikohet dhe të vendoset si detyrim. Gjithashtu nevojitet përforsimi i kërkesave për të zbatuar rregullat e parashikuara në vendim, si edhe theksimi në mënyrë të qartë i të drejtës së administratës për të refuzuar projektet që nuk janë konform me rregulloren. Ky vendim është miratuar para miratimit të KDKPAK dhe ligjeve dhe akteve nënligjore në zbatim të saj, ndaj edhe terminologjia dhe aspektet teknike të rregullores nuk janë në përputhje të plotë me këto dokumente.

Ndonëse rregullorja mbulon një pjesë të konsiderueshme të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë, ka ardhur koha që kjo rregullore të ripunohet duke u mbështetur në KDKPAK, ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe dokumentet e miratuara mbas miratimit të saj.

Rregullorja është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK

Ligji Nr. 10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me ligjin 140/2020 rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mos diskriminimit në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, *aftësinë e kufizuar*, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Ligji përkufizon “*Mohimi i përshtatjes së arsyeshme*” si formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një

rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat, liritë themelore të njeriut, bazuar në nenin 3 të ligjit “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ku përcaktohet *“Përshtatja e arsyeshme” si modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin, ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave, lirive themelore të njeriut.*¹⁴

Me ndryshimet në ligjin 124/2020, datë 15.10.2020, ky ligj është përmirësuar në drejtim të zbatimit të tij, nga ku veçojmë: (i) organizatat me interesa legjitime mund të përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara dhe mund të kryejnë hetime në interes të tyre; (ii) Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmbajnë afate për zbatimin e tyre, në të kundërt ato ankimohen në gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative; (iii) afatet kur vendimi i KKD kthehet në titull ekzekutiv; (iv) neni 33/1 i shtuar, i cili trajton penaltitetet/gjobat etj.

Ligji duhet të përmirësohet më tej në drejtim të fuqizimit të instrumenteve në dispozicion, për zbatimin e tij.

Ligji është në përputhshmëri të lartë me parimet e KDKPAK.

Një dokument tjetër i rëndësishëm është **Plani strategjik 2022 -2026 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, ku theksohet monitorimi i zbatimit të ligjeve kryesore në fushën e aksesueshmërisë, veçanërisht: *Ligjit Nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”* që ka për objekt garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, si edhe garantimin e

jetesës së pavarur të këtyre personave, *Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, i ndryshuar* i cili parashikon (neni 32) që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të kenë përmbajtje që çojnë në nxitjen e urrejtjes për shkak të racës, gjinisë, fesë, kombësisë, ose ndonjë shkak tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42.3 (b) parashikon se *komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual, Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive Seksioni 4/8, 11* në të cilin theksohet që *transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi se bashku me Avokatin e Popullit do të monitorojnë edhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Aksesueshmërinë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 – 2025 (“PKVPAK 2021–2025”)

i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 276, datë 12.05.2021 është një dokument strategjik që parashikon realizimin e aksesueshmërisë në përputhje me politikat për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social ekonomike të vendit, duke pasur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përmes masave specifike. Plani i Veprimit synon të ndihmojë përpjekjet e Shqipërisë për të ndërtuar një shoqëri që respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ndalon diskriminimin. PKV

¹⁴. Të njëjtin përkufizim për “mohimin e përshtatshëm” jep edhe ligji për mosdiskriminimin.

përcakton tre objektivat kryesore: (i) përmirësimi i aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara; (ii) aksesueshmëria në transportin publik dhe (iii) përmirësimi i aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara. Ky dokument synon që përmes realizimit të këtyre objektiveve të realizohet qëllimi strategjik për të garantuar akses të barabartë me të gjithë, në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara. Në zbatim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, monitorimi i zbatimit të këtij Plani Veprimi do të kryhet nga Komisioneri për Diskriminimin dhe Avokati i Popullit. Në detyrat e KKAK sipas VKM Nr. 48, datë 21.1.2015 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar” përfshihet edhe monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit, por edhe pse ka kaluar ½ e periudhës së vlefshmërisë së PKVPAK 2021-2025, nga KKAK nuk ka ende asnjë raport monitorimi mbi ecurinë e zbatimit të këtij plani.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar është në përputhshmëri me KDPAK.

Vendim Nr. 436, datë 22.6.2022 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara” përcakton detyrimin që kanë të gjithë institucionet për të garantuar jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara. Vendimi përkufizon “Shërbimet e jetesës së pavarur për PAK” si shërbime që ofrohen për rritjen e mundësive për zgjedhje të barabarta dhe liri të barabarta me personat e tjerë në shoqëri për përfshirjen dhe integrimin social nëpërmjet vendimeve individuale, të ofruara sipas pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Këto shërbime mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punësimit, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë.

Kreu II, 2. Shërbimet e aksesueshme për jetesë të pavarur përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për

aksesueshmërinë fizike dhe në informacion dhe realizohen në mënyrë progresive. Në këtë kapitull VKM përcakton strukturat dhe procedurat për të garantuar përfitimin e shërbimeve të përshtatjeve të arsyeshme në të gjitha fushat.

Kreu III, ankimimi përcakton 1. Për rastet e mos ofrimit të shërbimeve të jetesës së pavarur, çdo person me aftësi të kufizuara ka të drejtë: a) të ankohet te drejtuesi i subjekteve të parashikuara në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave, në rast se konstaton se rregullat, kriteret apo procedurat e parashikuara në këtë vendim janë shkelur, duke mos kufizuar të drejtën për ankimim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, Ministrisë përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuara, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe gjykatave. Në Kreun IV, vendimi ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë udhëzime dhe të mbështesë bashkitë dhe njësitë administrative për forcimin dhe bashkërendimin e shërbimeve të jetesës së pavarur në nivel kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, si edhe të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe koordinatorët mbështetës për garantimin e shërbimeve të jetesës së pavarur. Në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore angazhohet struktura përgjegjëse e shërbimit social në bashki/qarqe për të koordinuar procesin dhe ngarkon një punonjës me detyrën e koordinatorit të mbështetjes.

Vendimi ka nevojë të plotësohet me udhëzimet e nevojshme për zbatimin e tij dhe sigurimin e jetesës së pavarur sipas legjislacionit në fuqi.

Vendimi është në përputhshmëri me parimet e KDPAK.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10. 2020 përcakton procedurat për zhvillimin e procesit zgjedhor, përgatitjen e materialeve zgjedhore, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacioneve për publikun etj, nuk ka përcaktime

në lidhje me ushtrimin e të drejtës për të votuar për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Ky kod ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime në: Nenin 22 “Kompetenca të KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje”, dhe Nenin 23 “Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja”, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë së informacionit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara; Nenin 79 “Afishimi i materialeve propagandistike” dhe Nenet 80-84 e 85 “Mbi transmetimet televizive” duke përfshirë saktësime mbi aksesin e PAK në materialet zgjedhore dhe transmetimet televizive; Nenin 93 “Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave” duke përcaktuar kërkesat për aksesueshmërinë e këtyre qendrave për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 108 “Zjedhësit që nuk mund të votojnë vetë”, ka disa përcaktime për PAK fizikë dhe PAK të shikimit, por nuk garanton pjesmarrjen e të gjitha kategorive të PAK në zgjedhje.

Në “PJESA XIII PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET” nuk parashikohen sanksione në lidhje me moszbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e PAK. Në këtë pjesë duhet të parashikohen sanksione për mosrespektim të të drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara.

Ndonëse Kodi është ndryshuar në vitin 2020, ai nuk garanton ende, pjesmarrjen në zgjedhje të të gjitha kategorive të PAK dhe nuk detyron strukturat përgjegjëse të krijojnë mjedise dhe lehtësira që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtë e tyre për të votuar.

Në Kod duhet të sanksionohet garantimi i aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si edhe votimi për personat që nuk mund të paraqiten përpara komisionit në qendrën e votimit për shkak të aftësisë së kufizuar

Kodi ka nevojë për përmirësime duke konsideruar rekomandimet e KDPAK dhe lejisllacionit bazë shqiptar mbi aksesueshmërinë. *Më gjerësisht ky*

aspekt është trajtuar në kapitullin 5.3 “Pjesëmarrja në Jetën Politike dhe Publike”

Kodi Zgjedhor është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

Udhëzimi i KQZ Nr. 01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Ndonëse ky Udhëzim ka disa parashikime në lidhje me vendndodhjen e qendrave të votimit (në katet e para të ndërtesave) dhe krijimin e disa lehtësirave për PAK (vendosja e rampave), ai ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe lejisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioni Qendror Zgjedhor ka miratuar disa akte normative për të vendosur rampat në qendrat e votimi, por edhe kur ato janë vendosur, nuk janë kontrolluar në se janë zbatuar sipas standardit. Më gjerësisht ky aspekt është trajtuar në kapitullin 5,3 “Pjesëmarrja në Jetën Politike dhe Publike”

Udhëzimi është në përputhje të pjesëshme me KDPAK

V.1.1. Mbledhja e të dhënave

VKM Nr. 708, datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” përcakton institucionet dhe hierarkinë e mbledhjes së të dhënave. Vendimi detyron institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave, për garantimin e konfidencialitetit dhe për respektimin e jetës private të tyre. Ky vendim detyron

të gjithë mbledhësit e të dhënave, t'i dërgojnë ato periodikisht pranë sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) dhe ngarkon qarkun të përpunojë të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, të përcjella nga bashkitë, para se t'i përcjellë ato pranë sekretariatit teknik pranë KKAK. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar përpunon të dhënat e grumbulluara nëpërmjet sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, pranë KKAK, monitoron përditësimin progresiv të të dhënave, sipas treguesve të përcaktuar në vendim dhe i publikon e i dërgon ato pranë Institutit të Statistikave. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale) ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Në vijim vendimi jep formatin e mbledhjes së të dhënave sipas fushave : I. Edukimi; II. Shëndetësia; III. Drejtësia; IV. Strehimi/zhvillimi urban/infrastruktura/transporti; V. Punësimi dhe VI Kultura.

Vendimi është në përputhshmëri me parimet e KDKPAK.

V.1.2. Mjedisi/ Territori

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar është ligji më i rëndësishëm për zhvillimin e territorit dhe përkatës për miratimin e lejeve të ndërtimit për strukturat e reja dhe ato që rikonstruktohen. Ligji ka si qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet:

- përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- krijimit e garantimit të territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale,
- krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimin të përdorimit të sigurt të shërbimeve e

komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;

- nxitjes së jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
- garantimit të kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Neni 45/1; Kushti për përshtatshmërinë e mjedisit:

- Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.
- Përshtatshmëria e ndërtimeve të reja apo në proces rikonstruksioni, si më sipër, është kusht për marrjen e lejes së ndërtimit dhe çertifikatës së përdorimit, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit.
- Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Ky nen detyron aplikimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë bazë për marrjen e lejes së ndërtimit në të gjitha punimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, të reja dhe atyre që rikonstruktohen. Ndërkohë në nenin 6 të Rregullos Model të Zhvillimit të Territorit, dokumenti kryesor në zbatim të ligjit, përcakton “punimet për eliminimin e

barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara, nuk kanë nevojë të pajisen me leje ndërtimi”. Në gjë e tillë komprometon zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë sipas përcaktimeve në ligj, për arsye se Rregullorja model është formati kryesor për të gjitha rregulloret vendore, me të cilat operohet për zhvillimin e territorit dhe miratimin e lejeve të ndërtimit.

Ligji kujdeset për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, duke cilësuar detyrimet për hapësira dhe territore të shfrytëzueshme nga ata. Megjithatë disa përmirësime të cilat do të përforconin këto parashikime mund të bëhen duke shtuar përkufizimin e aksesueshmërisë sipas Ligjit Ligjin Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, pasi konceptimi i përshtatshmërisë ndryshon me atë të aksesueshmërisë (shih VKM Nr. 1503 19. 11.2008 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”), në “dokumentet e planifikimit sipas niveleve të qeverisjes” të përfshihen kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë së mjedisit në listën e dokumenteve të planifikimit sipas niveleve të qeverisjes, konkretisht në secilin dokument. Për takimet dhe konsultimet publike nevojitet të shtohet pikë e veçantë për konsultimin me persona me aftësi të kufizuara dhe përgatitjen e materialeve me formate të aksesueshme sipas Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Në përgjegjësitë e KKT-së”, të përfshihen kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë së mjedisit në secilin prej dokumenteve të përgatitur nga KKT. Të theksohet aplikimi i kërkesave dhe standardeve të përshtatshmërisë së mjedisit gjatë lëshimit të certifikatave të përdorimit dhe inspektimeve.

Neni 53, Ekzekutimi i dënimeve; Gjohet e përcaktuara, sipas neni 52, të këtij ligji, vendosen nga autoriteti përgjegjës i inspektimit i cili përkufizohet në Nenin 3, Përkufizime, pika 3 “Autoritetet e inspektimit të ndërtimit” janë organet e përcaktuara në legjislacionin për inspektimin e ndërtimit.

Ligji ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime në drejtim të theksimit për përfshirjen e detyrueshme të kërkesave të aksesueshmërisë, veçanërisht në nenet:

- neni 15 “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin”
- neni 24 “Këshillimi dhe takimi publik”,
- neni 28 “Përgjegjësitë e KKT-së”,
- neni 42, “Çertifikata e përdorimit” dhe neni 51, “Inspektimi”,
- neni 52, “Kundërvajtjet administrative” dhe neni 53, “Ekzekutimi i dënimeve”, në të cilin

nevojitet të shtohet një pikë e veçantë në rastet e moszbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë të përcaktuara në nenin 45/1 të ligjit.

Ky ligj, më tej është ndryshuar me *ligjin Nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar*, por në këto ndryshime nuk vërehet asnjë përmirësim në drejtim të aplikimit të kërkesave të aksesueshmërisë.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e “Rregullores model të zhvillimit të territorit” (i ndryshuar), është miratuar në zbatim të ligjit Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Pika 1 dhe 2 e rregullores thekson objektin e saj për “përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, si dhe për përmbajtjen, strukturën e procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit dhe qëllimin i saj “përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Rregullorja është shumë e detajuar në aspektet teknike të miratimit të lejeve të ndërtimit, por nuk ka asnjë detajim në zbatim të neni 45/1 të ligjit ku theksohet zbatimi i aksesueshmërisë. I vetmi përcaktim për aksesueshmërinë në këtë rregullore është Neni 6, Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi ku përcaktohet: b) Punimet për

eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara.

Kjo rregullore është ndryshuar me VKM Nr. 457, datë 29.6.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, date 13.5.2015, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, por Neni 6 ka mbetur i pandryshuar “Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi 2. Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara”.

Sipas përcaktimeve në rregulloren model, e cila definon formatin e rregulloreve vendore, punimet për aksesueshmërinë nuk kanë nevojë për leje ndërtimi, që nga njëra anë duket sikur lehtëson procedurat për aplikimin e përshtatshmërisë në mjedisin e ndërtuar, por nga ana tjetër përjashton kontrollin mbi zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë, nga strukturat përgjegjëse (Autoriteti vendor i miratimit të lejeve të ndërtimit, si edhe kontrollit dhe penaliteteve nga policia bashkiake, IVMT dhe IKMT)

Rregullorja Model e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të rishikohet dhe të plotësohet me kërkesat e përshtatshmërisë ndërtimore, në zbatim të nenit 45/1 të shtuar me ndryshimin e ligjit i cili përcakton: Kushti për përshtatshmërinë e mjedisit përcakton:

- Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara;
- Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruar të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Për të përmirësuar Rregulloren model të zhvillimit të territorit, në drejtim të zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë, rekomandohet të integrohet në këtë dokument VKM Nr. 1503 datë 19.11.1998 për

miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

Një dokument tjetër i rëndësishëm për zhvillimin e territorit është Manuali i Lejeve të Ndërtimit, i cili duhet të rishikohet duke përfshirë dhe theksuar kërkesat për aplikimin e standardeve të aksesueshmërisë së mjedisit sipas VKM 1305 datë 19.11.2008 “Për Shfrytëzimin e Hapësirave nga Personat me Aftësi të Kufizuara”.

Rregullorja Model është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

V.1.3. Transporti

Ligj Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar disa herë (nga viti 2014 deri në vitin 2023) mbas miratimit të KDPAK përcakton që normat dhe aktet në zbatim të këtij Kodi, udhëhiqen nga parimi i sigurisë së lëvizjes në rrugë, duke ndjekur objektivat e një lëvizjeje racionale, i mbrojtjes së mjedisit dhe i kursimit të energjisë. Kodi përmban disa parashikime për personat me aftësi të kufizuara, siç janë rezervimi i hapësirave të caktuara për qëndrimin e mjeteve të organeve të policisë rrugore, të zjarrfikëseve, të shërbimit të ndihmës së shpejtë dhe të atyre në shërbim të personave me aftësi të kufizuara lëvizëse, të pajisura me shenja speciale, ose për mjetet e shërbimit në linjë për qëndrimin e tyre në stacionet fundore të linjave. Në rastet e pezullimit të qarkullimit për motive të sigurimit publik, sigurisë së qarkullimit ose nevoja të karakterit ushtarak, si dhe atje ku janë vendosur detyrime, ndalime a kufizime të përkohshme ose të përhershme, mund t’u jepen leje të veçanta për nevoja të domosdoshme mjeteve të policisë, mjekësisë, si dhe personave me aftësi të kufizuar lëvizëse, të pajisura me sinjale të veçanta.

Kodi rrugor është miratuar në vitin 1998 dhe ndonëse është ndryshuar (disa herë nga viti 2014 deri 2023) pas miratimit të KDPAK, ka ende elementë diskriminues në lidhje me marrjen e lejes së drejtimit për një grup personash me aftësi të kufizuara. Në ndryshimet e vitit 2014, neni 115/1 i shtuar për Lejet

e Drejtimit për PAK, parashikon ende diferencime në lidhje me moshën për PAK dhe personat e tjerë. Në Kod vërehen ende kushte diskriminuese në rastin e personave që nuk dëgjojnë.

Kodi rrugor duhet të përmirësohet bazuar në parimin e përfshirjes dhe jo në një frymë përjashtuese. Ky parim duhet të reflektohet në lidhje me dispozita të sakta mbi aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në mbështetje të legjislationit në fuqi, si edhe kushte jo diskriminuese për shkak të gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e lejes së drejtimit të mjetit.

Kodi Rrugor është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

Ligji Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, i cili zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë. Ligji (neni 85) parashikon që, “është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta. Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislationi në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ligji ka nevojë për përmirësime: së pari duke përfshirë konceptin e aksesueshmërisë dhe vendosjen qartësisht të detyrimit për aplikimin e aksesueshmërisë, duke iu referuar të gjithë legjislationit ekzistues që mbulon këtë fushë (Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, VKM 1074 dhe VKM 1503) ; së dyti, duke qenë se legjislationi ndryshon vazhdimisht (legjislationi për vlerësimin e

personave me aftësi të kufizuara të cilat lidhen me përfitimet që ata marrin, përfshirë edhe përfitimet e transportit), dhe planifikohet që të përcaktohen kriteret të reja të përfitimeve ose lehtësimeve nga personat me aftësi të kufizuara (jo vetëm ata që përfitojnë nga ligjet e veçanta siç ka parashikuar ky ligj), propozohet që parashikimi për lehtësime të jetë më i hapur (duke hequr kufizimin që rrjedh nga ligjet e veçanta) dhe të parashikohet shprehimisht ky rregullim në vendimin që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ligji është ndryshuar pas ratifikimit të KDKPAK, por ende nuk janë refektuar saktë, parimet dhe rekomandimet e KDKPAK.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK

Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, rregullave, afateve dhe dokumentacionin për dhënien e liçencave, çertifikatave në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit, si dhe detyrimin e administratës shtetërore për trajtimin e kërkesave dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me legjislationin në fuqi. Vendimi parashikon që subjektet janë të detyruar të zbatojnë legjislationin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t'i krijojnë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Moszbatimi i legjislationit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuara përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e liçencës dhe, ose certifikatës së mjetit lëvizës.

Për të rritur efikasitetin e zbatimit të Udhëzimit, do të duhej të hartohen e miratohen akte ligjore ku të përcaktohen instrumente të saktë detyrues dhe penatitete në rast të moszbatimit të tyre

Udhëzimi është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

Udhëzimi Nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve” ka për qëllim të përcaktojë kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve. Ai parashikon disa dispozita për personat me aftësi të kufizuara, si për shembull infrastrukturë, tualete, asistencë, platforma të pjerrëta, informacion të përshtatur. Megjithatë, udhëzimi ka nevojë për përmirësime veçanërisht në drejtim të përmirësimit të terminologjisë së përdorur duke filluar nga përkufizimi i aksesueshmërisë, si edhe të harmonizimit me KDPAK dhe ligjet e aktet nënligjore për aksesueshmërinë (Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara dhe VKM 1503 datë 19.11.2008 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

Udhëzimi është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

V.1.4. Informimi dhe komunikimi

Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fushat ku zbatohet janë: transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, me përjashtim të medias së shkruar.

Ligji ka disa parashikime të mira për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, mbrojtjen e konsumatorëve me aftësi të

kufizuara, akses publik telefonik, informimin e rregullt të personave me aftësi të kufizuara për shërbimet dhe produktet dhe konsultimin me persona me aftësi të kufizuara. Megjithatë atij i mungojnë disa masa më detyruese dhe gjithëpërfshirëse për sa i takon realizimi të aksesueshmërisë së plotë për personat me aftësi të kufizuara. Kështu, nevojitet të shtohet një përkufizimi i aksesueshmërisë në komunikime dhe personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, aksesueshmëria në përdorimin e shërbimeve telefonike duhet të dalë si një detyrim që në krye të herës, (nen më vete) dhe jo si një kusht që duhet të vendoset nga AKEP ose kur ky i fundit e sheh të përshtatshme për t'u bërë.

Përveç përmirësimeve të mësipërme për plotësimin e përkufizimit të aksesueshmërisë dhe garantimit të saj përmes masave më detyruese, nuk evidentohen mospërputhshmëri me KDPAK.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

Ligji Nr. 43/2023 datë 15.06.2023 “Për qeverisjen elektronike” sanksionon Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si Autoritet përgjegjës për qeverisjen elektronike dhe e-Albania si portalin e vetëm për ofrimin e shërbimeve elektronike qeveritare në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike, të drejtat e personave fizikë, subjekteve private dhe autoriteteve publike për të komunikuar me njëri-tjetrin përmes teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturën e shërbimeve elektronike.

Në ligj nuk ka përcaktime për mënyrën e aplikimit në e-Albania të personave me aftësi të kufizuara si edhe për formate të përshtatura të dokumenteve që prodhohen nga e-Albania, duke përjashtuar PAK nga përdorimi i platformës elektronike, e cila ka hyrë gjerësisht në shërbimet qeveritare.

Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të përfshirjes së PAK në grupet përfituese të shërbimeve të ofruara nga e-Albania. AKSHI duhet të propozojë akte ligjore mbi mënyrat e aplikimit të PAK në

sisytemin e-Albania, si edhe përgatitjen e formateve të përshtatura të dokumenteve

Ligji nuk është në përputhshmëri të kënaqshme me KDPAK

Rregullore Për “Mbrotjtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.20, datë 25.09.2020 dhe ndryshuar në vitin 2021, ka për qëllim të sigurojë një mbrotjtje më të mirë të konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet rregullave më të qarta për të drejtat e përdoruesve në marrëdhëniet me operatorët. Me ndryshimet e fundit, në Rregullore parashikohet që sipërmarrësit e rrjeteve publike celulare duhet: (neni 41) të sigurojnë që çdo përdorues fundor i tyre, i cili për shkak të aftësive të kufizuara të tij/saj, duhet të bëjë ose të marrë thirrje, që mund të jenë në format teksti, mund të përdorin shërbimin e konvertimit të tekstit (Relay service), i cili është njoftuar dhe miratuar nga AKEP; (neni 43) të inkurajohen të ofrojnë pajisje fundore, të cilat ofrojnë shërbimet dhe funksionet e nevojshme për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara; (neni 44) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata dhe (neni 45) të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të veçantë të pajtimtarëve me aftësi të kufizuara, i cili krijon mundësinë e regjistrimit në varësi të pëlqimit të pajtimtarit me aftësi të kufizuara.

Sipërmarrësit e shërbimeve duhet të detyrohen të marrin masat e parashikuara në Rregullore për personat me aftësi të kufizuara dhe jo të inkurajohen të ofrojnë...

Në Rregullore nuk parashikohen ose referohen penalitete në rastet e moszbatimit të dispozitave të saj.

Rregullorja është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligji Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet e administratës shtetërore për personat që banojnë dhe/ose që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të tyre në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësinë më të lartë. Ligji e përmend parimin e aksesit dhe mosdiskriminimit, por nuk ka përcaktime të sakta dhe detyrime specifike për realizimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë aspekt, ligji ka vend për përmirësim në lidhje me përfshirjen e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji ngre agjencinë ADISA e cila ka të përfshirë në detyrimet e saj, aksesin e shërbimeve për PAK duke siguruar mjedis të përshtatur pjesërisht, si edhe sigurimin e gjuhës së shenjave për informacionet e kërkuara. Në ligj ka vend për përmirësim në lidhje me përfshirjen e aksesueshmërisë për të gjithë kategorotë e personave me aftësi të kufizuara.

Në ligj mungojnë penalitetet për rastet e moszbatimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, gjë që ndikon në zbatimin efektiv të tij.

Si konkluzioni, është e nevojshme që në mënyrë që të respektohet parimi i qasjes duale, të shtohet një pikë e posaçme për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, respektimi i legjislacionit mbi aksesueshmërinë nga ana e institucioneve të administratës shtetërore dhe të përfshihen elementët e aksesueshmërisë gjatë proceseve të standardizimit të shërbimeve të parashikuara në këtë ligj. Në ligj duhet të përfshihen sanksione dhe penalitete për rastet e moszbatimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Vendimi Nr. 673 dt. 22.11.2017 i Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, ka si qëllim kryesor ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit, (AKSHI), i cili është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit. Ndër të tjera ky institucion është përgjegjës për: Promovimin e teknologjive të reja, hartimin e strategjive dhe plan veprimeve për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOV dhe zhvillimin e politikave e strategjive në sektorin e shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe nxit investimet në këtë fushë. Gjithashtu AKSHI bashkërendon programe në fushën e SHI-së, si edhe jep kontribut në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

Ky vendim nuk ka përfshirë aspekte të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, çfarë sjell një mungesë vëmendjeje gjatë zbatimit të kompetencave që ai ka. Përmirësimi i këtij vendimi mund të përfshijë një pikë të veçantë në lidhje me miratimin e standardeve të aksesueshmërisë në TIK, e-shërbimeve, sisteme e aplikacione për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu integrimi i teknologjive të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara ndikon në përfshirjen më të madhe gjatë zbatimit të këtij vendimi për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu një aspekt që duhet të përfshihet është edhe detyrimi për të prokuruar produkte të cilat përmbajnë në specifikimet teknike edhe detyrimin për të qenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Përveç mungesës së përfshirjes direkte të personave me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmërisë, nuk janë evidentuar mospërputhshmëri të tjera me KDPAK.

Vendimi është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligj Nr. 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Neni 3 sanksionon të drejtën për informim për cilindo, pa pasur nevojë të shpjegojë arësyet..., por në asnjë nen të ligjit (veçanërisht

neni 14 “Mënyrat e dhënies së informacionit”) nuk jepen përcaktime për ofrimin e informacionit në formate të aksesuesueshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Ligji duhet të rishikohet bazuar në rekomandimet e KDPAK dhe legjisllacionit bazë në fuqi.

Ligji nuk është në përputhje me KDPAK.

Ligji nr. 146/2014 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.

Ky ligj gjithashtu rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik dhe përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Neni 5 i ligjit detyron zbatimin e parimit të transparencës gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese, por nuk ka përfshirë parimin e aksesueshmërisë gjatë proceseve të konsultimit apo dhënies së informacionit në formate të përshtatura.

Në ligj duhet të përfshihet parimi i aksesueshmërisë si në mënyrat e njoftimit dhe marrjes së informacionit, ashtu edhe gjatë organizimit të takimeve publike të parashikuara në këtë ligj. Në ligj mungojnë parashikime specifike për aksesueshmërinë në proceset e konsultimit të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin Nr. 30/2023, rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike dhe zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, me përjashtim të medias e shkruar.

Me përmirësimet e ligjit në prill 2023, janë ndryshuar dhe/ose shtuar disa nene që trajtojnë problematikat e personave me aftësi të kufizuara si: Neni 32, pika 4/a ndalon Operatorët të transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtar të një grupi mbi baza të tilla si gjinia, raca, ngjyra, origjina, ... paaftësia, etj. Si edhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; Neni 32/2 (shtuar në nenin 32) i cili trajton detyrimet e operatorëve që programet e tyre të jenë të arritshme në mënyrë graduale dhe progresive nga personat me aftësi të kufizuara dhe në pikën 5 përcakton “Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive sigurojnë që informacioni në rast emergjencash, përfshirë komunikimet publike dhe njoftimet në rast fatkeqësish natyrore, të ofrohet në mënyrë të tillë që të jetë i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara”; Neni 16 (ndryshuar neni 87) i cili cakton AMA-n me të drejtë t’u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive, ...veçanërisht shërbimeve që mundësojnë akses të përdoruesve me aftësi të kufizuara.

Në këtë ligj nuk ka parashikime të sakta për sigurimin e aksesit për të gjitha kategoritë e përdoruesve me aftësi të kufizuara, si edhe (neni 17/ndryshuar neni 133) nuk parashikohen penalitete dhe sanksione për rastet e moszbatimit të detyrimeve për sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Ligji duhet të përmirësohet duke përfshirë:

- konceptin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në përkufizimet e dhëna në ligj;

- theksim të veçantë në gjuhën e shenjave, përdorimin e ikonave të njohura ndërkombëtarisht si “CC” për sub titrat dhe “AD” për përshkrimet audio, guidat e programeve, dekodimin për shfaqjen e shërbimeve të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
- penalitete dhe sanksione në rast të moszbatimit të aksesueshmërisë për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive, (Miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017)

përfshin disa parashikime për personat me aftësi të kufizuara, por ato rezultojnë të pamjaftueshme për të adresuar në mënyrë të duhur aksesueshmërinë. Kodi duhet përmirësuar bazuar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht në drejtim të përfshirjes së përkufizimit të personit me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmërisë si edhe të respektimit të një modeli bashkëkohor të aftësisë së kufizuara dhe aksesueshmërisë.

Të shtohet një pikë për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku të vendoset theksi në respektimin e diversitetit dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Detyrimet e OSHMA duhet të mos kufizohen vetëm tek përkthimi në gjuhën e shenjave të paktën të një edicioni informativ, por duhet të mbulojnë sa më shumë programe, të theksohet që edicioni qendror informativ të jetë në gjuhën e shenjave si edhe të sigurojë aksesueshmëri në përgjithësi përmes gjuhës së shenjave ose titrave ose “captioning” për një kuotë të caktuar prej 30- 50% të programeve. Gjithashtu mund të lihet i hapur opsioni i përdorimit të një gjuhe të thjeshtë që të përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara në sferën intelektuale.

Përveç mangësive dhe problematikave të identifikuar më sipër, nuk evidentohen mospërputhshmëri me KDKPAK.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

V.1.5. Ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme/sectoriale

Strehimi

Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”¹⁵, ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Ligji garanton qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar plotësimin e nevojave të veçanta të banimit për këto kategori, përparësi në trajtimin e rasteve në programe specifike, ndihmë gjatë procesit të aplikimit, banesa të specializuara, si edhe shërbime fizioterapie, mjekësore, komunitare etj.

Ligji përkufizon “Banesën e specializuar” si banesë me infrastrukturë të përshtatur dhe të aksesueshme për të plotësuar nevojat funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë fizike, për grupet në nevojë.

Ligji përfshin gjithashtu “*Parimin e mos diskriminimit*” dhe specifikon “*Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese*”. Për këtë kategori banesash, ligji detyron pajisjen me infrastrukturën e nevojshme,

të përshtatur dhe të aksesueshme për lehtësimin dhe sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të njoftimit në raste emergjencash. Ligji përcakton gjithashtu që në katet e para të këtyre banesave të parashikohen mjedise të nevojshme për fizioterapi, shërbime mjekësore, shërbime sociale, si dhe mjedise të përbashkëta për jetë komunitare.

Ligji duhet të përmirësohet e të theksojë që të gjitha banesat (jo vetëm banesat sociale), ndërtesat apo programe të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe të plotësojnë kriteret e legjislacionit mbi aksesueshmërinë, pavarësisht faktit nëse janë të specializuara ose jo¹⁶. Kjo mund të rregullohet duke ndërhurë përkatësisht në nenin “Parimet”, duke shtuar aksesueshmërinë sipas legjislacionit për të gjitha programet. E rëndësishme është që të mos krijohen programe të veçanta aty ku nuk është e nevojshme, në përputhje me qasjen duale të KDPAK.

Përveç mungesës së përdorimit të qasjes duale, në ligj nuk ka mospërputhshmëri të tjera me KDPAK.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligji Nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 22/2018, “Për strehimin social” ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së programeve sociale për strehim, si dhe programit për strehim të të punësuarve të administratës publike me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm e të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmë të institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Ndryshimet në nenin 14 me nenin 14/2, parashikojnë lehtësira në aplikimet për strehim nga personat

¹⁵. E drejta për strehim shihet edhe në kontekstin e së drejtës për standard adekuat jetese dhe shërbimesh shoqërore. Ne e kemi përdorur në mënyrë të vazhdueshme në kontekstin e aksesueshmërisë, por informacioni që jepet këtu vlen edhe për seksionin që ka lidhje me të drejtën për standard adekuat jetese.

¹⁶. Ligji për Strehimin Social ka garantuar përmes një sërë parimesh, si garantimi i qasjes të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët dhe parimit të mos-diskriminimit që të gjitha programet që ofrohen në bazë të këtij ligji, ku me prioritet trajtohen ndër grupime të tjera edhe personat me aftësi të kufizuara dhe që këto programe janë të aksesueshme, duke vendosur theksin mbi infrastrukturën. Gjithashtu, ligji ka parashikuar banesa të specializuara për grupime në nevojë, ku gjithashtu përfshihen persona me aftësi të kufizuara.

me aftësi të kufizuara në portalin “e-Albania”, duke u drejtuar në zyrat me një ndalesë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin. Ata asistohen nga punonjësit e ngarkuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Pagesa për tarifat e nevojshme për procesin e aplikimit për personat me aftësi të kufizuara apo dhe familjeve pa të ardhura sigurohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Ligji ka sjellë risi në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara në përdorimin portalit qeveritar e-Albania, gjë që duhet të aplikohet për të gjitha llojet e shërbimeve. Ligji ka nevojë të plotësohet me akte nënligjore mbi format dhe formatet e aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

VKM Nr. 468, datë 26.7.2023 “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës” është miratuar në zbatim të ligjit Nr. 48/2023, dhe ka si qëllim të vendosë kriteret, procedurën, shqyrtimin, miratimin, si dhe rregullat e tjera për trajtimin me kredi të lehtësuar për të punësuarit në administratën publike. Në këtë vendim nuk ka specifikime për personat me aftësi të kufizuara.

VKM Nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, ka për qëllim të përcaktojë normën e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, kushtet dhe standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe standardet e banesave me kosto të ulët.

Ky vendim parashikon që kur në përbërje të familjes ka një a më shumë persona me aftësi të kufizuara, norma e strehimit për personin e parë është 40m² dhe për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m² dhe llogaritet sipas formulës së përcaktuar

në VKM.

Në vendim parashikohet gjithashtu që banesat të jenë të pajisura me ashensorë të përshtatshëm për të garantuar akses nga persona me aftësi të kufizuara, në masën një ashensor për jo më shumë se 75 njësi banimi. Për siguri evakuimi, do të ishte mirë që apartamentet për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha rastet (edhe në ndërtesat me ashensor), të parashikohen në katet e poshtme të tyre. Ky vendim shfaq disa problematika mbasi përveç shtesës në sipërfaqe, nuk përmban elemente të aksesueshmërisë sipas VKM 1503 datë 2008 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga Personat me Aftësi të Kufizuara”. Një problematikë e tillë vërehet edhe në standardet e banesave miratuar me VKM Nr. 626 datë 15.7.2015 “Për miratimin e normave të projektimit të banesave”. Përveç rregullimeve të mësipërme, nuk evidentohen mospërputhshmëri me KDKPAK.

VKM është në përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK

VKM Nr. 626 datë 15.7.2015 “Për miratimin e normave të projektimit të banesave”, Standardet kombëtare të projektimit të banesave ALS-P-NJHND-1501 Në këto standarde (në pikën 2.17) jepet përkufizimi “Pengesat arkitektonike, janë të gjitha vështirësitë që pengojnë lëvizjen e plotë të personave përherë ose përkohësisht, në kushte lëvizjeje të kufizuara ose që lëvizin me karrige me rrota”. Ky është një përkufizim i cunguar në lidhje me përkufizimin në ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”

Në këtë kontekst nuk reflektohen në këtë standard edhe kërkesat e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë dimensionet e saj, por vetëm me një shtesë me 10m², në sipërfaqen e banimit të apartamenteve. Në kapitujt në vijim ku jepen standardet për njësitë hapësinore të veçanta (hapësira e ndenjjes, e gatimit, etj.), dokumenti përcakton “Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë të shprehura në VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 “Për

shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”. Gjithashtu ky standard rekomandon “Projektimi i hapësirave të lëvizjes, distancat, përmasat etj. lidhur me plotësimin e kushteve normale për personat me aftësi të kufizuara, do t’i referohen dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

Kufizimi i kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë vetëm me shtesën në sipërfaqe, si edhe referenca në VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara” për projektimin e hapësirave të lëvizjes, distancat, përmasat etj. lidhur me plotësimin e kushteve normale për personat me aftësi të kufizuara, nuk garanton zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë sipas përcaktimeve në KDPAK dhe legjislacionit shqiptar në zbatim të saj.

Standardet e banesave duhet të rishikohen duke integruar në standard kërkesat e VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”

Nga një informacion i fundit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përgjegjëse për hartimin e standardeve, po punon për hartimin e standardeve të reja për banesat.¹⁷

Normat e projektimit të banesave, janë me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Edukimi - Arsimi

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, ligjin nr. 48/2018 dhe ndryshuar në qershor 2023 ka disa parashikime për aspekte të caktuara të aksesueshmërisë, por

duhet të shtohet një detyrim mbi aksesueshmërinë e institucioneve arsimore dhe të sigurohet një gjithëpërfshirje më efektive.

Me ndryshimet e vitit 2023 ligji shkon një hap me tej me përafrimin me Konventën, duke mundësuar kthimin e shkollave speciale në Qendra Burimore informacioni.

Ligji duhet të përmirësohet me dispozita detyruese për të garantuar nivelin bazë të aksesueshmërisë, në mënyrë që të sigurohet një gjithëpërfshirje më efektive.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

Udhëzim i përbashkët i MARS dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 15 datë 25.07.2023 Për vitin shkollor 2023-2024 në Arsimin parauniversitar.

Neni 5, përcakton: i) pika ç regjistrimin me përparësi në institucionet e arsimit parashkollor, të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.), fëmijët me aftësi të kufizuara; pika d ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinore për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi dhe pika dh. hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parauniversitar në bashkëpunim me personat që kryejnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale të specializuara.

Udhëzimi ka përcaktime pozitive për fëmijët me aftësi të kufizuara, por ka nevojë të plotësohet me specifikime dhe afate për zbatimin e tij. Ministria përgjegjëse duhet të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar Udhëzimin për vitin shkollor 2024-2025

Udhëzimi është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

¹⁷. Sipas informacionit të mbledhur nga ekspertet, por nuk është e vërtetuar.

VKM Nr. 319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”, përcakton shkollat gjithëpërfshirëse si shkollat që integrojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, si edhe definojnë në terminologjinë arkitektonike/inxhinierike “Komoditeti i përshtatshmërisë: Kushtet për përdorim të hapësirave nga nxënësit me aftësi të kufizuara”

Standardet japin shumë pak informacione për zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë bazë për persona me aftësi të kufizuara si në rastin e tualeteve “për të gjitha kategoritë e shkollave duhet të ketë minimum një nyje ËC-je për këta persona. Për informacione të mëtejshme referojuni VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara” dhe për elementët e tjerë të projektimit të shkollave referohuni VKM Nr. 626 datë 15.07.2015 “Normativat e projektimit të banesave”. Për personat me aftësi të kufizuara referohuni VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

Në këto standarde ka një kapitull të veçantë mbi projektimin për persona me nevoja të veçanta, ku përcaktohet: Projektimi i ndërtesave shkollore duhet të sigurojë qasjen e papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe mësim nxënien e nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit përkatës për këtë kategori. Prandaj projektuesit duhet të bazohen në këtë legjislacion por edhe në udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevojave të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të përkufizohen për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigohet me pajisje për dëgjim dhe humbje e pjesë ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit të përshtatshëm. Për pjesëmarrjen e kategorisë së fundit në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësim nxënies projektuesit për një informacion të plotë duhet t’i referohen VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”

Ky kapitull në vijim jep disa përmasa dhe tregues për hapësirat e nevojshme për përdorim nga PAK, por ato nuk janë të mjaftueshme për garantimin e aksesueshmërisë në të gjitha dimensionet e saj.

Standardet duhet të plotësohen me informacionet e nevojshme për të garantuar aksesueshmërinë bazë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”

Standardet e projektimit të shkollave janë me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

Ministria e Arsimit ka miratuar edhe një Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet, por në krye të tij thuhet “Standardet dhe udhëzimet e paraqitura në këtë udhëzim nuk duhet të konsiderohen si rregulla të detyrueshme, por më shumë si rekomandime që mund të modifikohen për t’iu përshtatur kushteve specifike, siç janë dimensionet e hapësirave dhe topografia apo mundësitë e zgjerimit të shkollës”.

Udhëzuesi është dokument teknik me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

VKM Nr. 159, datë 1.3.2017 “Për miratimin e standardeve të kopshteve” përcakton (në kapitullin 2.1 termat dhe përkufizimet) “asnjë fëmijë nuk diskriminohet nga frekuentimi i kopshtit si pasojë e paaftësisë fizike, gjinisë, racës apo etnisë”.

Në fund të përshkrimit për secilin mjedis (kapitulli 5, si të organizohet hapësira e kopshtit) citohet “këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, “Për personat me aftësi të kufizuara”.

Në hapësirën e tualeteve përcaktohet që minimalisht duhet të ketë një paradhomë me lavaman për të rritur dhe dy ËC, një normale dhe tjetra për personat me aftësi të kufizuar (sipas VKM 1503, datë 19.11.2008, “Për personat me aftësi të kufizuara”).

Në hapësirën e shërbimeve higjienike dhe gatimit gjithashtu citohet “këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, “Për personat me aftësi të kufizuara”. Ky standard zbatohet në kopshtit shtetërore dhe private.

Në kopshte apo ambiente shkollore (kapitulli 10) citohet “për persona me nevoja të veçanta duhet që të parandalohet kontakti i përdoruesve të këtyre mjediseve me sipërfaqe emetuese të nxehtësisë më të lartë se 43°C, duke përdorur forma të ndryshme të mbrojtjes”. Gjithashtu këto ambiente që do të shërbejnë për nxënës me nevoja të veçanta të cilët mund të jenë pak më të ndjeshëm ndaj temperaturave të ulëta, temperaturat e rekomanduara sipas ambienteve në tabelë mund të jenë 1 ose 2°C më të larta.

Gjithashtu në këto standarde ka një kapitull të veçantë (kapitulli 11 - aksesibiliteti i pak/barrierat arkitektonike) ku citohet “Për një informacion të plotë projektuesit duhet t’i referohen: Udhëzues në ndihmë të specialistëve projektues dhe zbatues në fushën e ndërtimit Bazuar në Rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar” Miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008”.

Vetëm në shkallët përcaktohet “Për personat me aftësi të kufizuar referohuni VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores “ Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

Standardet e kopshteve për fëmijë duhet të plotësohen me informacionet e nevojshme për të garantuar aksesueshmërinë bazë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e

shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

Standardet e kopshteve janë me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

VKM Nr. 530, datë 20.7.2016 Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve, ashtu si në standardet e kopshteve, për të gjitha njësitë hapësinore përbërëse të hapësirës së çerdheve, ky standard përcakton: për personat me aftësi të kufizuar referohuni VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar” (kapitullin 5 “si të organizohet hapësira e çerdheve, fusha e veprimit). Të njëjtat përcaktime janë në kapitullin 11 aksesibiliteti i PAK/barrierat arkitektonike “Për një informacion të plotë projektuesit duhet t’i referohen: Udhëzues në ndihmë të specialistëve projektues dhe zbatues në fushën e ndërtimit Bazuar në Rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar” miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008. Në kapitullin 12 shkallët përcaktohet “Për personat me aftësi të kufizuar referohuni VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

Standardi duhet të plotësohet me informacionet e nevojshme për të garantuar aksesueshmërinë bazë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”

Standardet e çerdheve janë me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

VKM Nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” Vendimi përcakton që transporti i disa mësuesve dhe nxënësve i sigurohet transporti falas. Nga ky vendim përfitojnë nxënësit të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik. Vendimi nuk ka parashikuar personat me aftësi të kufizuara të tjera, si ata me aftësi të kufizuara mendore për shembull, apo të tjerë të cilët nuk përfitojnë sipas statuseve të mësipërme. Gjithashtu në këtë vendim nuk është parashikuar edhe detyrimi për sigurimin e aksesueshmërisë dhe asistencës së nevojshme.

Vendimi ka nevojë të rishikohet në përputhje me VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

VKM nuk është në përputhshmëri me KDPAK

Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, ka parashikime për studentët, por nuk ka për studentët me aftësi të kufizuara. Ka disa vendime të Këshillit të Ministrave që lehtësojnë tarifat e arsimit për studentët me aftësi të kufizuara¹⁸, por vetë ligji nuk përmban parashikime për lehtësira, për aksesueshmërinë apo procedura të përshtatura pranimit dhe trajtimit në arsimin e lartë. Është e rëndësishme që të integrohen në këtë ligj parimi i aksesueshmërisë dhe standardet e cilësisë që lidhen me të, përkufizime të studentëve me aftësi të kufizuara, si edhe të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit për të garantuar aksesueshmërinë. Aksesueshmëria duhet të mbulojë të gjitha aspektet, përfshirë këtu aksesueshmërinë në mjedise, dhe atë në programet arsimore dhe shërbimet e ndryshme që ofrojnë shkollat. Në këtë

kuptim është e nevojshme përfshirja e konceptit të përshtatjes së arsyeshme që vjen si detyrim nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

VKM Nr. 89, datë 14.2 2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve”, rregullon shërbimet e transportit për nxënësit dhe studentëve në sistemin parauniversitar. Në të mungojnë krejtësisht parashikimet për transport të aksesueshëm për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara.

Edhe pse ekziston një legjislacion i posaçëm që parashikon akses edhe në fushën e transportit dhe kryesisht 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, sërish gjejmë të domosdoshme të theksojmë integrimin e tij në këto vendime, të cilat nuk i referohen këtij legjislacioni, as në tekstet e vendimeve dhe as gjatë zbatimit të tyre.

Përmirësimet duhet të përfshijnë aksesueshmërinë e mjeteve të transportit, konkretisht përfshirjen në kriteret apo kushtet që duhet të plotësojnë këto mjete, si edhe format e tjera të asistencës së nevojshme.

VKM është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK

Vendimi Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, parashikon standardet që duhet të plotësojnë subjektet që kërkojnë pranë MAS hapjen e institucioneve të

¹⁸ Lehtësim nga tarifat e studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në VKM. Nr 269, datë 29/03/2017.

Bursa gjatë studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë bazuar në VKM. Nr. 903, datë 21/12/2016 i ndryshuar;

arsimit të lartë. Në këtë vendim mungojnë krejtësisht standardet e aksesueshmërisë për studentët me aftësi të kufizuara dhe referencat në bazën ligjore ekzistuese¹⁹.

Është e nevojshëm që në këtë VKM të jetë një parashikim i veçantë i përfshirjes së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

VKM nuk është në përputhshmëri me KDKPAK

Ligji Nr. 75/2019, datë 4.11.2019 “Për rininë” ka si objekt mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Në nenin 3, c “Përkufizime” ligji përcakton “Hapësira rinore e sigurt” është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë dhe që plotësojnë standardet e përcaktuara në legjisllacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara, këto hapësira duhet të zbatojnë elementet e përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar. Ligji gjithashtu thekson në nenin 4, a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjisllacioni në fuqi. Ligji krijon Këshillin Kombëtar dhe Këshillin Vendor të Rinisë. Përveç referencave të sipërcituara, ligji nuk ka përcaktime të tjera për zbatimin e detyrueshëm të aksesueshmërisë në mjedis, infrastrukturë/shërbime dhe informacion e komunikim për aktivitetet e ndryshme të rinisë.

Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të përfshirjes së kërkesave të aksesueshmërisë përcaktime të tjera për zbatimin e aksesueshmërisë mbështetur në kuadrin ligjor përkatës. Përfshirja në këshillin kombëtar dhe vendor të rinisë të Personave

me Aftësi të Kufizuara dhe/ose organizatave në mbështetje të tyre, do të ndikonte pozitivisht në hartimin dhe zbatimin e politika në mbështetje të të rinjve me aftësi të kufizuara.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK.

Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” (ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020) përveç përcaktimeve në nenin 7 pika 3 ku përcaktohet “*Shteti nxit dhe mbështet përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmon nëpërmjet sportit integrimin e tyre në jetën shoqërore*”, nuk ka asnjë përcaktim tjetër në lidhje me zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në mbështetje të KDKPAK dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Ligji duhet të përmirësohet duke përfshirë rekomandimet e KDKPAK dhe legjisllacionit bazë mbi aksesueshmërinë.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK

Punësimi

Ligji nr. Nr.7961 datë 12.7.1995, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996; me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003; me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008; me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015), ka përfshirë detyrimin e përshtatjes së arsyeshme sipas rasteve. Një risi pozitive e tij ka të bëjë me zhvendosjen e barrës së provës tek i paditur. Sa i përket procedurës së ankimimit, Kodi i Punës parashikon ndjekjen e procedurës sipas Ligjit Nr. 10221 datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Në lidhje me vendin e punës, kodi ka parashikuar që, “*për aq sa është e mundur, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin e hapësirave në vendin e*

¹⁹. Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë, Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, Vendimi Nr.1503, datë 19.11.2008 Rregulloren “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”

punës nga ana e personave me aftësi të kufizuara". Ky parashikim mund të bjerë ndesh me KDPAK, pasi duket sikur nuk e vendos si detyrim aksesueshmërinë dhe standardet e saj të parashikuara në legjislacionin shqiptar. Shprehja "për aq sa është e mundur" do të nënkuptonte për sa kohë nuk përbën barrë të tepruar nga pikëpamja infrastrukturore, procedurale apo ekonomike. Punëdhënësi duhet të ketë të aksesueshëm vendin e punës, pavarësisht faktit nëse punon apo jo një person me aftësi të kufizuara. Përshtatja e arsyeshme bëhet rast pas rasti, kur aksesueshmëria si detyrim ligjor për të gjithë, nuk arrin të adresojë plotësisht nevojat dhe specifikat që ka një person me aftësi të kufizuara në një rast konkret.

Me ndryshimet e mëpasme të ligjit ka disa përcaktime në: (i) Nenin 9/1,2 "Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, ku përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara dhe 9/8 Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar; (ii) Nenin 33/1 "Informimi dhe konsultimi" nuk ka asnjë përcaktim mbi aplikimin e mjeteve dhe metodave të aksesueshme për kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara; (iii) Nenin 45/4 "vendi i punës" 4. "Për aq sa është e mundur, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin e hapësirave në vendin e punës nga ana e personave me aftësi të kufizuara".

Kodi i Punës ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në drejtim të aksesueshmërisë dhe përshtatjes së arsyeshme në zbatim të legjislacionit të miratuar në përputhje me KDPAK.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar me ligjin Nr. 47/2023 datë 22.06.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"

Ligji sanksionon konceptin e përshtatjes së arsyeshme, përshtatje të vendit dhe mjeteve të

punës, përshtatjen e mjedisit, të kurikulave dhe programeve si edhe mjeteve të trajnimit në kurset e formimit profesional.

Rishikimi i ligjit në vitin 2023 sanksionon ngritjen e Fondit Social të Punësimit, që ndikon drejtpërdrejt në mbështetjen financiare për aksesueshmërinë e vendit dhe mjeteve të punës për të punësuarit me aftësi të kufizuara.

Ndryshimi i ligjit ngarkon Ministrinë e Financave që brenda datës 31.12.2023 të miratojë aktin nënligjor për procedurat dhe mënyrën e mbledhjes së kontributit për Fondin Social të Punësimit në zbatim të ligjit.

Ndryshimi i ligjit në vitin 2023 duhet të shoqërohet me aktet nënligjore përkatëse për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së Fondit Social të Punësimit.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

VKM Nr. 199, datë 3.5.1995 "Për lehtësitë që u krijohen invalidëve në ndërtimet publike", përcakton që të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" dhe të këtij vendimi, duhet të ofrojnë kushte të përshtatshme përdorimi dhe për invalidët, që mënjanojnë barrierat arkitektonike. VKM-ja ngarkon personat fizikë e juridikë që hartojnë projekte për ndërtime publike (spitale, shtëpi pushimi, shkolla), në mjediset e jashtme të këtyre ndërtimeve, parashikojnë kushte që mbajnë parasysh interesat e invalidëve dhe të personave me aftësi të kufizuar. Ky vendim ngarkon institucionet përgjegjëse si dhe gjithë institucionet projektuese e zbatuese, publike e private për zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi është miratuar para miratimit të miratimit të KDPAK dhe si i tillë nuk përmbush standardet në lidhje me fjalorin e përdorur (invalid), si edhe e konsideron aksesueshmërinë vetëm në aspektin e mënjanimin të barrierave arkitektonike.

Ka ardhur koha për miratimin e një VKM-je të re në përputhje me KDPAK dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave

për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

VKM është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Turizmi dhe arkeologjia

Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” ka si qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitjen e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore. Objekti i ligjit është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji përcakton që strukturat e qeverisjes qendrore e vendore dhe subjektet private krijojnë kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut tek vlerat kulturore. Kjo është e pamjaftueshme për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në vlerat kulturore.

Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të përfshirjes së kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, duke ndërhyrë në veçanti në Nenin 167 “Shërbime për publikun”, Neni 176 “shërbimet në muze” dhe Nenin 233 “Aksesi për publikun në muze”, sipas përcaktimeve në VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Vendimi Nr. 711 datë 12.10.2016 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese”, përcakton krijimin e lehtësirave në lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në ambientet e strukturave akomoduese dhe krijimin e lehtësirave në komunikim, si kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese. Në vijim VKM përcakton që ndërtesat e strukturat akomoduese projektohen dhe ndërtohen me qëllim që të gjithë klientëve dhe vizitorëve t’ju sigurohet hyrja me anë të mjeteve të sigurta, të rehatshme dhe lehtësisht të përdorshme në të gjithë ndërtesën. Në hotele duhet të garantohet që një pjesë e dhomave të jetë e pajisur që të garantojë përdorimin e mjeteve nga personat me aftësi të kufizuara. Edhe ky vendim nuk ka dispozita të mjaftueshme për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

VKM ka nevojë për përmirësime sipas përcaktimeve në KDPAK dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, si edhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara”.

VKM është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Legjislacioni mbi statusin e personit me aftësi të kufizuara

Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit” rregullon statusin ligjor dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Ligji përmban parashikime specifike për personat e verbër dhe terminologjia e tij nuk është në përputhje me KDPAK dhe legjislacionin shqiptar në zbatim të saj.

Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të terminologjisë që përdoret dhe rregullimit të procedurave në mënyrë më të detajuar, për sigurimin e aksesueshmërisë në mjediset publike dhe në rrugë. Gjithashtu koncepti i aksesueshmërisë për të verbrit duhet të përfshihet dhe të shtjellohet në mënyrë të detajuar.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës” përcakton përfitimet e invalidëve të punës. Statusi ka parashikime për të drejtat dhe përfitimet e grupimit të invalidëve të punës (persona që janë me aftësi të kufizuara vetëm nga shkaqe që lidhen me punësimin e tyre). Terminologjia dhe kërkesat për garantimin e aksesueshmërisë për këtë kategori nuk janë në përputhje me KDPAK.

Ligji ka nevojë të përmirësohet në drejtim të terminologjisë dhe përfshirjes së aksesueshmërisë si e drejtë e invalidëve të punës, sipas përcaktimeve në KDPAK, ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Ligj Nr.8626, datë 22.6.2000 “Per statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe nga çasti i sigurimit. Ligji ka disa përcaktime për aksesin në ndërtesa të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Ligji është miratuar para ratifikimit të KDPAK, ndaj ka pak përputhje me KDPAK. Ligji ka nevojë për përmirësime dhe plotësime për të detajuar procedurat, si edhe forcuar masat dhe sanksionet, sipas përcaktimeve në KDPAK, ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK.

Monitorimi, kontrolli dhe zbatimi

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë,

si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Ligji nuk ka përcaktime mbi aksesueshmërinë për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës. Në nenin 8/c, ligji përcakton ushtrimin e autoritetit me interes publik vendor, duke krijuar struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi. Në ligj nuk ka parashikime për penalitete në rast të moszbatimit të dispozitave të tij.

Ligji nuk është në përputhshmëri me KDPAK.

VKM Nr. 83, datë 28.1.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore”

(Ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018), ka krijuar Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore e cila ka si objekt të punës së saj mbështetjen dhe monitorimin e aktivitetit të qeverisjes vendore në kryerjen e funksioneve të veta. Në këtë kuadër, Agjencia propozon përmirësime ligjore (ligje dhe akte nënligjore) dhe ofron këshillim ligjor e teknik në mbështetje të qeverisjes vendore. Në detyrat e Agjencisë nuk ka përcaktime në lidhje me aksesueshmërinë për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara aspektet e ndryshme të jetës sipas Ligjit Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 83, datë 28.1.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore” duhet të plotësohen me dispozita specifike mbi detyrimet e qeverisjes vendore për zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, si edhe me penalitete e sanksione në rast të moszbatimit të tyre nga strukturat përgjegjëse.

VKM nuk është në përputhshmëri me KDPAK.

Ligji Nr. 8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar sanksionon që projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për strukturat e ndërtuara në Republikën e Shqipërisë, kontrollohen dhe disiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji. Ligji nuk përmban parashikime specifike mbi sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj është i detyrueshëm të zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve të ndërtimit, ndaj duhet të jetë në përputhje me përcaktimet në ligjin Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të terminologjisë dhe të plotësohet me kërkesat e aksesueshmërisë në: (i) përgjegjësitë e zbatuesit të punimeve dhe (ii) dokumentacionin që provon plotësimin e kritereve të aksesueshmërisë sipas nenit 23 të Vendimit Nr.1503, datë 19.11.2008 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” në të cilin përcaktohen rregullat për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Ligji nuk është në përputhshmëri me KDKPAK.

Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve dhe legjisllacionit në fushën e ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore, në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë të decentralizuar dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative. Ligji sanksionon që projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për strukturat e ndërtuara në Republikën e Shqipërisë, kontrollohen dhe disiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji. Ky ligj është i detyrueshëm të zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve të ndërtimit, Ligji nuk ka parashikime për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Edhe pse është rishikuar në vitin 2020, Ligji

vazhdon të mos ketë parashikime specifike mbi kontrollin e aplikimit të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë.

Ligji nuk është në përputhshmëri me KDKPAK.

Vendimi Nr. 893, datë 4.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të mbrojtjes së territorit”

Misioni i këtij inspektorati është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e mjedisit nga ndërtimet e zhvillimet e kundërligjshme apo në shkelje të kushteve të lejeve, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, planifikimit, mbrojtjes së territorit, disiplinimit të punimeve në ndërtim, produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Në vendim mungojnë parashikime specifike për respektimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë.

VKM duhet të përmirësohet në lidhje me misionin e inspektoriatit, duke përfshirë garantimin e aksesueshmërisë gjatë kryerjes së përgjegjësisë. Më specifikisht në funksionet IKMT-së të parashikuara për kryeinspektorin dhe inspektorët, së bashku me sigurimin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në nivel qendror dhe rajonal të ligjeve e akteve nënligjore mbi ndërtimet e kundërligjshme, të shtohet edhe detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në zbatim të nenit 45/1 të ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Vërehet një problem në lidhje me këtë VKM, pasi Inspektorati i Kombëtar dhe Vendor i Mbrojtjes së Territorit është ngritur në zbatim të ligjit “Për prishjen e ndërtimeve të jashtëligjshme” dhe varet nga Ministria e Brendshme. Nuk ka një strukturë të ngritur në bazë të ligjit “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Në se do të mbetet vetëm kjo strukturë, ajo duhet të kontrollojë edhe standardet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e të jetë në zbatim të ligjit “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, pasi në këtë mënyrë garantohej aksesueshmëria. Mungesat apo paqartësitë në legjisllacionin mbi ndërtimet në

lidhje me strukturat e monitorimit vështirësojnë edhe zbatimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Do të ishte e rekomandueshme që së paku, të kishte të përfshirë në këtë strukturë, një specialist për kontrollin e standardeve të ndërtimit e veçanërisht të kërkesave e standardeve të aksesueshmërisë.

Vendimi nuk është në përputhshmëri me KDPAK.

V.2 Aktet ligjore e nënligjore kryesore për Pjesëmarrjen në Jetën Politike dhe Publike

Mundësia për të qenë të përfshirë në jetën politike është një ndër parimet e demokracisë. Marrja pjesë në zgjedhje, marrja e një posti publik, bashkimi me një parti politike, ndjekja e lajmeve apo artikujve politikë është një e drejtë e fituar për personat me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë pengesat ligjore, procedurat administrative, institucionale apo edhe aksesueshmëria e pengojnë personit me aftësi të kufizuara të marrë pjesë në zgjedhje.²⁰ Për ta parë më nga afër të drejtën e tyre për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike, janë marrë këta dokumente ligjor në shqyrtim;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , e ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr. 115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022)

Kushtetuta në nenin 15 të saj parashikon se “2. *Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”.

Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në Kreun III “Liritë dhe të Drejtat Politike” sanksionon se çdo qytetar që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.

Kjo e drejtë, edhe për personat me aftësi të kufizuara, shprehet qartë pasi ata gëzojnë të drejtën e lindur si shtetas të këtij vendi. Por, nëse i referohemi pikës 2 në vijim të këtij neni parashikohet se “2. *Përfshihen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht*.”.

Nëpërmjet parashikimeve të këtij neni konstatojmë se ende dispozitat kushtetuese kanë në fuqi parashikime ligjore që kufizojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuar, në këtë rast të personave me aftësi të kufizuar intelektuale, për ushtrimin e plotë të të drejtave politike dhe publike, konkretisht të drejtën e zgjedhjes.

Heqja e së drejtës për të votuar (e interpretuar si për të drejtën për të zgjedhur, ashtu edhe për t’u zgjedhur), përbën diskriminim të drejtpërdrejtë dhe bazohet në një mendësi të vjetruar, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mendore, intelektuale apo me probleme të shëndetit mendor, janë të paaftë në disa fusha apo në çdo fushë të jetës, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në jetën politike e proceset zgjedhore.

Zotësia juridike për të vepruar nuk përbën më një parakusht për të votuar, e për më tepër aftësia e personit në vendimmarrje nuk mund të jetë justifikim për asnjë përjashtim të personit me aftësi të kufizuar nga ushtrimi i të drejtave të tyre politike, përfshirë të drejtën e votës, të drejtën e pjesëmarrjes apo dhënies së ndihmës gjatë zgjedhjeve apo të drejtën për të marrë pjesë si vëzhgues apo monitorues.

Ndërkohë sa i përket ushtrimit të të drejtës të çdo shtetasi për tu organizuar kolektivisht për çdo qëllim të ligjshëm kjo është një e drejtë e garantuar nga neni 46 i Kushtetutës “1. *Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm*”.

Në linjë me standardet më të mira ndërkombëtare dhe me KDPAK duhet që ligjvënësi të ndryshojë qasjen ndaj personave me aftësi të kufizuar mendore,

²⁰ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2023/747889/EPRS_BRI\(2023\)747889_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2023/747889/EPRS_BRI(2023)747889_EN.pdf)

intelektuale apo me probleme të shëndetit mendor, për të garantuar ushtrimin në mënyrë të barabartë dhe të plotë të të drejtave të tyre politike dhe pjesëmarrjes në jetën publike, kryesisht të fokusuar tek garantimi i ushtrimit të të drejtës të zgjedhjes.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë²¹, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i miratuar në dhjetor 2008 parashikon të drejtat, rregullat dhe udhëzimet për të gjithë qytetarët e Shqipërisë që mund të votojnë ose të votohen.

Në gjithë historikun e ndryshimeve që ka pësuar *Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*, ndryshimet në nenet që ju referohen zgjedhësve me aftësi të kufizuara kanë qenë të pakta krahasuar nga nenet e tjera.

Neni 108 i cili përshkruan të drejtat dhe detyrimet e komisionit për zgjedhësit që nuk votojnë vetë parashikon se:

- Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.
- Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
- Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

- Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
- Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.
- Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.
- Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.
- Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

²¹. <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

Kodi, dhe në veçanti ky nen paraqet probleme serioze që pengojnë personat me aftësi të kufizuara për të votuar në kushte të barabarta me të tjerët. Së pari, neni nuk përfshin të gjithë personat me aftësi të kufizuara, por orienton kryesisht drejt zgjedhjeve për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore kryesisht të fokusuar në kategorinë e personave të verbër. Mbeten të përjashtuar personat që nuk dëgjojnë dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Së dyti, kodi nuk përmban parashikime për sigurimin e aksesueshmërisë si parim, por ndalet më së shumti tek fletët e votimit dhe disa aspekte të infrastrukturës. Sipas Raportit të Monitorimit të hartuar nga institucioni i pavarur i Avokatit të Popullit²² “Për Veprimtarinë E Institucionit Të Avokatit Të Popullit Në Zgjedhjet E Përgjithshme Parlamentare Që U Zhvilluan Në Datë 25 Prill 2021”, vihen re problematikat serioze për sa i përket marrjen e masave të duhura infrastrukturore dhe informative ndaj personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu ky kod nuk parashikon garantimin e mjeteve alternative për të votuar, si votim jashtë qendrave të votimit, përmes teknologjisë dhe të tjera të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Në disa raste nuk ofrohet as përshtatja e arsyeshme që mund të kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara. Më tej, parashikimi për kryerjen e kërkesave nga ana e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim lehtësimin e votimit ditën e votimit përbën barrë të panevojshme për personat me aftësi të kufizuara, pasi ata janë të identifikuar në njësitë vendore tashmë. Kjo kërkesë, përveçse nuk është e njohur, duhet bërë në një kohë shumë më të mëparshme nga data e zgjedhjeve, çka bën që personat mos ta shfrytëzojnë këtë alternativë për ushtrimin e të drejtave të tyre.

Ndalimi i të drejtës për të zgjedhur apo për të votuar për personat me aftësi të kufizuara intelektuale apo me probleme psiko sociale të cilëve i është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykate, është

një e drejtë që nuk garantohet sipas dispozitave kushtetuese dhe rrjedhimisht e ndaluar edhe nga ky Kod. Mos ushtrimi i kësaj të drejte nga kjo kategori e aftësisë të kufizuar bie në kundërshtim me KDPAK, pasi shkel parimet e barazisë dhe jetesës pa barriera.

Në përputhje të pjesshme me Konventën.

Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë²³: Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999, nr. 8781, datë 3.5.2001, nr. 17/2012, datë 16.2.2012, nr.121/2013, datë 18.4.2013, nr.113/2016, datë 3.11.2016; VGJK nr. 69, datë 27.12.2023

KDPAK në nenin 12, paragrafi 1, riafirmon se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit. Kjo garanton që çdo qenie njerëzore të respektohet si një person që gëzon “zotësi juridike” apo personalitet juridik, çka është element thelbësor dhe parakusht për njohjen e “zotësisë për të vepruar”.

Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë që në nenin e parë të tij përkufizon “Zotësinë juridike” duke përcaktuar se “Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.”

Neni 4 i Kodit Civil gjithashtu parashikon që “Personit fizik nuk mund t’i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj”.

Ndër të tjera në Kodin Civil ,përveç faktit tashmë të theksuar, që ende terminologjia e aplikuar në kuadrin ligjor Shqiptar është denigruese për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara dhe ende mëshon drejt qasjes mjekësore, ajo çka është shumë edhe më tepër problematike është qenia ende në fuqi e dispozitave që kufizojnë apo heqin “zotësinë për

²² <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raport%20monitorimi%20per%20zgjedhjet%20vendore%202021.pdf>

²³ <https://qbz.gov.al/previeë/f010097e-d6c8-402f-8f10-d9b60af94744>

të vepruar”, të drejtën e personave me aftësi të kufizuara intelektuale për të qenë të barabartë para ligji, dhe për më tepër për të gëzuar në mënyrë të plotë dhe të barabartë ushtrimin e të drejtave të tyre politike dhe publike.

Në këndvështrimin e standardeve që afirmon KDKPAK “të drejtat civile”, si një bazë fundamentale për të gëzuar më tej të drejtat politike dhe pjesëmarrjes në jetën publike, janë universale e si rrjedhim nuk mund të kufizohen apo ndalohen.

E drejta për tu njohur si mbajtës të drejtash dhe detyrimesh në mënyrë të plotë dhe të barabartë sa i përket pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar është parashikuar shprehimisht nga neni 29 i Konventës “Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër: ... (a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur...”.

Pikërisht Kodi Civil në vijim të sa është cituar më sipër është në mospërputhshmëri me standardet e vendosura nga KDKPAK, pasi në nenin 9 dhe nenin 10²⁴ të tij parashikon shprehimisht heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar për të miturin me moshë katërmbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, si edhe për madhorin, mbi tetëmbëdhjetë vjeç të cilët vlerësohen me vendim gjykatë të pazotë për tu kujdesur për punën e tyre për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor.

Pikërisht heqja apo kufizimi i zotësisë për të vepruar kushtëzon personat me aftësi të kufizuar dhe kryesisht ata me aftësi të kufizuara intelektuale apo psiko-sociale në ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre dhe pjesëmarrjen e barabartë në jetën publike dhe politike. Garantimi i këtyre të drejtave është i ndërlidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave për të kryer veprime juridike, për të disponuar lirisht të ardhurat personale, të drejtën e zgjedhjes së vendbanimit apo rezidencës së tij²⁵. Këto janë dispozita të cilat kërkojnë sigurisht një rishikim dhe përshtatje të plotë me standardet që afirmon KDKPAK në nenet 12, 19 dhe 29 të saj.

Në përputhje të pjesshme me Konventën.

Kodi i Procedurave Administrative të RSh (K.Pr. Administrative)²⁶: Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurave Administrative ka të përcaktuar në dispozitat ligjore “parimin e barazisë dhe mos diskriminimit”²⁷ edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar si parim udhëheqës i organit publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Por vërehet se pavarësisht se K.Pr.Administrative është përmirësuar me miratimin e tij prej vitit 2015, serish ka të parashikuara dispozitat që bien në kundërshtim me Konventën sa i përket parimit të “njohjes së barabartë para ligjit” çka drejtpërdrejt ndikojnë në ushtrimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të politike dhe të pjesëmarrjes në jetën publike të personave me aftësi të kufizuar.

Dispozitat e këtij kodi kryesisht janë në kundërshtim me standardet e KDKPAK, në kontestin e kufizimit të ushtrimit të të drejtave gjatë procesit administrativ që

²⁴. Kodi Civil - Neni 9 “I mituri me moshë katërmbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, që është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t’i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor”.

Neni 10 “Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës”.

²⁵. Kodi Civil - Neni 13 “... Personi të cilin i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.”.

²⁶. <https://qbz.gov.al/previeë/de7df9ee-7c2e-440a-9f46-1929531dc7d1>

²⁷. Neni 17 “Parimi i barazisë dhe i mos diskriminimit”

realizohet nga organi publik për ata persona të cilëve iu është hequr apo kufizuar “zotësia për të vepruar”²⁸ (neni 34; 36), pra kryesisht kategoria e personave me aftësi të kufizuara intelektuale.

Në funksion të përputhjes së legjislacionit Shqiptar me KDPAK sugjerohet gjithashtu rishikimi i dispozitave që janë ende në fuqi në Kodin e Procedurave Administrative për të qenë në linjë me ndryshimet që duhet të pësojnë edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në raport me gjithë dispozitat e tjera ligjore që cenojnë “zotësinë për të vepruar”, në mënyrë që K.Pr.Administrative të jetë në përputhje të plotë me standardet që KDPAK afirmon.

Në përputhje të pjesshme me Konventën.

Ligji Nr. 8580, datë 17.2.2000 ‘Për partitë politike’, i ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001)

Ky ligj, rregullon parimet, rregullat e krijimit apo funksionit të partive politike, duke përfshirë dhe mjetet financiare të tyre.

Në ligj garantohet e drejta e shtetasve, në linjë edhe me nenin 46 të Kushtetutës, për organizmin lirisht të tyre në parti politike nëpërmjet bashkimeve vullnetare, neni 1 “*Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimin të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit*”.

Ligji nuk përmban parashikime specifike për të nxitur krijimin e partive politike nga komunitete të pa favorizuara, duke përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara, po nëpërmjet dispozitave të tij nuk e ndalon këtë të drejtë. Ndalimi apo kufizimi i kësaj të drejte është i parashikuar kryesisht në nenet 5-8²⁹, në të cilën ndër të tjera përcaktohen se ndalohet krijimi dhe regjistrimi i partive politike me karakter antikushtetues, anti ligjor, me karakter ushtarak apo paraushtarak apo në kundërshtim të parimeve demokratike.

Në linja të përgjithshme ky ligj është në përputhje me KDPAK pasi nuk kufizon apo ndalon shprehimisht ushtrimin e të drejtës të personave me aftësi të kufizuara për tu përfshirë në jetën politike dhe publike, nëpërmjet krijimit apo organizmit në parti politike.

Ligji, është në përputhje me konventën

²⁸. Neni 34 “Zotësia për të vepruar në procedurën administrative”;

Neni 36 “Përfaqësuesi i caktuar kryesisht” 1. “Organi publik, që kryen procedurën, e pezullon procedurën dhe i kërkon autoritetit kompetent sipas ligjit, caktimin e përfaqësuesit ligjor ose përkatësisht zëvendësimin e tij, kur konstaton se palës që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar ose ka zotësi të kufizuar për të vepruar nuk i është caktuar ende përfaqësuesi ligjor ose ai ka konflikt interesash me të përfaqësuarin.....”;

Neni 40 “Zotësia për të qenë përfaqësues apo ndihmës” “...Çdo person që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, në bazë të Kodit Civil, mund të veprojë si përfaqësues apo ndihmës, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”.

²⁹. Neni 5 “Veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit”.

Neni 6 “Partive politike u ndalohet të krijojnë organizata me karakter ushtarak ose paraushtarak”.

Neni 7 “Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur:

- organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtarit për të zgjedhur e për t’u zgjedhur;
- në dokumentet e themelimit të partisë përmendet shprehimisht ose, nga përmbajtja e tyre, del se ato janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që ndalojnë krijimin e partive ose strukturave partiake në fushat e institucionet e parashikuara prej tyre;
- partia është krijuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- në dokumentet e themelimit të saj shprehet qëllimi për përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore;
- në dokumentet e themelimit të saj shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, krahinore ose etnike;
- mbështetet në metoda totalitariste, si dhe ka karakter të fshehtë;
- me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.

Neni 8 “Veprimtaria antikushtetuese e partive politike është e ndaluar. Konstatimi i veprimtarisë antikushtetuese të partisë politike dhe ndalimi i saj vendoset nga Gjykata Kushtetuese.”.

Udhëzimi i KQZ Nr.01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”

Udhëzimi kërkon që

- QV të jenë në katet e para të objekteve;
- krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;
- dërgimin në KQZ të listës së votuesve me aftësi të kufizuara dhe votuesve të verbër brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.

Por nuk ka një kërkesë të veçantë për sa i përket aksesueshmërisë dhe masat që duhen marrë për informimin e të drejtës së votës ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 6 përmendet vetëm “të jetë në katet e para të objekteve, që lë shumë hapësirë për interpretim”.

Udhëzimi mbetet i cunguar për sa i përket përgatitjes së hartës së njësisë së qeverisjes vendore. Ky dokument gjithashtu parashikon lehtësira, por nuk detajon çfarë nënkuptojnë këto lehtësira. Është e nevojshme që ai të zgjerohet dhe detajohet për sa i përket pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara. Nuk ka përputhje me Konventën.

Ligj Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi Të Kufizuara” Datë 24/07/2014

Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” në qëllimet e tij parësore ka garantimin e

jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët. Kjo e firmuar edhe nga Neni 5 i ligjit që shpjegon jetesën e pavarur duke ju siguruar personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ky nen është në përputhje me KDPAK pasi u garanton personave me aftësi të kufizuara mjetet ndihmuese dhe parimin e gjithëpërfshirjes në të gjitha sferat e jetës. Shkronja “g” e këtij neni shpreh aksesin në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur, e cilat duhet të sigurohet nga politikat shtetërore.

Në këtë ligj, në kohën e miratimit të tij, për herë të parë u përfshi një nen i veçantë, neni 7 “Vendimmarrja e mbështetur”³⁰ i cili dha jo vetëm një përkufizim mbi këtë regjim të ri juridik

në legjislacionin Shqiptar por edhe orientimin mbi mekanizmat mbështetës që duhet të ngrihen me qëllim ofrimin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje.

Me miratimin e kësaj dispozite vlerësohet se kemi një përputhje të kënaqshme me standardet e KDPAK në regjimin e brendshëm juridik. Në interpretim të dispozitës ligjore të nenit 7 vërejmë se ka nevojë për përmirësim dhe përputhshmëri me standardet që KDPAK afirmon.

Referuar pikës 1 të nenit 7, ku edhe është dhënë përkufizimi i vendimmarrjes së mbështetur, konstatojmë se është përdorur togfjalëshi “interesi i tij më i mirë”, term i cili bie duhet të jetë në përputhje me frymën dhe standardet që KDPAK kërkon të

³⁰. Neni 7 “Vendimmarrja e mbështetur”

1. “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundur kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.
2. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.
3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofritit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

afirmojë. Pikërisht ky term duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “dëshirat dhe preferencat e individit”³¹ që njihet nga KDPAK si një “masë mbrojtëse” dhe që garanton PAK të gëzojnë të drejtën për ushtrimin e “zotësisë për të vepruar” në baza të barabarta me të tjerët.

Gjithashtu neni 15³² i këtij ligji garanton pjesëmarrja dhe përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre në procese të konsultimit publik, kur diskutohen politika në nivel qendror dhe vendor.

Në ligji në tërësinë e tij është në përputhje me standardet e KDPAK referuar të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara

Ligji është në përputhje me Konventën.

Vendim nr. 470, datë 6.7.2022 “ Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”

Ky vendim përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara. pikërisht sipas pikës 2 të këtij vendimi është përcaktuar *kuptimi i vendimmarrjes të mbështetur nëpërmjet ushtrimit të vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara, nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin më të mirë të personit të aftësisë së kufizuara, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.*

Si edhe u shpjegua më lartë në analizimin e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” togfjalëshi “interesi më i mirë i personit me aftësi të kufizuara” vijon të përcaktohet edhe në këtë vendim duke mos e përputhur atë me frymën dhe standardet që KDPAK duke e zëvendësuar të me togfjalëshin “dëshirat dhe preferencat e individit”³³ që njihet nga KDPAK si një “masë mbrojtëse” dhe që garanton PAK të gëzojnë të drejtën për ushtrimin e “zotësisë për të vepruar” në baza të barabarta me të tjerët.

Në këtë vendim vërehet se janë përcaktuar disa kufizime në ushtrimin e regjimit të vendimmarrjes së mbështetur nga personi me aftësi të kufizuara.

Së pari vërehet se mbështetja në vendimmarrje përftohet nga personi me aftësi të kufizuara, që ka aftësi për të marrë vetë vendime dhe kërkon mbështetje (pika 12 e vendimit). Pra mbështetja në vendimmarrje është e kushtëzuar nga këto dy kritere kryesore aftësia për të marrë vendime dhe kur personi me aftësi të kufizuara e kërkon këtë mbështetje. Kriteri i aftësisë për të marrë vendime në këndvështrimin e kuadrit ligjor në fuqi shqiptar e ndalon apo kufizon plotësisht personin të cilit i është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykatë.

Së dyti në këtë vendim, në referim edhe të aneksit që përcakton modelin e “Marrëveshjes për vendimmarrje të mbështetur” vërehet se kjo formë mbështetje është e kufizuar vetëm në tre fusha (pika 4 e Aneks I) në çështjet shëndetësore, shërbime mbështetëse sociale dhe çështje financiare. Në gjithë përmbajtjen e vendimit nuk vërehet të jenë përcaktuar parashikimi

³¹ Paragraph 20 “General comment No. 1 (2014) Article 12: Equal recognition before the law

³² Neni 15 “Organizatave jofitimprurëse me të drejtë për t’u konsultuar”

1. Subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuara, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë:
 - a) individit me aftësi të kufizuara;
 - b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara;
 - c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara;
 - ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në kuptim të nenit 13 të këtij ligji.
2. Çdo organizatë jofitimprurëse, që pretendon se i është mohuar e drejta për t’u konsultuar apo se është përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, ka të drejtë të ankohet, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik

³³ Paragraph 20 “General comment No. 1 (2014) Article 12: Equal recognition before the law

për ushtrimin e vendimmarrjes së mbështetur për ushtrimin e të drejtave politike dhe pjesëmarrjen në jetën politike me të drejta të plota dhe të barabarta, kjo në mënyrë të veçantë e lidhur me kategorinë e personave me aftësi të kufizuara ndijore, intelektuale dhe të shëndetit mendor.

Për sa më sipër shpjeguar, sërish theksojmë domosdoshmërinë e ngritja e regjimit të vendimmarrjes së mbështetur për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara ndijore, intelektuale dhe të shëndetit mendor me qëllim ushtrimin e të drejtave të tyre politike dhe të pjesëmarrjes në jetën publike. Kjo sigurisht që do të kërkonte paralelisht shfuqizimin dhe riformulimin e kuadrit ligjor në përputhje me standardet e KDKPAK sa i takon njohjes së barabartë para ligjit nëpërmjet ushtrimit të “zotësisë të plotë për të vepruar” për të gjithë personat me aftësi të kufizuara”, duke përfshirë këtu Kushtetutën e RSH, Kodin Civil, rrjedhimisht Kodet e Procedurave, e në vazhdim aktet ligjore dhe nënligjore të ndërlidhura.

VKM është në përputhje të pjesshme me Konventën.

Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Në parimet e ligjit citohet... 2. *Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.* Kjo tregon që si ligj nuk është i përjashtuar nga kërkesa e parimit të gjithëpërfshirjes dhe barazisë në dhënie informacioni apo pjesëmarrje.

Gjithashtu për sa i përket konsultimit publik parashikohet që: *2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.*

Në këtë pikë duket qartë që pjesëmarrja e organizatave ose personave me aftësi të kufizuara nuk është e përjashtuar. Ato duhet të caktojnë Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik. Në rastin e mbledhjeve të këshillave bashkiakë ose publikimit të akteve të këshillave bashkiakë, publikimi jo gjithmonë është në një gjuhë të thjeshtë apo formate të aksesueshme, për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të jenë më aktivë.

Ky ligj, ka disa element të mos barazisë, pasi nuk ka rregulla të qarta për sa i përket aksesit në këto institucione dhe marrjen e informacionit. Çdo gjë mbetet në komunikimet individuale të secilit. E njëjta përgjegjësi bie edhe në rastin e zgjedhjeve, kur në përgjegjësi të kryetarëve të njësive vendore është përgatitja e listave dhe vendet ku do të mbahen zgjedhjet.

Ligji është në përputhje të pjesshme me Konventën.

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik 146/2014

Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politik-bërës dhe vendimmarrëse nga organet publike. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara, për sa i përket projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

Qeveria Shqiptare ka ngritur platformën “online” për njoftimet dhe konsultimet publike të çdo institucioni, qoftë ministri apo agjenci vartëse. Ky ligj është në pjesërisht në përputhje me Konventën, pasi faqja e ngritur për këtë qëllim, nuk është plotësisht e përshtatur për t’u informuar dhe konsultuar persona me aftësi të kufizuara shqisore, të komunikimit dhe intelektuale.

Mosnjohja dhe moszbatimi i legjislacionit që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë aksesueshmërinë, bën që edhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik të bëhet i paaksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara që duan të marrin pjesën në jetën publike dhe politike.

Ligji është në përputhje të pjesshme me Konventën.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 10 221, datë 04.02.2010 i ndryshuar me ligjin 140/2020

Ky ligj i hartuar që në 2010, vjen në përputhje me KDKPAK në lidhje me parimin e mbrojtjes nga diskriminimi që zbatohet për të drejtën për të votuar. Neni 9, 'Pjesëmarrja në politikë' sanksionon që ..., "ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji". Ndër shkaqet që mund të përbëjnë diskriminim të nenit 1, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është dhe aftësia e kufizuar, kështu që mund të themi që ky ligj është në përputhje me konventën.

Në përputhje me Konventën

Ligji nr. 119/2014 date 18.9.2014 Për të drejtën e informimit;

Ky ligj është i ngjashëm në qëllim me ligjin për informimin dhe konsultimin publik, ku synimi është njohja e informacionit publik që duhet të jepet nga institucionet me detyrimin ligjor për t'u përgjigjur.

Ligji për të drejtën e informimit nuk përmban dispozita të veçanta të cilat rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë informacionin për personat me aftësi të kufizuara por në përputhje me këtë ligj çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik në formën dhe formatin që mundëson akses të plotë të përmbajtjes të dokumentit, neni 3 "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."

Pikërisht përmbajtja e kësaj dispozite ligjore është një garanci e mjaftueshme për të kërkuar nga çdo institucion publik apo privat, në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit, aksesin nga çdo person me aftësi të kufizuar në informacion në formën dhe formatet e përshtatshme.

Ligji është në përputhje me Konventën.

Ligji Nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe Ligji Nr. 80/2021 " Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse

Ligji për organizatat jo fitimprurëse dhe ligji për regjistrimin e tyre përcaktojnë rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut.

Ligjet nuk parashikojnë dispozita që përmendin drejtpërdrejtë organizatat që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar por kanë të parashikuar garanci të mjaftueshme ligjore për të garantuar të drejtën e ushtrimit nga personat me aftësi të kufizuar për tu organizuar dhe për të marrë pjesë me të drejta të plota dhe të barabarta në veprimtaritë publike, përfshirë organizimin në shoqata, qendra apo fondacione.

Ligjet janë në përputhje me Konventën.

Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit"

Ky ligj rregullon statusin ligjor dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Ligji përmban parashikime specifike vetëm për personat e verbër dhe terminologjia e tij nuk është në përputhje me KDKPAK dhe legjisllacionin shqiptar në zbatim të saj.

Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të terminologjisë që përdoret dhe rregullimit të procedurave në mënyrë më të detajuar për sigurimin e pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike të këtij komuniteti.

Ligji është në përputhje të pjesshme me Konventën.

Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës"

Statusin e invalidit të punës e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 12 të tij, parashikohet që: *“Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 për qind të çmimit të biletës. Ministria që mbulon kulturën, rininë e sportet nxjerr aktet nënligjore përkatëse”*. Sa më sipër, është një masë nxitëse për të nxitur pjesëmarrjen në jetën publike.

Terminologjia dhe kërkesat për garantimin e aksesueshmërisë në këtë ligj nuk janë në përputhje me KDKPAK, çka rekomandon përmirësime në këtë drejtim.

Në nenin 17 të tij parashikohet që: *“Gjatë përgatitjes së akteve ligjore e nënligjore dhe të programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalidëve. Shoqatat që mbrojnë interesat e invalidëve, marrin pjesë në mbledhjet për diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që prekin drejtpërdrejt a tërthorazi interesat e invalidëve”*. Ky është një model pozitiv në drejtim të mundësimin të përfshirjes e pjesëmarrjes.

Ligji është në përputhje të pjesshme me Konventën

Plani Kombëtar i Veprimit i Aftësisë së Kufizuar 2021-2025

Në fushën e veprimit “ Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike” PKVPAK përcakton si qëllim politikash garantimin e përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimin e mbrojtjes së interesave të tyre, përmes:

Rritjes së numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënies së mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje

Rritjes së përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike dhe promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara.

Rritjes së mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument është në përputhje me Konventën

VI. KUADRI INSTITUCIONAL

VI.1. Aksesueshmëria

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aksesueshmërisë janë të përcaktuara sipas në legjislacionit të posaçëm për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen në jetën politike, por edhe të legjislacionin e përgjithshëm të ndërtimeve. Në të gjitha ligjet apo vendimet janë parashikuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre e si rrjedhojë, secili institucion ka përgjegjësi diku më të drejtpërdrejta dhe të posaçme e diku tjetër më pak të tilla.

Më poshtë rendisim institucionet e ngarkuara me përgjegjësi për zbatimin e aksesueshmërisë, duke filluar nga institucionet e posaçme për të vijuar me ato me natyrë të përgjithshme. Gjatë analizës ligjore janë evidentuar problematikat e këtyre institucioneve në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e aksesueshmërisë.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është organ këshillimor që është ngritur me VKM Nr. 48, datë 21.1.2015 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e këshillit kombëtar për aftësinë e kufizuar" në zbatim të ligjit Nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Ata emërohen nga Kryeministri me propozim të gjithë organizatave dhe lirohen po me urdhër të Kryeministrit. Përzgjedhja e tyre bëhet

duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik i aftësisë së kufizuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar. KKAK ka këto detyra (neni 3):

- Shqyrton dhe miraton planet kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Shqyrton zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për Këshillin e Ministrave.
- Këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- I propozon ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- Vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

- Analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Nëpunësit që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara

Në zbatim të ligjit Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” në çdo institucion caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar, ndërkohë që në organet e qeverisjes vendore, emërohet një ose disa nëpunës, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar.

Nëpunësi që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikën e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Ky detyrim nuk është zbatuar në të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, por edhe atje ku është zbatuar, nëpunësi është i ngarkuar njëkohësisht edhe me përgjegjësi të tjera. Një gjë e tillë ka ulur efikasitetin e punës në drejtim të zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë.

Avokati i Popullit

Avokati i Popullit shqyrton ankesat ose kërkesat: ndaj organeve të administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, ndaj policisë, shërbimit sekret, burgjeve, forcave të armatosura dhe pushtetit gjyqësor si dhe ankesa apo kërkesa të tjera. Ai bashkëpunon me organizatat joqeveritare si dhe bën studime në fushën e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Avokati i Popullit monitoron zbatimin e Ligjit Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” në përputhje me

Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8328, datë 30.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar. Avokati i Popullit do të monitorojë gjithashtu edhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Aksesueshmërisë për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është institucion i pavarur, i cili shqyrton dhe vendos për ankesat individuale për rastet e diskriminimit. Ai bën sondazhe, publikon raporte dhe rekomandime, përfshi rekomandime legjislative, si edhe kryen aktivitete ndërgjegjësuëse për parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Gjithashtu, Komisioneri mund të bëjë hetime ex officio në rast se ka informacione për sjellje apo veprime diskriminuese ndaj personave të akomoduar në institucion. Komisioneri, në rast se gjen shkelje, mund të vendosë gjoka .

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim do të monitorojë gjithashtu edhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Aksesueshmërisë për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

Komisionet për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara. Këto komisione

ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta. Pranë kësaj ministrie funksionon edhe Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar.

Ankesat për shkeljen e së drejtës për aksesueshmëri në shërbime publike, mund të paraqiten nga çdokush apo çdo subjekt edhe pranë Ministrit të MShMS.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara". VKM e sipërcituar detyron të gjithë institucionet që të hartojnë Planin e Veprimit për eliminimin e barrierave, i cili duhet të miratohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të Vendimit. Realizimi progresiv i tij duhet të fillojë 12 muaj nga data e miratimit të këtij plani. Në rastet kur ISHPSHSH konstaton shkelje të këtij vendimi mund të marrë masa përkatëse sipas kompetencave të veta dhe duhet të njoftojë MShMS. MShMS nga ana tjetër për rastet e moszbatimit të rregullave u kërkon subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigjojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se 1/2 e afatit të parashikuar në planifikim.

Moszbatimi i rregullave të vendosura në këtë vendim përbën shkak për dhënien e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shërbimi Social Shtetëror

Shërbimi Social Shtetëror kryen funksionet e veta pranë MShMS dhe ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Këtë mision e realizon nëpërmjet:

- Administrimit të Shërbimeve Shoqërore për individët në nivel kombëtar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- Kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën; ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e shoqërore;
- Administrimit të Regjistratit Elektronik Kombëtar për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe
- Monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar.

Drejtoria e Monitorimit në Shërbimin Social Shtetëror

Kjo drejtori funksionon pranë MShMS dhe kryen monitorim të standardeve të shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara.

Inspektoratit kombëtar i mbrojtjes së territorit

Misioni i këtij inspektorati është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e mjedisit nga ndërtimet e zhvillimet e kundërligjshme apo në shkelje të kushteve të lejeve, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, planifikimit, mbrojtjes së territorit, disiplinimit të punimeve në ndërtim, produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore sipas neneve 9 e 9/1, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për

inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar. Ky inspektorat është ngritur dhe kryen funksionet e veta në zbatim të ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë fokusi i tij është në mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Inspektorati nuk ka përgjegjësinë dhe kapacitetet/specialistë për të kontrolluar zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Inspektorati i mbrojtjes së territorit të njësisë vendore

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit brenda territorit administrativ të kësaj njësie, si edhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

- vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të liçencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

- përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky inspektorat është ngritur dhe kryen funksionet e veta në zbatim të ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë fokusi i tij është në mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Inspektorati nuk ka përgjegjësinë dhe kapacitetet/specialistë për të kontrolluar zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Agjencia e zhvillimit të territorit

Agjencia kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit. Në këtë kuadër, Agjencia ka përgjegjësitë për të:

- kryer monitorimin e zhvillimeve në territor, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, për të përgatitur raportin përkatës dhe për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit e autoritetet e tjera që kanë përgjegjësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- ofruar mbështetje ndaj njësisë të qeverisjes vendore në proceset e tyre të zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Agjencia siguron gjithashtu që dokumentet e kontrollit të zhvillimit, në nivel qendror e vendor, të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet e miratuara të planifikimit në çdo nivel.

Agjencia Për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

- respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Agjencia nuk ka përgjegjësinë dhe kapacitetet/specialistë për të kontrolluar zbatimin në territor të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Instituti i Ndërtimit

Ky institut është krijuar me Urdher të Ministrit me Nr. 225 dt 29.06.2004 “Per krijimin e institutit e ndertimit”, si rezultat i bashkimit të Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit (ISTN), Instituti i Studimeve e Projektmeve Hidroteknike (ISPH) dhe aktivitetit të ish Institutit të Studimeve e Projektmeve të Ujësjellës Ndërtime (ISPUN) në varësi të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, me seli në Tiranë.

Objekti kryesor i punës së institutit të Ndërtimit është kryerja e veprimtarisë kërkimore shkencore, aplikative zhvillimore dhe projektuese në fushën e ndërtimit, si dhe kryerja e veprimtarive shkencore e teknologjike për të tretë të tilla si oponenca, ekspertiza, kurse kualifikimi, vlerësime konformiteti dhe kontrole për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës. Inspektorati nuk ka përgjegjësinë dhe kapacitetet/specialistë për të kontrolluar zbatimin e kërkesave

dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

AKSHI është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë në varësi të Kryeministrit. Ndër të tjera ky institucion është përgjegjës për: Promovimin e teknologjive të reja, hartimin e strategjive dhe planveprimeve për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOVm dhe zhvillimin e politikave e strategjive në sektorin e shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe nxit investimet në fushë. Gjithashtu, AKSHI bashkërendon programe në fushën e SHI-së, si edhe jep kontribut në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. Një anëtar i AMA është person që merret me çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuara e grupe të tjera vulnerabël. AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron: që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve, ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias, ofrimin e shërbimeve të shumëllojshme dhe pa pagesë, realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e dëgjuesve e shikuesve dhe në veçanti për personat me nevoja të veçanta shqisore;

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

Gjykatat

Personat me aftësi të kufizuara, përveç institucioneve të identifikuar më sipër kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, pasi kanë ezaruar procedurat e ankimit në institucionet e mësipërme për shkeljen e të drejtave.

VI.2. Pjesëmarrje në Jetën Politike dhe Publike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre. Në varësinë e tij janë Komisioni Zonal për Administrimin e Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komisioni I Qendrës së Votimit (KQV). KZAZ-ja përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, regjistron dhe verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zone, administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja, garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit etj.

Përmes sekretarit KQV përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, për materiale zgjedhore, protokollimin e kërkesave, ankesave dhe njoftimeve drejtuar KQV-së etj.

Organet e Qeverisjes Vendore

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka në juridiksion zyrën përkatëse të gjendjes civile shpall dhe miraton listat e hartuara nga kjo e fundit. Ai kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Ai gjithashtu shpall vendndodhjen e qendrave së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe vendos krijimin qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zone apo bashkimit e qendrave nëse ky është rasti.

Sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Vetëqeverisjen Vendore (2023-2030), përshkrimi i personave me aftësi të kufizuara është vetëm për sa i përket marrjes së shërbimeve sociale. Gjithashtu, e identifikuar në këtë strategji: *NJQV-të kanë detyrim të raportojnë çdo 6 muaj pranë MSHMS-së mbi realizimin e aksesueshmërisë, por për këtë detyrim nuk raportohet.*³⁴ Bashkitë kanë për detyrë të ofrojnë një informacion më të plotë. Mbetet si detyrë për bashkitë nga kjo strategji që *“Bashkitë duhet të zhvillojnë përgjegjësitë e tyre duke filluar që nga vlerësimi i nevojave, planifikimi i buxheteve dhe kryerja e investimeve për të siguruar mjedise e transport të aksesueshëm, rritjen e kapaciteteve për dhënien e shërbimeve bazë për personat me aftësi të kufizuara.”* Por Akoma nuk ka hapa konkrete në këtë pikë.

Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion i pavarur i administratës publike.

³⁴. file:///Users/nesila.koka/Library/CloudStorage/OneDrive-Personal/ADRF%20service%20contract/Legislation%20/RENJK_567_SKNDQV-2023-2030.pdf

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes; urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale; jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre/ Është institucioni përgjegjës për garantimin e aksesit të barabartë në informacion por edhe të mënyrës sesi informacioni duhet të ofrohet në mënyrë të kuptueshme për gjithsecilin. Sipas Raportit vjetor për 2022³⁵ vihet re delegimi i detyrës për dhënien e informacionit nga një institucion në tjetrin edhe pse informacioni i kërkuar ishte i disponueshëm.

Kuvendi i republikës së Shqipërisë:

Kuvendi është organi, i cili vë në jetë (e bën reale) një nismë legjislative (e drejta për të propozuar një ligj), duke ushtruar kështu pushtetin që atij i është dhënë me Kushtetutë, pushtetin legjislativ. Të drejtën për të iniciuar një nismë të tillë në më të shumtën e rasteve e ushtron qeveria dhe kjo ndodh sidomos atëherë kur kjo qeveri gëzon shumicën parlamentare dhe si rrjedhojë ekziston probabiliteti më i madh që të arrihet në një rezultat të kënaqshëm të kësaj nisme. Por të drejtën për të iniciuar një nismë ligjvënëse e ka edhe çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës (neni 81 i Kushtetutës).

Ai funksionon në bazë të një organike dhe ka në përbërje të saj seksione të veçanta për transparencën dhe pjesëmarrjen e komunitetit në takime konsultuese si p.sh.: *Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit* ndjek dhe mbikëqyr punën e shërbimeve të Kuvendit të ngarkuara me garantimin e transparencës së veprimtarisë së deputetëve, komisioneve e shërbimeve të Kuvendit ndaj publikut dhe institucioneve. Sekretariati mbikëqyr punën për aplikimin e përdorimit të teknologjive të avancuara të informacionit (e-parlament), për modernizimin e

funksioneve të shërbimeve që ofron administrata, si dhe për mbështetjen e monitorimit të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj. Sekretariati mbikëqyr gjithashtu punën për informimin e publikut për veprimtarinë e Kuvendit dhe institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj.

Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

- i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji;
- bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- dërgon kërkesën për informim te një Autoritet tjetër Publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultoni se Autoriteti Publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar; (kjo pjesë lë hapësirë për keqinterpretim dhe për delegim më të shpeshtë të detyrave me justifikimin që nuk e zotëron informacionin e kërkuar)
- verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13 të këtij ligji;

Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjat "a", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", "h", "i", "j" dhe "k", të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji dhe konkretisht:

³⁵ <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>

- refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150,000 deri në 300,000 lekë;
- moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 50,000 deri në 100,000 lekë;

Gjykatat

Janë institucionet vendimmarrëse sidomos për rastet e ngritjes ose regjistrimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara, përveç institucioneve të identifikuara më sipër kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, pasi kanë ezaruar procedurat e ankimimit në institucionet e mësipërme për shkeljen e të drejtave.

VII. PËRFUNDIME

Edhe pse Shqipëria ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e legjislacionit, në kuadrin e harmonizimit me KNDPAK, nga analiza rezulton që legjislacioni akoma ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Legjislacioni shqiptar mbi pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike përputhet në një nivel të kënaqshëm me KDPK, edhe pse zbatimi dhe monitorimi i kuadrit ligjor ka mangësi.

Vlen të theksohet se ka ende nevojë për përmirësime të neneve në Kodin Zgjedhor dhe në kudin ligjor të analizuar në këtë raport për sa i përket ushtrimit të drejtës për të votuar nëpërmjet pjesëmarrjes në proceset zgjedhore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë e partive politike, kjo veçanërisht e lidhur me kategorinë e personave me aftësi të kufizuara ndijore, intelektuale dhe me probleme psiko sociale. Tepër problematike është qenia ende në fuqi e dispozitave që kufizojnë apo heqin “zotësinë për të vepruar”, të drejtën e personave me aftësi të kufizuara intelektuale për të qenë të barabartë para ligji, dhe për më tepër për të gëzuar në mënyrë të plotë dhe të barabartë ushtrimin e të drejtave të tyre politike dhe publike. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë sa duhet në Këshillin Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar, si edhe në Komisionet e Komitetet të ngritura për hartimin e politikave dhe vendimarrjen mbi jetën e personave me aftësi të kufizuara

Mes institucioneve ka një nivel të rritur ndjeshëm, të ndërgjegjësimit në lidhje me detyrimet që ato kanë përkundrejt personave me aftësi të kufizuara për sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën politike e publike.

Legjislacioni shqiptar mbi aksesueshmërinë përputhet në një nivel të kënaqshëm me KDPK dhe Komentin e Përgjithshëm të Komitetit të KDPK³⁶ në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë. Mes institucioneve ka një nivel të rritur ndjeshëm, të ndërgjegjësimit në lidhje me detyrimet që ato kanë përkundrejt personave me aftësi të kufizuara për sigurimin e aksesueshmërisë. Miratimi i legjislacionit të avancuar në lidhje me aksesueshmërinë, gjatë viteve të fundit, duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me veprimtari thelbësore siç janë promovimi dhe trajnimet, për të siguruar zbatimin efektiv të tij.

Por gjatë analizës evidentohet fakti se ligjet e përgjithshme mbi ndërtimet, infrastrukturën rrugore apo transportin dhe strehimin nuk kanë përfshirë çështje të personave me aftësi të kufizuara dhe konkretisht aksesueshmërinë që atyre duhet t'i garantohet. Duket sikur ligjvënësit janë mjaftuar me legjislacionin e posaçëm, por qartazi, nga situata aktuale e aksesueshmërisë, kjo është e pamjaftueshme. Nevojitet që në legjislacionin e përgjithshëm të rrymëzohet aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara dhe të ketë referencë të legjislacionit të posaçëm. Duhet theksuar që kuadri ligjor i përgjithshëm për ndërtimet mbetet i fragmentuar dhe apatik në shumë drejtime, sidomos përsa i përket institucioneve që e menaxhojnë atë. Kjo patjetër që ka pasur ndikimin e vet për zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me realizimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Një tjetër fakt i theksuar ndjeshëm në raport, lidhet me terminologjinë e aplikuar në kuadrin ligjor Shqiptar, e cila në shumë raste është denigruese për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara dhe

³⁶ Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 22 Maj 2014: http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/2&Lang=en

ende mëshon drejt qasjes mjekësore. Evidentohet gjithashtu mungesë në harmonizimin e përkufizimit të aftësisë së kufizuar dhe përshtatjes së arsëyeshme në gjithë kuadrin ligjor e politik me referencë aftësinë ë kufizuar.

Mbetet shqetësues niveli i ulët i njohjes të legjislacionit, mekanizma shumë të dobët të monitorimit, ndëshkueshmëri e ulët (edhe për shkak të mungesës së penalteteve) dhe mungesë e raportimit të shkëlqejve së të drejtave nga vetë personat me aftësi të kufizuara.

Zbatueshmëria e kuadrin ligjor mbetet problemi kryesor dhe çënohet kryesisht nga mosrealizimi i detyrimeve për sa i takon:

- alokimit të buxhetit të përshtatshëm për sigurimin e aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike; mjetet shumë të kufizuara financiare renditen si një nga problemet e para për mosrealizimin e aksesueshmërisë dhe të drejtës për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike dhe hapave që duhen ndjekur për sigurimin e saj.³⁷
- mekanizmave efektivë të monitorimit apo vendosjes së penalteteve, edhe për shkak se përgjegjësitë për monitorimin, kontrollin dhe zbatimin janë të fragmentarizuara në disa institucione.

Sikurse u theksua gjatë analizës së kornizës ligjore, MSHMS është institucion i papërshtatshëm për adresimin e të drejtës së aksesueshmërisë në raste shkëlqesh. Është i domosdoshëm, ose forcimi i ISHPSHS, ose ngritja e një strukture të re të posaçme, për shkak të veçorive që ka aksesueshmëria.

Ndërsa në rastin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që siguron funksionimin e pjesëmarrjes në jetën politike, mungon fuqia kompetenca për të sanksionuar institucionet e vetëqeverisjes vendore në marrjen e masave të duhura për garantimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së votës nga Personat me Aftësi të Kufizuara dhe për të garantuar që informacioni për zgjedhjet të jetë marrë nga të gjithë në një mënyrë të kuptueshme.

Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka fuqi detyruese ndaj partive politike për të kërkuar bërjen e programeve të tyre në formate të thjeshtëzuara e në formate të tjera alternative, të cilat do të mund të prezantohen ndaj gjithë komunitetit, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara.

- rritjes së kapaciteteve për zbatimin e ligjeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara. Sigurimi i trajnimeve për të dyja tematikat do të ndihmonte në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimin.

³⁷. Këto gjetje gjatë takimeve dhe analizës së kuadrin ligjor konfirmohen edhe nga Raporti i monitorimit: Zbatimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, I realizuar nga FSHDPAK në vitin 2017.

VIII. FORMA E PËRMBLEDHUR E ANALIZËS SË KORNIZËS LIGJORE PËR AKSESUESHMËRINË DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

	Niveli i qeverisjes	Kuadri ligjor ekzistues	Zgjidhjet që ofron legjislacioni	Përputhje/mospërputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	Ndryshimet e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë
Aktet ligjore e nënligjore kryesore për aksesueshmërinë					
1	Nivel Kombëtar	Ligji kuadër me Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Ligji synon të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; të përcaktojë përgjegjësitë e strukturave publike dhe jobpublike, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara. Neni 3 përkufizon termin "Përshtatje e arsyeshme" si "modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme". Neni 14 "Financimi i aksesueshmërisë", përcakton alokimin e fondeve për garantimin e aksesueshmërisë. Ligji krijon Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) Ligji parashikon Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për monitorimin e ligjit.	Ligji ka përputhje me parimet e KDPAK Mungojnë aktet nënligjore mbi mënyrën e planifikimit të fondeve nga MSHMS dhe përdorimin e tyre nga institucionet. Mungojnë aktet nënligjore (rregullore dhe urdhëresa) mbi veprimtarinë e KKAK dhe modalitetet e bashkëveprimit me institucionet e tjera. Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e kryejnë monitorimin në përputhje me fushën e zbatimit të ligjeve sektoriale të tyre. Në ligj mungojnë penalitetet dhe sanksione në rast të mos zbatimit të dispozitave të ligjit	Fryma e ligjit nuk ka nevojë për përmirësime, por ligji duhet të përmirësohet për të rritur efikasitetin e zbatimit të tij. Neni 14 ka nevojë për plotësime me akte nënligjore mbi planifikimin e fondeve nga MSHMS dhe përdorimin e tyre nga institucionet. Të miratohen rregullore dhe urdhëresa mbi veprimtarinë e KKAK. Të saktësohet mekanizmi për monitorimin e ligjit Të plotësohet ligji me penalitete e sanksione;
2	Nivel Kombëtar	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"	VKM detajon përkufizimet dhe parimet e vendosura nga Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe përcakton masat për mënjanimin e pengesave në mjedis infrastrukturë dhe informacion e komunikim për personat me aftësi të kufizuara. VKM siguron karakterin gjithëpërfshirës të aksesueshmërisë sipas KDPAK. VKM përcakton institucionet përgjegjëse, planifikimin për zbatimin e aksesueshmërisë dhe/ose eliminimin e pengesave, si edhe strukturat përgjegjëse për monitorimin e tyre në nivele të ndryshme (qendror MSHMS; rajonal ISHPSHSH) dhe KKAK. VKM ngarkon (ISHPSHSH) Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për monitorimin e zbatimit e tij dhe aplikimin e penaliteteve	Vendimi në përgjithësi respekton kërkesat e nenit 9 të KDPAK. Proçedura e monitorimit për zbatimin e VKM kanë rezultuar jo efektive (nuk raportohen raste të shkeljeve pranë MSHMS dhe KAAK). Nuk ka përcaktime të sakta mbi aplikimin e penaliteteve.	VKM ka vend për përmirësime në drejtim të rritjes së efikasitetit për zbatimin e tij. Duhet të përcaktohen saktë përgjegjësitë e strukturave për monitorimin dhe zbatimin e VKM. Penalitetet duhet të rishikohen sipas Ligjit Nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
3	Nivel Kombëtar	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 874, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal	VKM përcakton rolin dhe detyrat e ndihmës personal në mbështetje të personit me aftësi të kufizuara për të kapërcyer pengesat në jetën e përditëshme, si barrierat fizike ashtu edhe ato të komunikimit dhe ndërveprimit. Përcaktohet gjithashtu edhe ndërtimi i marrëdhënies sociale ndërmjet palëve. Ndihmësi personal përzgjidhet dhe paiset me program të detajuar nga Administratori shoqëror pranë njësisë administrative. Në pjesën më të madhe të njëjësive vendore (Bashkia e Tiranës bën përjashtim) nuk funksionon zinxhiri për përfitimin e ndihmesës personale (administrator social, ndihmës personal dhe Person me Aftësi të Kufizuara)	VKM është në përputhje të pjesëshme me KDPAK. Në VKM nuk përcaktohen masat për ndërtimin e marrëdhënies financiare ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të shërbimit dhe sigurimeve shoqërore.	VKM ka vend për përmirësime, në drejtim të plotësimit të zinxhirit të shërbimit (administrator social, ndihmës personal dhe PAK) me qëllim zbatimin korrekt të këtij shërbimi. Duhet të përcaktohet edhe mënyra se si do të ndërtohen marrëdhëniet financiare ndërmjet ndihmës personal me përfituesin si edhe me sigurimet shoqërore

4	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 82/2021 datë 4.06.2021 "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar",	Ligji përcakton "Interpretuesin ose interpretin e gjuhës së shenjave" si të gjithë përkthyesit e tjerë. Ligji i mundëson komunikimin personave që nuk dëgjojnë dhe/ose nuk flasin, pjesërisht ose plotësisht, nga gjuha e shenjave në gjuhën e folur dhe të shkruar shqipe.	Ligji ka përputhje me KDPAK.	
5	Nivel Kombëtar	VKM 470 datë 6. 07. 2022 "Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara"	VKM përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara për të ushtruar të drejtën e tyre për të zgjedhur mënyrën e jetesës, pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në aktivitetet e jetesës së përditshme dhe marrjen e vendime për mbështetje në formën më efektive. Vendimi ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Kulturës, bashkitë dhe njësitë administrative për zbatimin e këtij vendimi.	Në VKM nuk vërehen mospërputhje me KDPAK.	
6	Nivel kombëtar	Vendimi Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".	Rregullorja përcakton kërkesat, standardet dhe rregullat për sigurimin e aksesueshmërisë dhe eliminimin e barrierave kryesisht në mjedis (ndërtesa dhe infrastrukturë), për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore (të shikimit e të dëgjimit).	VKM është miratuar para miratimit të KDPAK, ndaj nuk i përmbahet kuptimit gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara që përcakton KDPAK. Si rrjedhojë, edhe terminologjia e përdorur në rregullore nuk është në përputhje të plotë me KDPAK. Përfshin të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar.	Rregullorja duhet të ripunohet në përputhje me KDPAK dhe legjislacionin mbi aksesueshmërinë.
7	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Ligji rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mos diskriminimit në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Ligji përkufizon "Mohimi i përshtatjes së arsyeshme" si formë diskriminimi.	Në ligj nuk evidentohen mospërputhshmëri me KDPAK, por disa probleme në lidhje me efikasitetin e zbatimit të tij (lehtësira me barrën e provës, me afatet për marrjen e vendimeve në përgjigje të ankesave, sigurimin e prokurës për organizatat me interesa legjitime dhe kthimin e Vendimit të KMD-së në titull ekzekutiv).	Në ligj ka vend për përmirësime në lidhje me shkurtime dhe afateve procedurale për ankesat, eliminimin e prokurës kur jepet pëlqimi i personit. Të përforcohet përfshirja e konceptit të diskriminimit të shumëfishtë në propozimet që ky institucion do të dërgojë në Kuvend.
8	Nivel qendror dhe vendor	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 – 2025, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 276, datë 12.05.2021	PKVPAK ka si qëllim të vjojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social ekonomike të vendit, në përmbushje të detyrimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. PKV përcakton objektivat kryesore: (i) përmirësimi i aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara; (ii) aksesueshmëria në transportin publik dhe (iii) përmirësimi i aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara. Monitorimi i zbatimit të këtij Plani Veprimi do të kryhet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimin dhe Avokati i Popullit.	Nuk vërehen mospërputhje të Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara me KDPAK.	

9	Nivel qendror dhe vendor	Vendim Nr. 436, datë 22.6.2022 "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara"	VKM përkufizon "Shërbimet e jetesës së pavarur për PAK" si shërbime që ofrohen për rritjen e mundësive të tyre për zgjedhje dhe liri të barabarta me personat e tjerë në shoqëri dhe integrimin social. Vendimi përcakton detyrimin që kanë institucionet për të garantuar jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara. Në Kreu II, 2 VKM përcakton strukturat dhe procedurat për të garantuar përfitim të shërbimeve të përshtatjeve të arsyeshme në të gjitha fushat. Kreu III, ankimimi përcakton të drejtat e ankimimit të PAK në rastet e moszbatimit të përshtatjes. Kreu IV, ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë aktet nënligjore dhe udhëzime për zbatimin e VKM nga strukturat përgjegjëse.	Nuk vërehen mospërputhje të VKM me KDPAK, përveç detyrave që ka vendosur vetë Vendimi.	Vendimi ka nevojë të plotësohet me udhëzimet e nevojshme për zbatimin e tij.
10	Nivel qendror dhe vendor	Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10. 2020	Kodi Zgjedhor përcakton procedurat për zhvillimin e procesit zgjedhor, përgatitjen e materialeve zgjedhore, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacioneve për publikun etj. Neni 108 "Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë", ka disa përcaktime për PAK fizikë dhe PAK të shikimit	Kodi nuk është në përputhje me KDPAK. Kodi nuk garanton pjesëmarrjen në zgjedhje të të gjitha kategorive të PAK dhe nuk detyron strukturat përgjegjëse të krijojnë mjedise dhe lehtësira që personat me aftësi të kufizuara, të ushtrorin të drejtë e tyre për të votuar. Neni 108 "Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë", nuk garanton pjesëmarrjen e të gjitha kategorive të PAK në zgjedhje.	Ky kod ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime: në Nenin 22 "Kompetenca të KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje"; Nenin 23 "Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimarrja" duke përfshirë përdorimin e teknologjisë së informacionit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara; në Nenin 79 "Afishimi i materialeve propagandistike"; Nenet 80-84 e 85 "Mbi transmetimet televizive" duke përfshirë saktësime mbi aksesin e PAK në materialet zgjedhore dhe transmetimet televizive; Nenin 93 "Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave" duke përcaktuar kërkesat për aksesueshmërinë e këtyre qendrave për personat me aftësi të kufizuara; Neni 108 "Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë", duke përfshirë të gjitha kategoritë PAK.

11	Nivel qendror dhe vendor	Udhëzimi i KQZ Nr. 01, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet"	Udhëzimi ka disa parashikime në lidhje me vendndodhjen e qendrave të votimit (në katet e para të ndërtesave) dhe krijimin e disa lehtësirave për PAK.	VKM nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Mungojnë dispozita detyruese për aksesueshmërinë dhe krijimin e lehtësirave për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuara.	VKM ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe lejisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
12	Nivel qendror dhe vendor	Vendimi nr. 708, datë 26.8.2015 "Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor"	VKM përcakton institucionet dhe hierarkinë e mbledhjes së të dhënave dhe detyron institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar dhe të përfshirjes së PAK. Ky vendim detyron të gjithë mbledhësit e të dhënave, t'i dërgojnë ato në sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar pranë KKAK. Të dhënat e përpunuara dërgohen pranë Institutit të Statistikave. Vendimi ngarkon Ministrinë e Mirëqenies Sociale për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit.	Nuk vërehen mospërputhje të VKM me KDPAK	
Mjedisi/territori					
13	Nivel qendror dhe vendor	Ligji Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar	Ligji ka si qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore, arantimit të kushteve të sigurisë etj. Ligji ka një nen të veçantë 45/1 që detyron plotësimin e kërkesave dhe standardeve të përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.	Ligji nuk ka përputhje të plotë me KDPAK Përfshirja e nenit 45/1 në ligj nuk mjafton për të garantuar aksesueshmërinë mbasi mungojnë dispozitave detyruese për zbatimin e nenit, si edhe sanksionet dhe penalitetet në rast të moszbatimit të aksesueshmërisë.	Ligji ka nevojë për përmirësime me dispozitave të sakta e detyruese për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë. Në "dokumentet e planifikimit sipas niveleve të qeverisjes" duhet të përfshihen kërkesat e përshtatshmërisë sipas niveleve të qeverisjes. Në nenin 24 "konsultimi dhe takimi publik" duhet të shtohet pikë e veçantë për përgatitjen e materialeve me formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Në nenin 42 "çertifikata e përdorimit", të specifikohen elementët që garantojnë nivelin bazë të aksesueshmërisë Në nenin 51, 52 dhe 53, "inspektimi" kundërvajtjet administrative" dhe "ekzekutimi i dënimeve" duhet të parashikohen penalitete në rast të moszbatimit të kërkesave të nenit 45/1 të ligjit.

14	Nivel qendror dhe vendor	VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e "Rregullores model të zhvillimit të territorit", (i ndryshuar) dhe ndryshuar me VKM Nr. 457, datë 29.6.2022	Rregullorja është dokumenti bazë për zbatimin e ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". Rregullorja detajon strukturat dhe procedurat dhe përmbajtjen e instrumenteve për planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit. Në nenin 6/b, "Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi" përcaktohet përjashtimi nga detyrimi për marrjen e lejes së ndërtimit në rastet e eliminimit të barrierave arkitektonike.	Rregullorja Model nuk ka përputhje të plotë me KDPAK.	Rregullorja Model e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të plotësohet me përcaktime të sakta mbi kërkesat e aksesueshmërisë ndërtimore, në zbatim të nenit 45/1 të ligjit "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Për lehtësi përdorimi dhe zbatim të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë, rekomandohet të integrohet në këtë dokument VKM Nr. 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".
Transporti					
15	Nivel Kombëtar	Ligj Nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë"	Kodi nuk përmban dispozita të sakta për aksesueshmërinë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Kodi përmban disa parashikime për personat me aftësi të kufizuara, siç janë rezervimi i hapësirave të caktuara për qëndrimin e mjeteve ose paisjen me leje të veçanta për nevoja të domosdoshme për këtë kategori. Në Kod, marrja e lejes së drejtimit është diskriminuese për një grup personash me aftësi të kufizuara.	Kodi rrugor është miratuar në vitin 1998 dhe ka mospërputhje me KDPAK	Kodi rrugor duhet të rishikohet në lidhje me: (i) terminologjinë në përputhje me KDPAK; (ii) dispoza të sakta mbi aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në mbështetje të legjislacionit në fuqi; (iii) kushte jo diskriminuese për gjendjen fizike dhe mendore për marrjen e lejes së drejtimit të mjetit.
16	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar	Ligji zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë Neni 85 i ligjit parashikon detyrimin për përkujdesje dhe transport me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë ato duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.	Ligji është miratuar në vitin 1998 dhe ka disa mospërputhje me KDPAK.	Ligji ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe legjislacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
17	Nivel Kombëtar	Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit"	Udhëzimi ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, rregullave, afateve dhe dokumentacionin për dhënien e licencave, certifikatave në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit, si dhe detyrimin e administratës shtetërore për trajtimin e kërkesave dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me legjislacionin në fuqi. Parashikon që subjektet janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t'i krijojë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Moszbatimi i ligjit shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe, ose certifikatës së mjetit lëvizës.	Nuk vërehen mospërputhshmëri me KDPAK, por paraqiten probleme me zbatimin e tij.	Për të rritur efikasitetin e zbatimit të Udhëzimit, do duhej të përcaktohen instrumente të saktë detyrues.
18	Nivel Kombëtar	Udhëzimi Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifët dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve"	Udhëzimi përcakton kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimin, mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit, tarifët dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve. Ai parashikon disa dispozita për personat me aftësi të kufizuara, si për shembull infrastrukturën, tualetet, asistencën, platformat e pjerrëta dhe informacion të përshtatur.	Udhëzimi ka përputhje të pjeshme me KDPAK	VKM ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe legjislacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Informimi dhe komunikimi					
19	Nivel Kombëtar	Ligj Nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"	Ligji rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe zbatohet në transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, (me përjashtim të medias së shkruar) mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji ka disa parashikime të mira për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, mbrojtjen e konsumatorëve me aftësi të kufizuara, aksesin publik telefonik, informimin e rregullt të personave me aftësi të kufizuara për shërbimet dhe produktet dhe konsultimin me persona me aftësi të kufizuara.	Ligji ka përputhje të pjesëshme me KDPAK. Ligjit i mungojnë disa masa më detyruese dhe gjithëpërfshirëse për sa i takon realizimi të aksesueshmërisë së plotë për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të përkufizimit të aksesueshmërisë në komunikime për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria në përdorimin e shërbimeve telefonike duhet të përcaktohet në nen të veçantë, si një detyrim për të gjitha rastet.
20	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike"	Sanksionon Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si Autoritet përgjegjës për qeverisjen elektronike dhe e-Albania si portalin e vetëm për ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike, të drejtat e personave fizikë, subjekteve private dhe autoriteteve publike për të komunikuar me njëri-tjetrin përmes teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturën e shërbimeve elektronike. Në ligj nuk ka përcaktime për mënyrën e aplikimit në e-Albania të personave me aftësi të kufizuara si edhe për formate të përshtatura të dokumenteve që prodhohen nga e-Albania. Ligji përjashton PAK nga përdorimi i platformës elektronike e cila ka hyrë gjerësisht në shërbimet qeveritare.	Ligji nuk ka përputhshmëri me KDPAK	Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të përfshirjes së PAK në grupet përfutuese të shërbimeve të ofruara nga e-Albania. AKSHI duhet të propozojë akte ligjore mbi mënyrat e aplikimit të PAK në sisytemin e-Albania , si edhe përgatitjen e formateve të përshtatura të dokumenteve
21	Nivel Kombëtar	Rregullore Për "Mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike"	Ligji siguron mbrojtje më të mirë të konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet rregullave të qarta mbi të drejtat e përdoruesve në marrëdhënie me operatorët. Rregullorja përmban disa parashikime për konsumatorët me aftësi të kufizuara.	Rregullorja ka përputhje të pjesëshme me KDPAK Rregullorja nuk ka përkufizim të qartë të aksesueshmërisë dhe përfshirje të plotë të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara.	Rregullorja ka nevojë të përmirësohet në drejtim të konceptit gjithëpërfshirës të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e komunikimit elektronike publike. Aksesueshmëria duhet të përkufizohet qartë dhe të jetë detyrim për të gjithë autoritetet komunikuese. Të saktësohet dhe zgjerohet aksesin e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e emergjencës. Të përmirësohet informacioni i aksesueshëm për identifikimin dhe vendndodhjen e numrit thirrës.
22	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"	Ligji përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet e administratës shtetërore, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të tyre në mënyrë të shpejtë, efektive, transparente dhe cilësore. Ligji e përmend parimin e aksesit dhe mosdiskriminimit, por nuk ka përcaktime të sakta për këto.	Ligji nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Ligjit i mungon përfshirja e çështjeve të personave me aftësi të kufizuara. Ligji nuk përmban detyrime specifike për realizimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe lejislatonit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

23	Nivel qendror	VKM Nr. 673 dt. 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"	VKM ka si qëllim kryesor ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI), si institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit. AKSHI është përgjegjës për: Promovimin e teknologjive të reja, hartimin e strategjive dhe plan veprimeve për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOV dhe zhvillimin e politikave e strategjive në sektorin e shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe nxit investimet në këtë fushë. AKSHI bashkërendon programe në fushën e SHI-së, si edhe jep kontribut në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.	VKM nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. VKM ka mungesë vëmendjeje dhe mungon përfshirja direkte e aspektit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.	VKM duhet përmirësuar duke përfshirë: (i) miratimin e standardeve të aksesueshmërisë në TIK, e-shërbimeve dhe sistemet e aplikacionet për personat me aftësi të kufizuara; (ii) integrimin e teknologjive të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara; (iii) në dokumentet e prokurimit (specifikimet teknike), duhet të përfshihet detyrimi për të siguruar produkte të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.
24	Nivel Kombëtar	Ligj Nr. 119/2014 date 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"	Ligji rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Neni 3 sanksionon të drejtën për informim për cilindo, pa pasur nevojë të shpjegojë arësyet, por në asnjë nen të ligjit (veçanërisht neni 14 "Mënyrat e dhënies së informacionit") nuk jepen përcaktime për ofrimin e informacionit në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji nuk ka përputhje me KDPAK	Ligji duhet ripunuar në përputhje me KDPAK dhe legjislationin në fuqi.

25	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"	Ligji rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik dhe përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.	Ligji ka mospërputhshmëri me KDPAK. Ligji i mungojnë parashikime specifike për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në proceset e konsultimit publik, ndaj Ligji nuk ka të përfshirë parimin e aksesueshmërisë gjatë proceseve të konsultimit apo dhënies së informacionit në formate të përshtatura.	Ligji ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe legjisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
26	Nivel Kombëtar	Ligj Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"	Ligji rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike dhe zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, me përjashtim të medias e shkruar.	Ligji ka mospërputhje me KDPAK. Në ligj nuk përfshihet parimi i aksesueshmërisë si detyrim për të gjithë mediat audiovizive që operojnë në Republikën e Shqipërisë	Ligji duhet të përmirësohet duke përfshirë: (i) parimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara; (ii) përcaktimin e detyrimeve për të gjitha mediat që të sigurojnë transmetime të aksesueshme për PAK në programet më të ndjekura dhe ngjarjet me rëndësi të veçantë; konceptin e aksesueshmërisë, me theks të veçantë në gjuhën e shenjave, përdorimin e ikonave të njohura ndërkombëtarisht si "CC" për sub titrat dhe "AD" për përshkrimet audio, guidat e programeve; (iii) dekodimin për shfaqjen e shërbimeve të aksesueshm për personat me aftësi të kufizuara etj.; (iv) aftësinë e kufizuar si një nga grupet potencialisht të prekshme nga gjuha e urrejtjes.
27	Nivel Kombëtar	Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive	Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive përfshin disa parashikime për personat me aftësi të kufizuara, por nuk plotëson kërkesat për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.	Kodi është pjesërisht në përputhje me KDPAK. Përkufizimi mbi aksesueshmërinë nuk është në përputhje me KDPAK. Mungojnë dispozita në respektim të diversitetit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Akses në transmetimet televizive kufizohet vetëm në një edicion informativ të përkthyer në gjuhën e shenjave (për PAK të dëgjimit). Parashikimet për personat me aftësi të kufizuara rezultojnë të pamjaftueshme për të adresuar në mënyrë të duhur aksesueshmërinë në këtë Kod.	Kodi duhet përmirësuar bazuar në KDPAK, veçanërisht duke përfshirë: (i) përkufizimin e personit me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmërisë; (ii) respektimin e diversitetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara; (iii) detyrimet për OSHMA për të rritur gamën e programeve audiovizive të aksesueshme (edicioni qendror informativ në gjuhën e shenjave; 30%-50% të programeve të jenë të aksesueshme përmes gjuhës së shenjave ose titrave ose "captioning" për një kuotë të caktuar prej të programeve; të lihet opsioni i përdorimit të gjuhës së thjeshtë për personat me aftësi të kufizuara të intelektualit).

Ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme/sectoriale

Strehimi					
28	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social"	<p>Ligji përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, përfshi strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm.</p> <p>Ligji garanton qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, përparësi në trajtimin e rasteve me programe specifike, ndihmë gjatë procesit të aplikimit, banesa të specializuara dhe shërbime fizioterapie, mjekësore, komunitare etj.</p> <p>Ligji përkufizon "Banesën e specializuar" për grupet në nevojë.</p> <p>Ligji përfshin "Parimin e mos diskriminimit" dhe specifikon "Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/ dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasojë diskriminuese".</p> <p>Për banesat sociale, ligji detyron pajisjen me infrastrukturën e nevojshme, të përshtatur dhe të aksesueshme për marrjen e ndihmës së shpejtë mjekësore, njoftimit në raste emergjencash, si edhe paisjen me mjediset e nevojshme për fizioterapi, shërbime mjekësore, shërbime sociale, etj.</p>	Ligji nuk është në përputhje të plotë me KDPAK.	Ligji ka vend për përmirësime duke përfshirë në nenin "Parimet". të gjitha banesat (jo vetëm banesat sociale), ndërtesat apo programe të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit mbi aksesueshmërinë.
29		Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 22/2018, "Për strehimin social"	<p>Ligji ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së programeve sociale për strehim, si dhe programit për strehim të të punësuarve të administratës publike</p> <p>Ndryshimet në nenin 14 (neni 14/2), parashikon lehtësira në aplikimet për strehim nga personat me aftësi të kufizuara në portalin "e-Albania", duke u asistuar nga punonjësit e ngarkuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore pranë njësive ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin. Paga për tarifat e nevojshme për procesin e aplikimit për personat me aftësi të kufizuara apo dhe familjeve pa të ardhura sigurohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.</p> <p>Ligji ka sjellë risi në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara në përdorimin e portalit qeveritar e-Albania. Kjo praktikë duhet të aplikohet për të gjitha llojet e shërbimeve që ofron ky portal.</p> <p>VKM është miratuar në zbatim të ligjit Nr. 48/2023, dhe ka si qëllim të vendosë kriteret, procedurën, shqyrtimin, miratimin, si dhe rregullat e tjera për trajtimin me kredi të lehtësuara për të punësuarit në administratën publike.</p>	Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK	Ligji ka nevojë të plotësohet me akte nënligjore mbi format dhe formatet e aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

20	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 301, datë 15.4.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët".	Vendimi përcakton normën e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, kushtet dhe standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe standardet e banesave me kosto të ulët. VKM parashikon sipërfaqen e banimit që i takon personave me aftësi të kufizuara (personi i parë 40m2 dhe për çdo person shtesë, shtohet me 10m2), sipas formulës së përcaktuar në VKM. Në vendim parashikohet numri i njesive të banimit që shërbehet nga një ashensor i përshtatshëm për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. VKM rekomandon që apartamentet për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha rastet (edhe në ndërtesat me ashensor), të parashikohen në katet e poshtme të ndërtesave.	VKM nuk është në përputhje të plotë me KDPAK. Përveç shtesës në sipërfaqe (afërsisht 10m2/person me aftësi të kufizuara) VKM nuk përmban elemente të aksesueshmërisë sipas VKM 1503 datë 2008 "Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga Personat me Aftësi të Kufizuara".	VKM duhet të plotësohet me aplikimin e kërkesave dhe standardeve për të garantuar nivelin bazë të aksesueshmërisë sipas VKM 1503 datë 2008 "Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga Personat me Aftësi të Kufizuara".
31	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 626 datë 15.7.2015 "Për miratimin e normave të projektimit të banesave", Standardet kombëtare të projektimit të banesave ALS-P-NJHND-1501	Në pikën 2.17 të Standardeve jepet përkufizimi "Pengesat arkitektonike, janë të gjitha vështirësitë që pengojnë lëvizjen e plotë të personave përherë ose përkohësisht, në kushte lëvizjeje të kufizuara ose që lëvizin me karrige me rrota". Në kapitujt mbi njësitet hapësirore të veçanta (hapësira e ndenjjes, e gatimit, etj.), nuk trajtohet aksesueshmëria, por referohet: "Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë të shprehura në VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara". Standardi rekomandon që për "Projektimin e hapësirave të lëvizjes, distancat, përmasat etj. lidhur me plotësimin e kushteve normale për personat me aftësi të kufizuara, do t'i referohen dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".	Normat e projektimit të banesave nuk janë në përputhje me KDPAK dhe lejisllacionin mbi aksesueshmërinë. Aksesueshmëria trajtohet në mënyrë të cunguar (vetëm si pengesa arkitektonike) krahasuar me KDPAK dhe përkufizimin në ligjin "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë" Normat e banesave nuk detyrojnë aplikimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë sipas VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".	Standardet e banesave duhet të rishikohen duke integruar në standard rekomandimet e KDPAK, kërkesat e VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara" dhe VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008 "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".
Edukimi - Arsimi					
32	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018	Ligji ka disa parashikime për aspekte të caktuara të aksesueshmërisë, por nuk janë të mjaftueshme për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Ligji nuk garanton gjithpërfshirjen dhe nuk detyron garantimin e nivelit bazë të aksesueshmërisë në institucionet arsimore.	Ligji duhet të përmirësohet me dispozitave detyruese për të garantuar nivelin bazë të aksesueshmërisë, në mënyrë që të sigurohet një gjithë përfshirje më efektive.
33		Udhëzimi i përbashkët i MARS dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 15 datë 25.07.2023 "Për vitin shkollor 2023-2024 në Arsimin parauniversitar"	Në nenin 5, përcakton: në pikën ç/i regjistrimin me përparësi në institucionet e arsimit parashkollor, të fëmijëve me nevoja të veçanta (nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare romë, egjiptianë etj.), fëmijët me aftësi të kufizuara; në pikën d ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinore për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjisllacionit në fuqi dhe në pikën dh. hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parauniversitar në bashkëpunim me personat që kryejnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale të specializuara. Udhëzimi ka përcaktime pozitive për fëmijët me aftësi të kufizuara, por ka nevojë të plotësohet me specifikime dhe afate për zbatimin e tij.	Udhëzimi është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK	Ministria përgjegjëse duhet të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar Udhëzimin për vitin shkollor 2024-2025, në drejtim të mbështetjes ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

34	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 319, datë 12.4.2017 "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave".	Në standardet përcaktohet: Projektimi i ndërtesave shkollore duhet të sigurojë qasjen e papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe mësim nxënien e nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit përkatës për këtë kategori. Shkolla standarde përkujdeset për fëmijët me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigjohet me pajisje për dëgjim dhe humbje e pjesëshme ose e tërësishme e të parit. Në këtë kapitull jepen disa përmasa dhe tregues për hapësirat për përdorim nga PAK. Standardi propozon: projektuesit për një informacion të plotë duhet t'i referohen VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".	Standardet e projektimit të shkollave nuk janë në përputhje të plotë me KDPAK. Kapitulli mbi aksesueshmërinë nuk trajton të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (përfshijon PAK të intelektit). Përmasat dhe treguesit e hapësirave në këtë kapitull nuk garantojnë aksesueshmërinë në të gjitha dimensionet e saj.	Standardet duhet të plotësohen me informacionet e nevojshme për të garantuar aksesueshmërinë bazë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, sipas rekomandimeve të KDPAK, në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara" dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".
35	Nivel Kombëtar	Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet.	Udhëzimi nuk është i ndetyrueshëm për zbatim dhe specifikon "Standardet dhe udhëzimet e paraqitura në këtë udhëzim nuk duhet të konsiderohen si rregulla të detyrueshme, por më shumë si rekomandime që mund të modifikohen për t'iu përshtatur kushteve specifike, siç janë dimensionet e hapësirave dhe topografia apo mundësitë e zgjerimit të shkollës".		
36	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 159, datë 1.3.2017 "Për miratimin e standardeve të kopshteve"	Standardi në kapitullin 2.1 temat dhe përkufizimet përcakton "asnjë fëmijë nuk diskriminohet nga frekuentimi i kopshtit si pasojë e paaftësisë fizike, gjinisë, racës apo etnisë". Në standard përfshihen disa informacione mbi aksesueshmërinë e tualeteve dhe shkallëve, por për detaje i referohet VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara". Kapitulli 5, përcakton "këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara". Në kapitullin 11 "aksesibiliteti i PAK/barrierat arkitektonike" citohet "Për një informacion të plotë projektuesit duhet t'i referohen VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"	Standardi nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Nuk përfshihen në standard, kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë në të gjithë dimensionet e saj.	Standardi duhet të plotësohet me informacionet e nevojshme për të garantuar nivelin bazë të aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara" dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".
37	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 530, datë 20.7.2016 Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve	Standardi përcakton: për personat me aftësi të kufizuara referohuni VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara" Në standard përfshihen disa informacione mbi aksesueshmërinë e tualeteve dhe shkallëve, por për detaje i referohet VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara". Kapitulli 5, përcakton "këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara". Në kapitullin 11 "aksesibiliteti i PAK/barrierat arkitektonike" citohet "Për një informacion të plotë projektuesit duhet t'i referohen VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"	Standardi nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Nuk përfshihen në dokument, kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë në të gjithë dimensionet e saj.	Standardi duhet të plotësohet me informacionet e nevojshme për të garantuar nivelin bazë të aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara" dhe VKM 1503 datë 19.11.1998 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuara".

38	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 682, datë 29.7.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit"	Vendimi përcakton sigurimin e transportit falas për disa mësues e nxënës të arsimit parauniversitar, me status të invalidit që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.	VKM nuk është në përputhje të plotë me KDPAK. VKM nuk përfshin PAK që nuk e kanë siguruar statusin e invalidit dhe PAK të intelektit. VKM nuk parashikon detyrimin për sigurimin e aksesueshmërisë dhe asistencës së nevojshme në transport.	Vendimi ka nevojë të rishikohet në përputhje me VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"
39	Nivel Kombëtar	Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë	Ligji nuk ka parashikime për lehtësira, në procedurat e përshtatura të pranimit dhe akomodimit si edhe sigurimin e aksesueshmërisë ndjekjen e studimeve nga studentët me aftësi të kufizuara.	Ligji nuk ka përputhje me KDPAK	Ligji duhet të përmirësohet duke përkufizuar aftësinë e kufizuar sipas KDPAK dhe duke përfshirë aksesueshmërinë në të gjitha dimensionet e saj (aksesueshmërinë në mjedise, në programet arsimore dhe shërbimet e ndryshme që ofron institucioni). Në ligj duhet të përfshihet: (i) koncepti i përshtatjes së arsyeshme si detyrim nga Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe (ii) detyrimet e përgjegjësitë e institucionit për të garantuar aksesueshmërinë.
40	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 89, datë 14.2.2018 "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve"	VKM rregullon shërbimet e transportit për nxënësit dhe studentët në sistemin parauniversitar.	VKM nuk ka përputhje me KDPAK Në VKM mungojnë krejtësisht detyrimet për parashikimet për transport të aksesueshmëm për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara.	VKM ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe lejislatonit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
41	Nivel Kombëtar	Vendimi Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre"	Vendimi parashikon standardet që duhet të plotësojnë subjektet që kërkojnë pranë MAS hapjen e institucioneve të arsimit të lartë. Në këtë vendim mungojnë krejtësisht standardet e aksesueshmërisë për studentët me aftësi të kufizuara dhe referencat në bazën ligjore ekzistuese	VKM nuk është në përputhje me KDPAK	Është i nevojshëm një parashikim i veçantë i përfshirjes së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

42	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 75/2019, datë 4.11.2019 "Për rininë"	Ligji ka si objekt mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Neni 3/c "Përkufizime" përcakton "Hapësira rinore e sigurt" është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë dhe që plotësojnë standardet e përcaktuara në legjisllacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara, këto hapësira duhet të zbatojnë elementet e përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar. Ligji thekson në nenin 4, a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjisllacioni në fuqi. Ligji krijon Këshillin Kombëtar dhe Këshillin vendor të rinisë.	Ligji ka përputhje të pjesëshme me KDPAK. Referencat e ligjit nuk sanksionojnë zbatimin e detyrueshëm të aksesueshmërisë në mjedis, infrastrukturë, shërbime dhe informacion e komunikim për të mbështetur të rinjtë me aftësi të kufizuara në aktivitetet e ndryshme të rinisë. Në ligj nuk ka parashikime për përfshirjen e të rinjve në Këshillin Kombëtar dhe Vendor të Rinisë	Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të përfshirjes dhe zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi. Të përfshihen të rinj me aftësi të kufizuara ose pjestarë të organizatave në mbështetje të tyre, në Këshillin Kombëtar dhe Vendor të Rinisë
43	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin" (ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)	Në nenin 7/3 ligji përcakton që "Shteti nxit dhe mbështet përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmon nëpërmjet sportit integrimin e tyre në jetën shoqërore".	Ligji nuk ka përputhje të plotë me KDPAK. Nuk ka specifikime në lidhje me zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në mbështetje të KDPAK dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara"	Ligji ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe legjisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
Punësimi					
44	Nivel Kombëtar	Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7961 datë 12.7.1995, (Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996; me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003; me ligjin nr. 10 053, datë 29.12.2008; me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015).	Ligji parashikon "për aq sa është e mundur, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin shfrytëzimin e hapësirave në vendin e punës nga ana e personave me aftësi të kufizuara". Kodi parashikon detyrimin për "përshtatjen e arsyeshme". Ligji zhvendos barrën e provës tek i padituri. Kodi i Punës parashikon ndjekjen e procedurës sipas Ligjit Nr. 10221 datë 14.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Në lidhje me vendin e punës, kodi ka parashikuar që, "për aq sa është e mundur, punëdhënësi respekton rregullat për shfrytëzimin e hapësirave në vendin e punës nga ana e personave me aftësi të kufizuara". Ky parashikim mund të bjerë ndesh me KDPAK, pasi duket sikur nuk e vendos si detyrim aksesueshmërinë dhe standardet e saj të parashikuara në legjisllacionin shqiptar. Shprehja "për aq sa është e mundur" do të nënkuptonte për sa kohë nuk përbën barrë të tepruar nga pikëpamja infrastrukturore, procedurale apo ekonomike.	Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK Kodi nuk e vendos aq sa duhet detyrimin mbi aksesueshmërinë por "për aq sa është e mundur"	Kodi ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe legjisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

45	Nivel Kombëtar	Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar me ligjin Nr. 47/2023 datë 22.06.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"	Ligji sanksionon konceptin e përshtatjes së arsyeshme, përshtatje të vendit dhe mjeteve të punës, përshtatjen e mjedisit, të kurikulave dhe programeve si edhe mjeteve të trajnimit në kurset e formimit profesional. Ligji çon drejt ngritjes së Fondit Social të Punësimit, që ndikon drejtpërdrejt në mbështetjen financiare për aksesueshmërinë e vendit dhe mjeteve të punës për të punësuarit me aftësi të kufizuara.	Ndryshimi i ligjit në vitin 2023, duhet të shoqërohet me aktet nënligjore përkatëse për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së Fondit Social të Punësimit.	Ligji në përputhje me Konventën, pas miratimit të akteve nënligjore që mundësojnë aplikimin e Fondit Social të Punësimit.
46	Nivel Kombëtar	VKM Nr. 199, datë 3.5.1995 "Për lehtësitë që u krijohen invalidëve në ndërtimet publike"	VKM përcakton që të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" dhe të këtij vendimi, duhet të ofrojnë kushte të përshtatshme përdorimi për invalidët. VKM-ja ngarkon personat fizikë e juridikë që hartojnë projekte për ndërtime publike (spitale, shtëpi pushimi, shkolla), të parashikojnë kushte në përputhje me interesat e invalidëve dhe të personave me aftësi të kufizuara, si edhe institucionet përgjegjëse e institucionet projektuese e zbatuese, publike e private për zbatimin e këtij vendimi.	VKM është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK. Vendimi është miratuar para miratimit të KDPAK dhe si i tillë nuk përmbush sa duhet standardet në lidhje me fjalorin e përdorur (invalid), si edhe nuk e trajton aksesueshmërinë në të gjithë dimensionet e saj e për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (e konsideron aksesueshmërinë vetëm në aspektin e mënjanimit të barrierave arkitektonike).	Duhet miratuar VKM e re në përputhje me KDPAK dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara".
Turizmi dhe arkeologjia					
47	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"	Ligji ka si qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitjen e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore. Ligji përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e këtyrvlerave. Neni detyron strukturat e qeverisjes qendrore e vendore dhe subjektet private të krijojnë kushte për garantimin e aksesit të barabartë të publikut tek vlerat kulturore.	Ligji është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK. Në nenin 167 "Shërbime për publikun", Neni 176 "shërbimet në muze" dhe Neni 233 "Aksesi për publikun në muze", nuk ka përcaktime dhe detyrime për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Dispozitat e ligjit nuk janë të pamjaftueshme për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në vlerat kulturore	Ligji duhet të përmirësohet sipas legjisllacionit në fuqi, duke ndërhyrë veçanisht në Nenin 167 "Shërbime për publikun", Neni 176 "shërbimet në muze" dhe Nenin 233 "Aksesi për publikun në muze".
48	Nivel Kombëtar	Vendimi Nr. 711 datë 12.10.2016 për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese"	VKM përcakton krijimin e lehtësirave në lëvizje të personave me aftësi të kufizuara në ambientet e strukturave akomoduese dhe krijimin e lehtësirave në komunikim, si kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese. VKM përcakton detyrimin për të projektuar e ndërtuar ndërtesa e struktura akomoduese me qëllim që për të gjithë klientët dhe vizitorët, të sigurohet hyrja me anë të mjeteve të sigurta, të rehatshme dhe lehtësisht të përdorshme në të gjithë ndërtesën. Në hotele duhet të garantohet që një pjesë e dhomave të jetë e pajisur që të garantojë përdorimin e mjeteve nga personat me aftësi të kufizuara.	VKM është në përputhshmëri të pjesëshme me KDPAK. Përcaktimet në VKM janë të pamjaftueshme për të garantuar aksesin në strukturat akomoduese, për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara	VKM ka nevojë për përmirësime e saktësime mbi lehtësirat e detyrueshme për të gjitha kategoritë e PAK, në përputhje me rekomandimet e KDPAK dhe lejisllacionit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Legjislativimi mbi statusin e personit me aftësi të kufizuara					
49	Nivel Kombëtar	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit"	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" rregullon statusin ligjor dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Ligji përmban parashikime specifike vetëm për personat e verbër (persona me aftësi të kufizuara të shikimit).	Ligji është miratuar përpara miratimit të KDKPAK, ndaj nuk ka përputhje me KDKPAK.	Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të terminologjisë që përdoret, detajimit të konceptit mbi aksesueshmërinë për personat me probleme në shikim, si edhe detajimit të procedurave për të siguruar e aksesueshmërinë në mjediset publike dhe në rrugë.
50	Nivel Kombëtar	Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës"	Ligji përcakton procedurat e përfitimit të përfitimit e invalidëve të punës. Statusi ka parashikime për të drejtat dhe përfitimet e grupimit të invalidëve të punës (persona që janë me aftësi të kufizuara vetëm nga shkaqe që lidhen me punësimin e tyre).	Ligji është miratuar para miratimit të KDKPAK, ai nuk ka përputhje me KDKPAK.	Ligji ka nevojë për përmirësime në drejtim të terminologjisë që përdoret, detajimit të aksesueshmërisë, si edhe detajimit të procedurave për të siguruar e aksesueshmërinë në mjediset publike dhe në rrugë.
51	Nivel Kombëtar	Ligji Nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"	Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vëndndodhja e aksidentit dhe nga çasti i sigurimit. Ligji ka disa përcaktime për aksesin në ndërtesa të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë	Ligji është me përputhshmëri të pjesëshme me KDKPAK Ligji është miratuar para miratimit të KDKPAK, pra ka shumë pak përputhje me KDKPAK.	Ligji ka nevojë për përmirësime dhe plotësime për të detajuar procedurat dhe forcuar masat dhe sanksionet.
Monitorimi, kontrolli dhe zbatimi					
52	Nivel qendror dhe vendor	Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"	Ligji rregullon organizimin dhe funksionimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Neni 8/c, i ligjit përcakton ushtrimin e autoritetit me interes publik vendor, duke krijuar struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi.	Ligji nuk ka përputhje me KDKPAK. Në ligj nuk ka parashikime për penalitete në rast të moszbatimit të dispozitave të tij. Ligji nuk ka përcaktime mbi aksesueshmërinë për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës.	Ligji duhet përmirësuar në përputhje me rekomandimet e KDKPAK dhe lejislativimit në fuqi mbi aksesueshmërinë për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
53	Nivel qendror dhe vendor	VKM Nr. 83, datë 28.1.2015 "Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore" (Ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018)	VKM ka krijuar Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore e cila ka si objekt të punës së saj mbështetjen dhe monitorimin e aktivitetit të qeverisjes vendore në kryerjen e funksioneve të veta. Agjencia propozon përmirësime ligjore (ligje dhe akte nënligjore) dhe ofron këshillim ligjor e teknik në mbështetje të qeverisjes vendore. Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 83, datë 28.1.2015 "Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore" nuk janë në përputhje me KDKPAK. Ato duhet të plotësohen me dispozita specifike mbi detyrimet e qeverisjes vendore për zbatimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, si edhe me penalitete e sanksione në rast të moszbatimit të tyre nga strukturat përgjegjëse.	VKM nuk është në përputhje me KDKPAK. Në detyrat e Agjencisë nuk ka përcaktime në lidhje me aksesueshmërinë sipas Ligjit Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" dhe VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara".	VKM duhet të përmirësohet sipas rekomandimeve të KDKPAK dhe ligjit Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"

54	Nivel Kombëtar	Ligji Nr. 8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"	Ligji sanksionon që projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për strukturat e ndërtuara në Republikën e Shqipërisë, kontrollohen dhe disiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji. Ky ligj është i detyrueshëm të zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve të ndërtimit,	Ligji është miratuar para miratimit të KDPAK dhe nuk ka përputhje me KDPAK. Ligji nuk përmban parashikime specifike mbi kontrollin e aplikimit të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë.	Ligji duhet të përmirësohet sipas rekomandimeve të KDPAK dhe në përputhje me ligjin Nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Ligji duhet të përmirësohet në drejtim të terminologjisë dhe të plotësohet me kërkesat e aksesueshmërisë në (i) përgjegjësitë e zbatuesit të punimeve dhe (ii) dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve të aksesueshmërisë sipas nenit 23 të Vendimit Nr.1503, datë 19.11.2008 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara" në të cilin përcaktohen rregullat për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.
55	Nivel qendror dhe vendor	Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit"	Ligji ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore, në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë të decentralizuar dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative. Në zbatim të ligjit është miratuar VKM për krijimin e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik. Ky vendim është shfuqizuar dhe është zëvendësuar me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit.	Ligji është miratuar para miratimit të KDPAK dhe nuk ka përputhje me KDPAK. Ligji nuk ka parashikime për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji duhet të përmirësohet mbështetur në VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara".
56	Nivel qendror dhe vendor	Vendimi Nr. 893, datë 4.11.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit" (IMT)	Misioni i IKMT dhe IVMT është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e mjedisit nga ndërtimet e zhvillimet e kundërligjshme apo në shkelje të kushteve të lejeve.	VKM nuk ka përputhje me KDPAK. VKM është miratuar në zbatim të ligjit "Për ndërtimet e jashtëligjshme" dhe nuk ka parashikime specifike për respektimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë.	VKM duhet të përmirësohet në lidhje me misionin e inspektoriatit, duke përfshirë garantimin e aksesueshmërisë në mjedis. Në funksionet e IKMT-së dhe IVMT të shtohet kontrolli i zbatimit të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë në mjedis. në zbatim të nenit 45/1 të ligjit "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Aktet Ligjore dhe nën ligjore për Pjesëmarrjen në Jetën Politike dhe Publike

	Aktet Ligjore dhe nën ligjore për Pjesëmarrjen në Jetën Politike dhe Publike				
	Niveli i qeverisjes	Kuadri ligjor ekzistues	Zgjidhjet që ofron legjislatiioni	Përputhje/mospërputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	Ndryshimet e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë
57	Niveli qendror i qeverisjes	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr. 115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022),	Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15). Neni 45 pika e 2-të, një nen i cili diskriminon personat me aftësi të kufizuara mendore, të cilëve me vendim gjykate i është hequr zotësia juridike për të vepruar.	Ky nen është në përputhje të plotë me Konventën, Ky nen nuk është në përputhje me Konventën.	Duhet ndryshuar neni 45 pasi zotësia juridike për të vepruar nuk përbën më një parakusht për të votuar, në vend të saj është njohja e kombësisë së individit si parakusht.
58	Nivel qendror i qeverisjes	Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ²⁷ , Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020	Neni 108 – Për personat që nuk votojnë vetë. Mbeten të përjashtuar personat që nuk dëgjojnë dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Së dyti, kodi nuk përmban parashikime për sigurimin e aksesueshmërisë si parim, por ndalet më së shumti tek fletët e votimit dhe disa aspekte të infrastrukturës.	Është në mospërputhje me konventën.	Duhet ndërrhyrje për të reflektuar qasjen e KNDDPAK.
59	Nivel qendror i qeverisjes	Ligji Nr. 8580, date 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001)	Neni 2: Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësisimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike.	Nuk është plotësisht në përputhje me konventën.	Në shumicën e rasteve nuk ka hapësira të krijuara nga partitë politike për ritjen e edukatës politike dhe për nxitjen e njerëzve e sidomos të personave me aftësi të kufizuara për të marrë përgjegjësi publike.

60	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligj Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen Dhe Aksesueshmërinë E Personave Me Aftësi Të Kufizuara" Datë 24/07/2014	Neni 5 – jetesa e pavarur Gjithashtu në nenin 15: Subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë: a) individit me aftësi të kufizuara; b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara; c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara; organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në kuptim të nenit 13 të këtij ligji.	Ky ligj tregon që janë marrë në konsideratë rekomandimet e Konventës	
61	Nivel vendor i qeverisjes	Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"		Është pjesërisht në përputhje me Konventën pasi janë marrë parasysh parimet, por jo rregulla të qarta sesi organizohet pjesëmarrja në jetën publike e personave me aftësi të kufizuara.	Ky ligj ka disa element të mos barazisë pasi nuk ka rregulla të qarta për sa l përket aksesit në këto institucione dhe marrjen e informacionit nga personat me aftësi të kufizuara.
62	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik 146/2014	Janë të caktuar rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikë-bërëse.	Është në përputhje të pjesëshme, pasi njihet të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të qënë pjesëmarrës, por edhe të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në atë fushë.	Aksesi në Platformën elektronike, e ngritur për zbatimin e këtij ligji, është pjesërisht i aksesueshëm nga personave me aftësi të kufizuara. Kjo pengon pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, kështu që nevojiten rregullore të vecanta për PAK.
63	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Udhëzimi i KQZ Nr.01, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet"	Udhëzimi kërkon që (a) QV të jenë në katet e para të objekteve; (b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara; (c) dërgimin në KQZ të listës së votuesve me aftësi të kufizuar dhe votuesve të verbër brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.	Ka disa elementë dhe parime të KDKPAK. Është në përputhje të pjesëshme me Konventën, por mungojnë detajimet mbi metodologjitë e zgjidhjes së pengesave.	Edhe pse janë marrë përsipër rekomandimet dhe parimet e caktuara në KDKPAK, vihet re që përsëri nuk ka një kërkesë specifike në lidhje me pjesëmarrjen në jetën politike. Urdhri është i ndërtuar në mënyrë të përgjithshme që lë shumë hapësirë për interpretim.
64	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 10 221, datë 04.02.2010 i ndryshuar me ligjin 140/2020	Neni 9, 'Pjesëmarrja në politikë' sanksionon që ..., "ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji".	Është në përputhje me Konventën, përveç pjesës në ligj për barrën e provës e cila nuk duhet të jetë pjesë e përgjegjësisë së personit.	Ka nevojë të përmirësohet ky aspekt ligjor duke marrë si model zgjidhjet e dhëna në vënde të tjera të Europës, për t'u përgjigjur barrës së provës.
65	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligji nr. 119/2014 date 18.9.2014 Për të drejtën e informimit;	"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."	Është pjesërisht në përputhje me Konventën, sidomos përsa i përket parimit të barazisë në aksesin në informacionin dhe pjesëmarrjen në jetën publike.	Ligji nuk ka informacion të plotë përsa i përket kontekstit për personat me aftësi të kufizuara. Nuk ka një përshkrim të qartë që përfshin pjesëmarrjen në jetën publike të kësaj kategorie.
66	Nivel qendror	Ligji Nr. 8788, date 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse"	Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse.	Nuk është në përputhje me Konventën, pasi nuk siguron asnjë të drejtë dhe akses specifik për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji duhet të ketë përshkrime ose akte nënligjore që lehtësojnë pjesëmarrjen e PAK në aktivitete publike.
67	Nivel qendror	Ligj Nr. 80/2021 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"	Ky ligj, edhe pse nënkuptohet, parashikon dhe rregullat e krijimit dhe regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që punojnë për personat me aftësi të kufizuara ose janë të krijuara nga ata.	Nuk është shumë në përputhje me KDKPAK, pasi është një përshkrim i përgjithshëm teknik i regjistrimit të organizatave të shoqërisë civile, pa një nen të specifikuar për PAK dhe lehtësirat për të cilat ata kanë nevojë.	Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në organizime, duhet lehtësuar përmes shtimit të elementëve të aksesueshmërisë në këtë ligj.

68	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit"	Rregullon statusin ligjor dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Ligji përmban parashikime specifike vetëm për personat e verbër dhe terminologjia e tij nuk është në përputhje me KDPAK dhe legjislacionin shqiptar në zbatim të saj.	Është një nga ligjet më të vjetër dhe më pak të ndryshuar në krahasim me pjesën tjetër të legjislacionit. I hartuar në 1996 pothuajse 6 vite para miratimit të KDPAK që do të thosë se ka nevojë për përshtatje të tij me rregulat dhe standartet e tanishme.	Ligji ka terminologji të vjetëruar që ka nevojë për rishikim.
69	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës".	Neni 12 parashikon që hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 për qind të çmimit të biletës. Ministria që mbulon kulturën, rininë e sportet nxjerr aktet nënligjore përkatëse. Neni 17 parashikon që gjatë përgatitjes së akteve ligjore e nënligjore dhe të programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalidëve. Shoqatat që mbrojnë interesat e invalidëve, marrin pjesë në mbledhjet për diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që prekin drejtpërdrejt a tërthorazi interesat e invalidëve.	Është një mungesë përputhjeje përsa i përket pjesëmarrjes së personave me AK në jetën publike. Kjo pjesë e ligjit është në përputhje, por përsëri terminologjia është shumë e vjetëruar.	Si ligj ka nevojë për rishikim ose akte nënligjore për ta përmirësuar atë.
70	Nivel qendror të qeverisjes	Ligji nr.112/2020 Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues	Ky ligj i miratuar në 2020 ka për qëllim rregullimin e përkufizimit të pronarit përfitues, subjektet e detyruara të cilat duhet të regjistrojnë pronarët përfitues, krijimin, funksionimin dhe administrimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues	Në një pamje të përgjithshme si ligj nuk është i hartuar duke marrë parasysh Konventën. Nuk ka një qëllim që të jetë në përputhje me vlerat dhe parimet e konventës por me tepër me të drejtat e tjera sociale.	Ligji nuk ka shumë akte nënligjore të rregullojnë funksionimin e këtij regjistri. Që prej miratimit e deri tani nuk ka akoma hapa të marrë në krijimin e këtij regjistri qoftë edhe në E-Albania (platforma shtetërore e shërbimeve zyrtare) dhe cilat do jenë masat mbështetëse ose nëse do ketë lehtësira në akses të personave me aftësi të kufizuara apo jo.
71	Nivel qendror dhe vendor i qeverisjes	Plani Kombëtar i Veprimit i Aftësisë së Kufizuar 2021-2025	Në fushën e veprimit 'Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike', PKVPAK përcaktohet si qëllim politikash garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre, përmes objektivave: (i)Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënia e mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje; (ii)Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike dhe promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara; (iii)Rritja e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.	Është në përputhje me Konventën.	Parashikimi i kostove për të realizuar objektivat, i rëndësishëm.

IX. REFERENCA

I. Kuadri ligjor Ndërkombëtar

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe

Agenda 2030 mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara - Unioni I Barazisë, Strategjia Europiane Drejtat për Personat me Aftësi të kufizuara 2021-2030.

II. Kuadri ligjor rreth Aksesueshmërisë:

Aktet ligjore e nënligjore:

Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Ligji Nr. 82/2021 datë 4.06.2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”

VKM 470 datë 6. 07. 2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”

VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

Ligji Nr. 10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021 – 2025 (“PKVPAK 2021–2025”) i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 276, datë 12.05.2021

VKM Nr. 436, datë 22.6.2022 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara”

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10. 2020

Udhëzimi i KQZ Nr. 01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Mbledhja e të dhënave

VKM Nr.708, datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”

Mjedisi/ Territori

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin Nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar,

VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e “Rregullores model të zhvillimit të territorit” (i ndryshuar) dhe Manuali i Lejeve të Ndërtimit

Transporti

Ligj Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”

Udhëzimi Nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”

Informimi dhe komunikimi

Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Rregullore Për “Mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”

Ligji Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”

Vendimi Nr. 673 dt. 22.11.2017 i Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”,

Ligj Nr. 119/2014 date 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

VKM Nr. 204, datë 7.4.2023 për miratimin e dokumentit të politikave për standardet e shërbimeve publike në Republikën e Shqipëri

Ligj Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive

Ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme/sectoriale

Strehimi

Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”,

VKM Nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me çira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”

VKM Nr. 626 datë 15.7.2015 “Për miratimin e normave të projektimit të banesave”, Standardet kombëtare të projektimit të banesave ALS-P-NJHND-1501

Edukimi - Arsimi

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018

VKM Nr. 319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave” dhe Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet

VKM Nr. 159, datë 1.3.2017 “Për miratimin e standardeve të kopshteve”

VKM Nr. 530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”,

VKM Nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”

Ligji Nr. 80/2015 datë 22.7.2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”

VKM Nr. 89, datë 14.2 2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve”,

VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”,

Ligji Nr. 75/2019, datë 4,11,019 “Për rininë”

Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020

Punësimi

Ligji nr. Nr.7961 datë 12.7.1995, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar me ligjin Nr. 47/2023 datë 22.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”

VKM Nr. 199, datë 3.5.1995 “Për lehtësitë që u krijohen invalidëve në ndërtimet publike”,

Turizmi dhe arkeologjia

Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”

VKM Nr. 711 datë 12.10.2016 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese”

Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”

Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”

Monitorimi, kontrolli dhe zbatimi

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

VKM Nr. 83, datë 28.1.2015 “Për krijimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore”

Ligji Nr. 8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”

Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimeve”

VKM Nr. 893, datë 4.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit

III. Kuadri Ligjor për pjesëmarrjen në Jetën Politike dhe Publike

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , e ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr. 115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022 ;

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020;

Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë, Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” , i ndryshuar;

Kodi i Procedurave Administrative të RSh: Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji Nr. 8580, date 17.2.2000 ‘Për partitë politike’, i ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001);

Ligj Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen Dhe Aksesueshmërinë E Personave Me Aftësi Të Kufizuara” Datë 24/07/2014

Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik 146/2014

Udhëzimi i KQZ Nr.01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 10 221, datë 04.02.2010 i ndryshuar me ligjin 140/2020 ;

Ligji nr. 119/2014 date 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit;

Ligji Nr. 8788, date 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”

Ligj Nr. 80/2021 Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse;

Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”

Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”

Plani Kombëtar i Veprimit i Aftësisë së Kufizuar 2021-2025

